



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 19 SHTATOR 2008**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE 19.
SEPTEMBRA 2008. GODINE**

**SHTATOR – SEPTEMBAR
2008**

R e n d i i d i t ë s

1. Shqyrtimi i Raportit për shpenzimet e Buxhetit të Kosovës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2008 (raporti iu është dërguar deputetëve më 04.08.2008),
2. Shqyrtimi i Raportit të Radio Televizionit të Kosovës për vitin 2007 (raporti iu është dërguar deputetëve më 23.05.2008), dhe
3. Shqyrtimi i Raportit të Këshillit të Pavarur të Mediave për vitin 2007 (raporti iu është dërguar deputetëve më 06.03.2008).

D n e v n i r e d

1. Razmatranje Izveštaja o troškovima budžeta Kosova za prvo šestomesečje 2008.godine (izveštaj je dostavljen poslanicima 04.08.2008) ,
2. Razmatranje izveštaja Radio Televizije Kosova za 2007.godinu (izveštaj je dostavljen poslanicima 23.05.2008), i
3. Razmatranje izveštaja Nezavisnog odbora za medije za 2007.godinu (izveštaj je dostavljen poslanicima 06.03.2008).

A g e n d a

1. Review of the report for expenditures of the Kosovo Budget for first six months of 2008,
 2. Review of the RTK report for year 2007, and
 3. Review of the report presented by Independent Media Council for year 2007.
-

Seancën e drejtoi Kryetari i Kuvendit, zoti **Jakup KRASNIQI**.

KRYETARI: Të nderuar deputetë, ju lutem, i zini vendet tuaja!
Urdhro, Besa Gaxherri, por ende nuk kemi filluar séancën!

BESA GAXHERRI: Ju faleminderit, zoti Kyetar!

Në emër të Grupit Joformal të Grave, pra deputete të Kuvendit të Kosovës, kjo ndoshta relevanten e ka pasur dje, por dje fatkeqësisht nuk na u ka dhënë fjala, nuk na u ka dhënë mundësia as të flasim, sot gratë, Grupi Joformal i Grave, në shenjë proteste për emërimin e dhjetë diplomatëve të parë, pa përfshirje të asnjë gruaje në këtë kor diplomatik, gratë donë të bëjnë protestë, 15 minuta dalin nga seanca.

Ne e ftojmë, ju lutem, ne e ftojmë edhe gjininë e kundërt, ata që solidarizohen me ne, 15 minuta protestë!

Vazhdimi i seancës pas përfundimit të protestës së grave deputete

KRYETARI: Të nderuar deputetë, të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar, Mirë se keni ardhur në Seancën e tretë plenare të Sesionit vjeshtor të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë 97 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Rendi i ditës dhe materialet u janë dërguar me kohë, andaj fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

A ka kush diçka lidhur me rendin e ditës. Ramë Buja e ka kërkuar fjalën.

RAMË BUJA: zoti Kryetar,
Të nderuar ministra, zëvendëskryeministër,
Të nderuar kolegë deputetë,
Unë kam një propozim zoti Kryetar, para se të fillojmë me punën për pikën e dytë të rendit të ditës, ne kemi marrë vërtet më 23.05.2008 Raportin e Radiotelevizionit të Kosovës, por në Radiotelevizionin e Kosovës është bërë edhe në auditim dhe atë raport nuk e kemi.

Besoj se do të ishte më logjike, por edhe debati më përmbytësor, nëse do ta kemi edhe Raportin e auditimit gjeneral që është bërë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Kolë Berisha e ka fjalën.

KOLË BERISHA: Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së pajtohet me këtë propozim.

KRYETARI: Mirë, ju faleminderit!
Grupi Parlamentar i AKR-së, Ibrahim Makolli

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së pajtohet që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet. Po ashtu kemi vërejtje sa i përket pikës së parë të rendit të ditës. Është shumë e vërtetë që Raporti për shpenzimet e buxhetit të Kosovës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2008 iu është dërguar deputetëve me datën 4. gusht 2008, por kemi konsideratë se muaji gusht ka qenë pushim dhe është kohë shumë e shkurtër që nuk i plotëson kushtet e parapara me Rregulloren të Punës për t'u trajtuar kjo pikë e rendit të ditës. Andaj, propozojmë që edhe kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet, në mënyrë që deputetët të kenë mundësi...

KRYETARI: Njëherë e kemi pikën e dytë të rendit të ditës, ta kryejmë njëherë e pastaj vazhdojmë me pikën tjetër. Ju faleminderit, Ibrahim!

IBRAHIM MAKOLLI: Mirë Kryetar, kthehem prapë në pikën e parë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Ne do të pajtohemi që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës, por nuk mund të mos vërejmë edhe njëherë se nuk ka mbledhje ose seancë të Kuvendit ku nuk heqim pika prej rendit të ditës me justifikime kryesisht prej dy partive të cilat janë në pushtet. Mendoj se është koha të fillohet në mbledhje të Kryesisë, të shihen pak më herët këto çështje dhe mos të tërheqim kaq shumë pika prej rendit të ditës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të LDD-së, Lulzim Zeneli e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Po, pas qëndrimeve paraprake që i dhanë grupet në fjalë, një gjë nuk është e justifikueshme që për herë të dytë ky Raport të hiqet nga rendi i ditës. Edhe ashtu njëherë e kemi tërhequr më parë, me arsyetim kinse Komisioni për Buxhet nuk ka arritur ta shqyrtojë Raportin financiar dhe, tash, pas një kohe shumë të gjatë, prapë e kemi një arsyetim të tillë. Unë besoj që Televizioni Publik i Kosovës ka nevojë, ka nevojë për ndihmë, ka nevojë që ky Kuvend i Kosovës të debatojë mbi Raportin e Punës dhe kjo e justifikon edhe një argument tjetër kur dihet se raporti i fundit i OSBE-së nuk ka qenë, nuk ka qenë në nivelin për ta përshëndetur punën e mediumeve publike, në raport me pavarësinë editoriale.

Prandaj, jemi të bindur që ky Kuvend i Kosovës, në qoftë se anashkalon diskutimet, debatet rreth këtij mediumi publik, nuk është në nivelin e përgjegjësisë dhe të detyrës që i ngarkohet edhe me Ligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Shpresa Murati e ka kërkuar fjalën.

ŠPRESA MURATI: Hvala, gospodine predsedniče!

I Parlamentarna grupa „7+“, podržava predlog Parlamentarne grupe PDK da se ova tačka skine sa dnevnog reda. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Slobodan Petroviq:

SLOBODAN PETROVIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

Ono što je optimalno rešenje, jeste da se odloži ova tačka za sledeću sednicu, s tim što bih ja imao samo predlog da se odredi sednica, a to da bude sledeća sednica, da nemamo posle ponovo predlog da se i za sledeću sednicu odloži ova tačka.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Atëherë, shkojmë me një votim formal. Kush është që pika e dytë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e ardhshme? Ju faleminderit! A ka “kundër”? 5 janë “kundër” A ka abstenime? Tri abstenime. Konstatoj se me shumicën e votave të deputetëve, shtyhet për seancën tjetër, pas shqyrtimit të Raportit të Auditorit të Përgjithshëm.

Urdhëro! Zëvendëskryeministri e ka fjalën.

HAJREDIN KUÇI: Unë, për hir të korrektësisë, që tha zonja Gaxherri, ndoshta ka nevojë të japim një sqarim edhe për opinionin publik. E kuptoj mënyrën e reagimit. Ne i kemi emëruar tri femra në pozitë diplomatike, një në Vjenë, një në Bernë dhe një në Francë. Besoj që në përzgjedhjet tjera do të jenë edhe më të mira. Ju faleminderit!

KRYETARI: Besa Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Zoti Kryetar, ju faleminderit! Një replikë të vogël, e pastaj do ta marrë fjalën edhe për pikën e parë të rendit të ditës.

Zoti zëvendëskryeministër, ndoshta i keni emëruar, unë e kam parë veç një emër për sekretare. Ndoshta ju tash i keni bërë edhe dy sekretare, sepse po punoni pa procedura dhe mund t'i ndërroni këta emra kur të doni, si të doni. Por, më lejoni, ju lutem, një theksim të Presidentit shumë ironik. Kur e jep përgjigjen në pyetjen e bërë, pse nuk e keni asnjë femër në Korin diplomatik, thotë: "Po shikoni, ne jemi në fazën emergjente, na mungon logjistika"! Presidenti i kursen gratë prej mundit të ambasadoreve, ndërsa gratë kanë qenë në aparteidin 10 vjeçar në ballë të situatës, edhe gjatë luftës, edhe në tranzicion, herë një hap para jush, e herë krah me ju, ndërsa faleminderit që po na kurseni për ambasadore, se ka mundim! Kjo është. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar deputetë, edhe pse nuk e kemi në rend të ditës, do të vazhdojmë me pyetjet parlamentare, pastaj me pikën e tretë të rendit të ditës, për shkak që ministri i Ekonomisë dhe i Financave është në takim zyrtar në këtë kohë, andaj e lëmë pas pauzës. Kështu, fillojmë me pyetjet parlamentare të mbetura nga seanca e kaluar.

Urdhëro! Besa Gaxherri e ka fjalën, pastaj le të përgatitet Teuta Hadri.

BESA GAXHERRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Ju lutem, e kam fjalën për pikën e parë të rendit të ditës: - Shqyrtimi i Raportit për shpenzimet e buxhetit të Kosovës për 6 mujorin e parë të vitit 2008.

Zoti Kryetar, ky material apo ky raport na ka ardhur në Kuvend me datën 4 të muajit të tetë, do të thotë, në kohën kur deputetët ose Kuvendi ka qenë në pushim.

Komisioni i Buxhetit e ka shqyrtuar këtë material me datën 3 09.2008 dhe, ju lutem, edhe Komisioni për Buxhet e ka shkelë procedurën duke na ftuar vetëm një ditë përpara me telefon, pa u njoftuar me rendin e ditës, siç thotë Rregullorja, së paku tri ditë, dhe ne e kemi qitë, unë për vete e kam qitë në propozim në Komision që nuk mund të shqyrtohet në Komision ky dokument në atë procedurë urgjente dhe, natyrisht, propozimi im është mbivotuar sepse shumica jeni në pozitë.

Ju kisha lutur, zoti Kryetar, që këtë pikë të rendit të ditës, që edhe sot, ky është dokumenti që sot e bien Komisioni i Buxhetit rekomandimin, sot ka mbërrirë te deputetët rekomandimi, do me thënë as Komisioni i Buxhetit deri sot nuk ka qenë i përgatitur. Përveç kësaj, ende nuk është procesverbali i asaj dite nga Komisioni i Buxhetit. Kjo të jep të kuptosh që kjo seancë nuk është e përgatitur në qoftë se do t'i respektojmë procedurat për këtë pikë të rendit të ditës, përndryshe ju jeni shumicë, në qoftë se doni t'i thyni procedurat, na jemi të përgatitur të diskutojmë edhe për materialin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Gani Koci. Teutë, me fal!

GANI KOCI: Për hir të opinionit dhe të Besës në këtë rast, që e respektoj shumë, ne e kemi pasur një muaj ditë afat të konsultimit të këtij Raporti. Arsyetimi se ne kemi qenë në pushim, nuk vlen absolutisht, sepse deputetët, kudo që të jenë, duhet të njoftohen me materialin.

Më 4 gusht Raporti ka ardhur nga Qeveria. Më 4 shtator Komisioni e ka shqyrtuar këtë Raport dhe sot është data 19 shtator, do të thotë që 15 ditë pas shqyrtimit të raportit nga ky Komision, secili deputet ka pasur kohë dhe mundësi ta lexojë, ta deshifrojë, ta konsultojë dhe të dalë sot i përgatitur këtu në Kuvend. Në pamundësi të përgatitjeve të deputetëve, nuk konsideroj se duhet të shtyhet kjo rend dite.

Ishte e rëndësishme e asaj pikës tjetër të rendit të ditës, sepse në gusht, në qershor kemi mbajtur takimin e Komisionit dhe kemi ardhur në përfundim se duhet një raport i Auditorit për RTK-në. Raporti i Auditorit është në përfundim e sipër dhe ishte shumë e arsyeshme shtyrja për Radio-Televizionin e Kosovës, dhe po e shfrytëzoj këtë rast se sot e ka ditën e vet, është Dita e Radio-Televizionit të Kosovës, që t'ua uroj një punë më të mbarë, më të suksesshme dhe më të mirë!

Prandaj, nuk duhet të shtyhet absolutisht Raporti i Buxhetit për 6 - mujin e këtij viti.

KRYETARI: Ju Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar, deputetja Teuta Hadri.

TEUTA HADRI: Ju faleminderit, Kryetar!

Fjalën e desha pas zëvendëskryeministrit, por po ke simpati për Besën, ia dhe fjalën përpara. (Të qeshura në sallë). Eh, Unë desha vetëm ta sqaroj atë që tha Ganiu, po herën e dytë po kthehem se, ndoshta do të humbë vlera e fjalës sime para fjalës së Besës, se Besa Gaxherri nuk ka qenë e caktuar nga Komisioni dhe askush nuk e ka caktuar nga gratë formale, se është edhe kryetarja këtu.

Unë nuk dua ta keqinformojmë opinionin dhe të vihet ky Parlament në lojë, kështu që thashetheme dhe spekulime nuk dua radhëve të tjera, në emër të grave kur flitet. Në emër të individit Besa mund të flasë edhe në Parlament, edhe në rrugë, kurse në emër të grave nuk e lejojmë që ky Parlament të vihet në tallje. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka kërkuar Riza Smaka.

Ju lutem, nëse keni kërkuar fjalën për rendin e ditës, jo për diçka tjetër.

RIZA SMAKA: Zoti Kryetar,

Të nderuar qeveritarë, deputetë,

Me datën 8 shtator të këtij viti ia kam adresuar Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës një kërkesë shkrimore, të mbështetur në dispozitat e neneve 23, paragrafi 2, të nenit 29, paragrafi 1, për rendin e ditës është fjala, ju lutem. Ju lutem, për rendin e ditës unë kam propozuar çështje urgjente e cila do të ishte definuar nga ju dhe unë, sipas rregullave. Ju nuk më keni thirr mua, kurse Kryesia e ka interpretuar keq dhe gabimisht, se nuk ka qenë fjala për Rezolutë, por ka qenë për pyetje urgjente. Edhe këtë, shkurt ju lutem!

Konform me nenin 23, paragrafi 2, dhe nenin 29, paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, propozim për radhitje në rendin e ditës të seancës së parë të Kuvendit të Republikës së Kosovës të mocionit të Serbisë adresuar Kuvendit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për adoptimin e Rezolutës me të cilën do të krijohet baza juridike që Gjykata Ndërkombëtare të Drejtësisë të kontestojë ligjshmërinë e aktit politik të Kuvendit të Republikës së Kosovës për pavarësinë politike të Kosovës. Do të ishte shumë e rëndësishme, e përshtatshme që Kuvendi i Republikës të Kosovës të miratonte një deklaratë politike, e cila do t'i shërbente, në radhë të parë Ministrisë, ministrit për Punët Botore, që dje thoshte se nuk e ka mision lotimin, kurse Ismail Kemajl Vlorën, zotëri Virioni në vitin 1012 e ka pas angazhuar për të lobuar nëpër Evropë, ose Hasan Prishtina krejt pasurinë e vet e paska pas shkrirë për lobim nëpër diplomacitë...

KRYETARI: Ju faleminderit, po historinë e di bukur mirë, kështu që nuk kemi ardhur të tregojmë histori. Vazhdojmë me pikën e rendit të ditës. Vazhdojmë. Ministria Nekibe Kelmendi e ka fjalën.

NEKIBE KELMENDI: Në rend dite nuk janë të përfshira edhe pyetjet parlamentare, por nëse ju doni ta plotësoni rendin e ditës, nuk kam asgjë kundër.

KRYETARI: Ne i kemi rreth 40 pyetje. Ju e dini se dje kur kanë përfunduar pyetjet, kryesuesi i Seancës ka thënë se pyetjet e mbetura vazhdojnë në seancën e sotme, prandaj jeni pajtuar në një formë. Ne mund edhe t'i lëmë, nuk është krejt çështja ime, është çështje e Kuvendit. Nëse ju doni t'i lëmë pyetjet, i lëmë, por megjithatë dje kryesuesi ju ka njoftuar se pyetjet e mbetura vazhdojnë në seancën e sotme.

Urdhëro, Gjylnaze Syla!

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Si Kryetar i Kuvendit, ju ftoj që t'i përmbaheni Rregullores dhe përgjegjësi që i keni.

E para, nuk ka çështje më të rëndësishme se shqyrtimi i buxhetit, dhe ju duhet të siguronit që ministri i Ekonomisë dhe Financave të jetë këtu dhe të mos jetë nëpër takime. Kjo është e para.

D dyta, në rendin e ditës ne nuk i kemi pyetjet parlamentare, prandaj sipas rregullave, ju duhet të na ftoni të votojmë, a jemi ne për atë pikë të rendit të ditës, apo jo? Ju faleminderit!

KRYETARI: Mirë! I ftoj deputetët, a jeni që në rend dite t'i kemi pyetjet parlamentare. Kush është "për"? Ju faleminderit! A ka "kundër"? 3 "kundër! A ka abstenime? 1 abstenim, kështu që hyn në rend dite dhe vazhdojmë me pyetjet parlamentare.

Deputetja Myrvete Pantina, pyetje për ministrin e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiqin. Deputete, parashtrijeni pyetjen!

MYRVETE PANTINA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Zehtarëve të Komunës së Vushtrrisë iu mungon dokumentacioni mbi kryerjen e obligimeve tatimore ndaj shtetit deri në vitin 1999, edhe pse ekziston regjistri i tatimpaguesve për atë kohë. Këta zehtarë i kanë kryer obligimet e tyre në bazë të

vendimit të tatimit para vitit 1999. Në mungesë të këtij dokumentacioni, pa fajin e tyre, zejtarët e komunës së Vushtrrisë nuk mund të realizojnë të drejtën e tyre për pension të plotë.

Zoti ministër, si duhet të veprojnë zejtarët e Komunës së Vushtrrisë për të realizuar të drejtën e tyre për pension të plotë?

NENAD RAŠIĆ: Poštovani predsedniče,
Poštovani zamenici premijera,
Poštovani ministri,
Dame i gospodo, narodni poslanici,
Poštovana gospodjo Myrvete,

Kao što znate, penzioni sistem koji je nastupio, koji je nastao pogotovo u zadnjem periodu sa povećanjem od 40 do 75 €, doneo je neke određene poteškoće. To su poteškoće koje su tehničke prirode, ali najkonkretniji odgovor na vaše pitanje je da opština sama, u konkretnom slučaju u Vučitrnu, može dati potvrdu da su ovi ljudi, ovi predstavnici, ovi penzioneri bili u radnom odnosu u opštini u periodu koji je sporan, jer oni su ti koji najbolje znaju.

Mi smo se nadali da dokumenta, kada je pravljen sam taj zakon, mogu biti dostupna, ali nema detaljnih informacija o tome ko je platio doprinos u tom spornom periodu, tako da za zatatlljije iz Vučitna mogu najkonkretnije u svojoj opštini da dobiju potvrdu od opštinskih organa vlasti da su bili u sistemu institucija u to vreme, a mi ćemo takvu njihovu potvrdu prihvatiti kao validnu i na osnovu toga odobriti im da budu u delu penzije za ove koji su plaćli kontribut, odnosno doprinose tako da će i taj njihov zahtev biti usvojen. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit! A ka pyetje shtesë? Ju faleminderit edhe juve! Vazhdojmë.

Deputeti Driton Tali, pyetje për Kryeministrin, zëvendëskryeministrin, ose ministrin e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, zotin Enver Hoxhaj.
Zoti deputet, mund ta parashtroni pyetjen!

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Pyetja ka të bëjë me vendimin e Qeverisë së Serbisë që mos t'i njohë diplomat akademike të UNMIK-ut, të vërtetuara nga UNMIK-ut, dhe kjo pyetje është bërë më 1 shtator, kur Qeveria ende nuk pati reaguar, andaj do ta bëj ashtu siç ishte shkruar. Si do të reagojë Qeveria e Kosovës ndaj këtij provokimi të radhës? Çfarë do të ndërmarrë ajo konkretisht ndaj këtij vendimi tendencioz, i cili ka për qëllim kryesor diskriminimin e shqiptarëve të Luginës së Preshevës, të Bujanocit dhe të Medvegjës?! Pyetjen do t'ia drejtoja ministrit të Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën!

ENVER HOXHAI: I nderuar zoti Kryetar,
Të nderuar zëvendëskryeministra,
Të nderuar kolegë, shumë të respektuar deputetë,

Informatat tona janë që, diplomat të cilat janë vërtetuar deri më tash nga ana e UNMIK-ut veç pranohen edhe në Luginën e Preshevës, mirëpo dilema është për diplomat që lëshohen me vulën Republikës së Kosovës, nuk pranohen në Serbi. Kjo është një çështje ku mundësitë tona janë shumë të kufizuara që vërtet të ndikojmë mbi autoritetet serbe që të pranohen diplomat e tilla. Ndërkaq, kam dëshirë t'ju informoj që në Republikën e Maqedonisë, në Mal të Zi, në Bosnjë, pothuaj se në heshtje edhe në Sanxhak, diplomat e tilla pothuaj se pranohen dhe qarkullojnë edhe me vulë të Republikës së Kosovës. Kështu që, pyetja në formën se si e shtruat që diplomat UNMIK-ut nuk pranohen, për mua është një situatë e re, ndërsa sa i takon qarkullimit të diplomave të Universiteti të Prishtinës në universitetet evropiane, dua t'ju informoj që të premtën e kaluar kam pasur një takim me Rektorin e Universitetit të Vjenës, i cili është kryetar i Asociacionit të Universiteteve Evropiane. Të gjitha universitetet evropiane i pranojnë diplomat e Universitetit të Prishtinës për arsimim të mëtutjeshëm. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputet, a ke pyetje shtesë?

DRITON TALI: Po, zoti Kryetar!

Kjo pyetje është marrë nga ueb sajti i Qeverisë së Serbisë, ashtu ka qenë, unë e ceka më 1 shtator. Aq më mirë, thashë, që diplomat e Republikës së Kosovës nuk pranohen, që është përsëri një racizëm i llojit të vet. Unë prita një agjilitet më të madh nga Qeveria në kuptimin e ankesës në institucionet e caktuara ndërkombëtare ndaj këtij ligji diskriminues që ka për qëllim segregacionin e shqiptarëve atje, sidomos në këtë kohën kur kjo Qeveria demokratike e Serbisë me të madhe trumbeton disponimin e saj properëndimor. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Deputeti Riza Smaka, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi, ose për ministrin e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, zotin Enver Hoxhaj.

Urdhëroni, bëjeni pyetjen, deputet!

RIZA SMAKA: 32 universitete private i ka licencuar MASHT-i. Studenti në universitet është palë në procedurë. Ligji kur ka çështje të dilemave, kurdoherë aplikohet në favorin e studentit. Kisha pasur dëshirë, zoti ministër, të jepni një deklaratë zyrtare se si do të trajtohet statusi juridik i studentëve të viteve të dyta, të treta dhe të atyre që kanë fituar diploma në universitetet private? Ju faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, më duket se je përgjigjur dje, por përgjigju edhe sot!

MINISTRI ENVER HOXHAI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Po synoj që të jem vërtet shumë i shkurtër. Deri më tash, sipas informatave të Ministrisë së Arsimit, ka 68 studentë që kanë diplomuar në universitetet private dhe janë tri universitete të cilat kanë mbërrirë që t'i përcjellin të rinjtë me një diplomë të tillë deri në diplomën e universitetit.

Unë e përmenda edhe dje që kjo çështje nuk është çështje e Ministrisë së Arsimit, është çështje e Ligjit mbi arsimin e lartë. Ligji për arsimin e lartë e rregullon punën dhe funksionimin e institucioneve private të cilat janë të licencuara. Çdo diplomë që është lëshuar deri me tash me licencë dhe në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë, do të pranohet, do të jetë valide dhe, si e tillë, ne si Ministri, do të thotë, e pranojmë dhe kuptohet se duhet të pranohet edhe prej të gjitha institucioneve të tjera. Do të thotë,

statusi juridik i këtyre studentëve është, për mendimin tonë, shumë, shumë i qartë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!
Deputet, ke pyetje shtesë?

RIZA SMAKA: Kam dëshirë edhe këtu të theksoj se është më se e nevojshme ajo që e ka ndërmarrë Qeveria nëpërmjet Ministrisë, ndryshe, pa fije të dyshimit, numri më i madh i universiteteve private nuk kanë mund të licencohen as për shkolla të mesme. Mirëpo, kjo pyetja ime ishte parimore, apo jo, jo, si të them, do të thotë, masa juaj është e pranueshme, e mirë, por shumë e vonë, mjerisht. Është dashur që të mos licencohet një numër i madh i universiteteve private, të cilat nuk i kanë plotësuar, nuk i plotësojnë kushtet për shkolla të mesme. Ju faleminderit shume!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet! Përsëri deputeti Riza Smaka, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi, ose për ministrin përkatës, do të thotë, të Punës dhe të Mirëqenies Sociale, zotin Nenad Rashiq.
Urdhëro, bëje pyetjen, deputet!

RIZA SMAKA: Trusti i pensioneve i Kosovës, në vend që të mbështetet në parimin dhe në premisën e solidaritetit, të reciprocitetit, të publicitetit, mbështetet në premisa tekno-burokratike. Kjo është e padiskutueshme. Ndërkohë, ai trust ka krijuar e ka prodhuar humbje marramendëse mbi 30 milion euro, para të pensionistëve të nëpërkëmbur e të neglizhuar të Kosovës, të cilët kanë pensione trupërisht të ulëta.

Ju lutem, zoti ministër, çfarë është opinioni juaj dhe, athua, a keni ndërmend të ndërmerrni masa juridike e efikase kundër atyre që abuzojnë me parane e pensionistit kosovar jashtëzakonisht të përulur edhe të nëpërkëmbur? Ju faleminderit!

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

Poštovani gospodine Riza,

Ja stvarno nemam drugi odgovor da vam dam, osim toga da Ministarstvo za rad i socijalnu politiku nema nikakve veze sa tim fondom. Verovatno ste vi bolje upoznati, da oni rade, da ne podnose izveštaj Parlemnetu Kosova, tako da sigurno ne mogu ništa osim toga da vam kažem.

A što se tiče mog mišljenja, naravno, ja kad sam to čuo, to je jedno od velikih grešaka ili turbulencija, da ih nazovem, na tom tržištu tih finansija, tih fondova, prema tome, mogu da vam prenesem moju iskrenu zabrinutost zbog toga i moje iskreno nezadovoljstvo, a s druge strane, Ministarstvo za rad i socijalno politiku, tehnički nema nikakve povezanosti sa ovim fondom, niti ima nikakve jurisdikcije nad njim. Prema tome, mislim da sam delimično odgovorio na vaše pitanje. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!
Ke pyetje shtesë deputet? Urdhëro!

RIZA SMAKA: ...në përgjigjen e ministrit se e kuptoj konformitetin e Kushtetutës edhe të ingerencave të Ministrisë, por megjithatë do t'i kisha kërkuar ministrit që në Qeveri ta ngrejë këtë çështje, Qeveria si ekzekutiv t'i ndërmarrë masat të cilat do të

mund t'i ndërmerre, se është fjala për 30 milionë euro para të pensionistëve të ngratë. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Ju faleminderit! Kur nuk keni pyetje, është mirë të na kurseni prej komenteve.

Deputetja Drita Maliqi, pyetje për ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, zotin Sadri Ferati.

Deputete, mund ta bëni pyetjen!

DRITA MALIQI: Po zoti Kryetar, ju faleminderit!

I nderuari zoti ministër,

Ligji për barazi gjinore e ka paraparë që në kuadër të kuvendeve komunale të ekzistojnë zyrat për barazi gjinore, por në bazë të një udhëzimi administrativ shkelet në mënyrë flagrante Ligji për barazi gjinore, neni 4.15. Sipas këtij udhëzimi administrativ, në kuadër të kuvendit komunal tani po funksionojnë vetëm njësitë për të drejtat e njeriut. Pse keni lejuar që të shkelet Ligji dhe çka do të ndërmerreni që Ligji për barazi gjinore të impementohet? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër, urdhëro, e ke fjalën!

MINISTRI SADRI FERATI: I nderuari Kryetar,

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete,

Në vitin 2005 Qeveria e Kosovës mori vendimin për krijimin e njësive për të drejtat e njeriut në nivelin qendror të qeverisjes me qëllim të krijimit të një sistemi të qëndrueshëm për mbrojtjen të drejtave të njeriut në institucionet e Kosovës.

Lidhur me këtë, pengesa kryesore e identifikuar në nivelin lokal ishte mungesa e një strukture homogjene që ka të bëjë me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, sepse në disa komuna ekziston një zyrtar për mundësi të barabarta, pozitat e të cilit ishin krijuar nga Udhëzimi administrativ 2003/12 mbi procedurat e mundësive të barabarta. Ndërsa, në disa komuna ekzistojnë pozitat e zyrtarëve për barazi gjinore, të krijuara nga Ligji për barazi gjinore 2004/12.

Nga evidentimi i gjendjes në terren është konstatuar se të gjitha komunat kanë zyrtarë për barazi gjinore, mirëpo procedurat e rekrutimit, përsëkrimet e detyrave dhe koficientët e pagës nuk ishin të harmonizuara. Madje, disa prej këtyre zyrtarëve në të njëjtën kohë kryejnë edhe punën e zyrtarit për mundësi të barabarta, punën e zyrtarit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve apo punonin edhe në pozitat të tjera dhe, si pasojë e kësaj, në disa raste puna e zyrtarit për barazi gjinore bëhej punë sekondare.

Natyrisht, të gjitha faktet e lartpërmendura reflektonin në domosdoshmërinë e krijimit të një strukture të qëndrueshme dhe unike për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivelin lokal të qeverisjes.

Lidhur me këtë, është krijuar njësia për të drejtat e njeriut në komuna. Këto njësi do të mundësojnë ekzistimin e një strukture më të fortë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel komunal, që u përgjigjet nevojave për zbatimin e strategjive dhe të planeve të veprimtimit për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, identifikimin e linjës së

komunikimit në mes të nivelit qendror dhe atij lokal që ka të bëjë me të drejtat e njeriut. Njëkohësisht, kjo do të rezultojë në sistemizimin efektiv të resurseve njerëzore ekzistuese në komuna kur kemi parasysh kufizimet buxhetore të komunave në këtë drejtim, të rritjes së numrit të punëtorëve në administratën komunale. Përveç kësaj, funksionalizimi i njësive për të drejtat e njeriut në komuna do të fuqizojë rolin e të gjithë zyrtarëve ekzistues komunalë për të drejtat e njeriut, ku përfshihen zyrtari për barazi gjinore, ai për të drejtat e fëmijëve, zyrtari mundësi të barabarta, për persona me aftësi të kufizuara, kundër diskriminimit, kundër trafikimit me qenie njerëzore, barazia e gjuhëve, pra që të shtatë fushat. Prandaj, krijimin e kësaj njësie për të drejtat e njeriut në nivelin komunal, me 3 deri 5 zyrtarë, MPL-ja e konsideron si mekanizëm të domosdoshëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke përfshirë këtu barazinë gjinore e cila, njëkohësisht, konsiderohet pjesë përbërëse e lirive dhe të drejtave të njeriut. Natyrisht, tani...

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputete, ke pyetje shtesë? Urdhëro!

DRITA MALIQI: Vetëm një koment të shkurtër, zoti Kryetar, nëse më lejohet t'i drejtohem zotit ministër se çështja është se nuk po më intereson çka do të ndërmerrni, sepse ne plotësisht i përkrahim të drejtat e njeriut, por më intereson pse është shkelur ligji dhe neni 4.15 i Ligjit për barazi gjinore? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër, ke përgjigje? Urdhëro!

MINISTRI SADRI FERATI: Do të përsëris se jo vetëm barazia gjinore, por thashë, të gjitha 7 fushat që ka obligim Pushteti Lokal që të mbrojnë të drejtat e njeriut, krijojnë një administratë që komuna nuk e përballon dhe është shumë e drejtë që nxirren ligjet në këtë fushë, por asnjëherë në ligj nuk parashikohet rritja e administratës nëpër komuna. Jo vetëm fusha e mbrojtjes së të drejtave dhe të lirive të njeriut, por kemi edhe disa fusha të tjera. Mund t'i identifikoj 5-6, që në nivelin qendror të përshkruhet më mirë funksionaliteti dhe gjithmonë parashihet rritja e administratës, por komunës asnjëherë nuk i lejohet që ta rritë administratën. Prandaj, duhet të kuptojmë tash që të shtatë fushat janë ndërtuar në një zyrë me 3 deri në 5 zyrtarë dhe e kryejnë mirë funksionin e tyre. Përndryshe, po të zbatojmë të gjitha normat, pra ligjet që obligojnë, atëherë komunës do të ishte dashur t'ia lejojmë edhe 10 deri 15 administrator në rritje për që të mund të realizohen të gjitha këto obligime që i kemi, prandaj kjo zyrë do t'i përfshijë të gjitha këto të drejta dhe do ta luaj mirë rolin e vet.

KRYETARI: Ju faleminderit!
Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin për Ekonomi dhe Financa, zotin Ahmet Shala, dhe për ministrin Punëve të Brendshme, zotin Zenun Pajaziti.
Zoti deputet, mund ta bëni pyetjen.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
Çështja është kjo: më 25 gusht u publikua lajmi se më 24 gusht është djegur arkivi i Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit. Sipas zëdhënësit të UNMIK-ut, zotit Ivanko, arkivi ka qenë e paprekur deri më 21 gusht, deri në momentin kur kosovarët, drejtuesit e AKP, Agjencionit Kosovar të Privatizimit, janë futur me forcë në objektet e ish AKM-së. Ndërsa, sipas udhëheqësve të AKP-së, kur janë futur drejtuesit e AKP-së në ish

objektet e AKM-së, gjendja ka qenë katastrofave, gjithçka e rëndësishme prej arkivit është shkatërruar dhe djegur.

Pyetja: Kur do të na zbardhni këtë rast, duke marrë parasysh rëndësinë e arkivit, sidomos lidhur me aligacionet për korrupsion dhe hajni gjatë procesit të privatizimit? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTËR ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti Tali,

Më lejoni t'ju informoj se Ministria e Punëve të Brendshme, përkatësisht Policia e Kosovës, ka marrë, ka ndërmarrë veprime të nevojshme me qëllim të grumbullimit të informatave dhe të provave për qëllimin e zbardhjes së këtij rasti.

Më lejoni t'ju informoj, po ashtu, se edhe pse ne kemi asistuar ose Policia ka asistuar në instalimin e Agjencionit tonë në objekt ku tani ajo vepron ose ku ka vepruar më parë AKM, nuk kemi pasur ndonjë kresë të veçantë për çështjen e dokumentacionit dhe më lejoni t'ju them po ashtu se asnjë kërkesë deri më tash nuk ka ardhur me një shqetësim të tillë nga Agjencioni ynë për të vërtetuar apo për të shikuar hetime lidhur me dokumentacionin i cili është bërë publik.

Reagimi ynë ka qenë i menjëhershëm pas asaj që edhe ne e kemi parë të bërë publike nga mediat tona.

Në bazë të hetimeve preliminare del se nuk mund të jepet ndonjë vlerësim se mbeturinat e dokumentacionit të djegur kanë të bëjnë me dokumentacionin e rëndësishëm të AKM-së, nga fakti se ende nuk është formuar një komision i përbashkët ndërmjet Agjencionit ekzistues dhe atij të mëparshëm, i cili do të vërtetonte se a mungon apo jo dokumentacioni i rëndësishëm.

Po ashtu, ne jemi të informuar nga UNMIK-u se dokumentacioni origjinal dhe serverët e arkivit elektronik janë të sigurt dhe të njëjtat janë tërhequr nga zyrtarët e AKM-së, dhe se çdo dokument, që është kopje fizike, është i ruajtur edhe në mënyrë elektronike dhe se ky dokumentacion dhe serverët do t'i dorëzohen së shpejti Agjencionit Kosovar të Privatizimit. Në rast se pas pranim-dorëzimit të dokumentacionit vërtetohet se mungon ndonjë dokument i rëndësishëm, atëherë policia do të marrë veprime të hollësishme hetimore. Prandaj, pa u bërë pranim-dorëzimi i dokumentacionit në mes AKM-së dhe AKP-së, nuk mund të konstatojmë se kemi të bëjmë me dyshim të bazuar se është kryer vepër penale sipas Kodit penal, përkatësisht nenit 323, - Marrja apo asgjësimi i vulave dhe shkresave zyrtare, dhe nenit 324, - Asgjësimi apo fshehja e materialit arkivor. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Deputet, ke pyetje shtesë?

DRITON TALI: Zoti ministër, unë do t'ju rekomandoja që këto që i thatë, t'i kishit thënë më herët për shkak se me të vërtetë në opinion është një, mos të them panik, por

është një brengosje e madhe se diçka e madhe atje është kah zihet. E thashë dhe po e përsëris edhe një herë, tentohet që të fshihen gjurmët e hajnisë që ka ndodhur gjatë procesit të privatizimit, të paktën kështu është kah merret në komunitetin afaristëve, mendoj këtu në Kosovë.

Do të ishte shumë më mirë sikur të reagonit me kohë për t'i sqaruar dilemat të cilat me të vërtetë qytetarët, sidomos ndërmarrësit, është kah i preokupon. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Deputeti Naim Rrustemi, pyetje për ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi.

Zoti deputet, e ke fjalën!

NAIM RRUSTEMI: Ju faleminderit!

E nderuara ministre,

A ka plan Ministria e Drejtësisë për kthimin e funksionalitetit të organeve të judikaturës në territorin e Mitrovicës? Nëse po, cili është ai plan, nëse jo, pse nuk keni plan?

KRYETARI: Ministre, e keni fjalën!

NEKIBE KELMENDI: Së pari dua ta njoftoj deputetin e nderuar, zotin Naim Rrustemi se Ministria e Drejtësisë nuk i menaxhon gjykatat, sepse ato janë të pavarura tërësisht. Ato i menaxhon Këshilli Gjyqësor Prokurorial. Kështu që nuk ka pasur nevojë as të kemi plan apo strategji për funksionalizimin e gjykatave në Veri të Mitrovicës. Sido që të jetë, Ministria e Drejtësisë është e interesuar dhe ka kontaktuar disa here dhe është në përpjekje për t'i rifunksionalizuar ato gjykata.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministre!

Keni pyetje shtesë, deputet?

NAIM RRUSTEMI: Nuk e di a do të jetë pyetje, por koment gjithsesi. Ia përkujtoj ministres se ministrja e Drejtësisë është eksoficio anëtare e Këshillit Gjyqësor, një, dhe, e dyta, organet e judikaturës përfshijnë gjyqet, përfshijnë Prokurorinë dhe burgjet, e besoj se ministrja e Drejtësisë e di se menaxhon me burgje.

KRYETARI: Ministre, keni përgjigje në koment?

NEKIBE KELMENDI: Është e vërtetë se jam anëtare eksoficio, mirëpo ai Këshill nuk drejtohet prej një anëtari, por drejtohet prej shumë anëtarëve dhe ka kryetarin e vet dhe sekretarinë e vet. Kjo është nën një. Nën dy, sa i përket burgut në Veri të Mitrovicës, ai funksionon dhe gjithnjë kemi raporte prej atij burgu për të gjitha ato që ndodhin, furnizohet dhe i nënshtrohet zinxhirit komandues të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Sa i përket Prokurorisë dhe organeve të tjera të judikaturës, duhet t'ju them se edhe Prokuroria është e pavarur dhe nuk menaxhohet nga ministrja e Drejtësisë, menaxhohet vetëm stafi administrativ i Prokurorisë.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministre!

Deputeti Naim Rrustemi, pyetje për ministrin Punëve të Brendshme, zotin Zenun Pajaziti.

NAIM RRUSTEMI: I nderuar ministër,

A ka plan Ministria e Punëve të Brendshme për vendosjen e rendit dhe të ligjit në Veri të Kosovës, nëse po cili është ai plan? Nëse jo, pse nuk keni plan?

KRYETARI: Urdhëroni, ministër!

ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit shumë për pyetjen zoti Rrustemi! Tashmë ju jeni në dijeni që situata e sigurisë në Kosovë është menaxhuar mirë falë institucioneve të Kosovës, pa dallim, dhe qytetarëve të saj. Ju e dini po ashtu dhe jeni të vetëdijshëm me vet faktin se pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, zbatimi i saj ka vështirësi dhe sfida në disa pjesë të Kosovës, me theks të veçantë në pjesën veriore të vendit. Sidoqoftë, ne institucionet e Kosovës e kemi bërë të qartë se do të ushtrojmë autoritetin në gjithë Republikën e Kosovës dhe këtu nuk ka hapësirë për interpretime apo vlerësime të tjera.

Tanimë, përveç se jemi të obliguar me Kushtetutë, ekziston një përkushtim dhe gatishmëri e institucioneve shtetërore të Kosovës dhe të partnerëve ndërkombëtarë për të shtrirë autoritetin edhe në atë pjesë të vendit, por duke ndjekur një qasje të matur dhe graduale.

Mungesa e autoriteteve të doganave në pikat 1 dhe 31, si rezultat i shkatërrimit të bërë me datën 19 shkurt 2008, dhe presioneve të vazhdueshme ndaj tyre, e kanë vështirësuar dukshëm punën e Policisë së Kosovës, luftimin e kontrabandave, kontrabandës së mallrave, gjë që po ndikon negativisht në realizimin dhe planifikimin e të hyrave buxhetore në Republikën e Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Punëve të Brendshme është duke koordinuar aktivitetin me prezencën ndërkombëtare në Republikën e Kosovës, me qëllim të normalizimit të gjendjes në atë pjesë. Në këtë kontekst, të gjitha planifikimet e strukturave vendore e ndërkombëtare të sigurisë janë të mbështetura në plan veprime konkrete, të cilat po zbatohen me qëllim të sigurimit, të vendosjes së rendit dhe të ligjit në gjithë territorin, ndërsa jo vetëm Policia, por ne po punojmë me të gjithë mekanizmat institucional që të kemi një mobilizim të përgjithshëm që të forcojmë sundimin e ligjit dhe të sigurojmë rendin dhe qetësinë publike për të gjithë qytetarët, pa dallim, në gjithë territorin.

Më lejoni t'ju them që luftimi i krimit të organizuar, tashmë e dini se është prioritet i Qeverisë sonë. Ministria e Punëve të Brendshme ka filluar përgatitjet dhe tanimë është në fazë të rëndësishme. Një strategji kundër krimit të organizuar.

Ne jemi përcaktuar dhe nuk do të lejojmë që asnjë pjesë të shndërrohet në oazë të krimit të organizuar. Kemi plane operative të Policisë dhe mund t'ju them që kemi bashkëpunim të fuqishëm me mekanizmat ndërkombëtarë për ta luftuar krimin e organizuar. E kemi, ju e dini, kemi proklamuar në politikat tona se qëllimi kryesor është për t'i mbështetur edhe qytetarët atje, në radhë të parë qytetarët serbë, të cilët kanë ngelur si peng i këtyre veprimeve, kryesisht të krimit të organizuar atje, dhe ne e kemi obligim...

KRYETARI: Zoti deputet, keni pyetje shtesë?

NAIM RRUSTEMI: Me qenë se keni plan, kur do të jetë afati kohor kur do të zhvendoset doganimi i mallrave që futen nga Serbia, nga pika rreth Fabrikës së akumulatorëve në Mitrovicë, nga pika mbi fshatin Çabër në pozicionet 60 kilometra përtej asaj pike? Planet kanë afate kohore.

ZENUN PAJAZITI: Dëshiroj t'ju them po ashtu që, të vazhdoj përgjigjen time, që është me rëndësi një mbështetje e fuqishme që na vjen nga Misioni evropian i sundimit të ligjit dhe ata do të na mbështesin fuqishëm në këtë drejtim. Po ashtu dëshiroj t'ju them që planet tona të Policisë, konsistojnë kryesisht në pengimin kontrabandimit, që ju thashë, dhe çështja e doganave dhe e organeve të tjera të sundimit të ligjit, është çështje e një procesi që po vazhdon vendosjen dhe rivendosjen atje. Mendoj që për t'u bërë publike, keni në kronikat e Policisë përditë aksionet e Policisë në pengimin e kontrabandës dhe të vijave të ndryshme që qarkullojnë tash në gjithë atë pjesë.

Dëshiroj t'ju them që po ashtu është me rëndësi në këtë drejtim se ka filluar funksionimi i Këshillit për funksionimin e ligjit në Kosovë, ku jemi disa mekanizma bashkë dhe një prej pikave të agjendës tonë është pikërisht edhe kjo që ju e shtroni. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Pyetja e radhës, deputeti Hydajet Hyseni, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe Financave, zotin Ahmet Shala, që nuk është këtu.

Deputet, doni ta lexoni pyetjen apo po e kalojmë? Ju faleminderit!

Edhe ministria e Energjetikës nuk është këtu. Po kalojmë përsëri te pyetja e 19-të, deputeti Hydajet Hyseni, pyetje për ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi.

Urdhëro, bëje pyetjen, deputet! Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit!

E nderuara ministre, pyetja ime për Ministrinë është: Çka ka ndërmarrë Qeveria dhe Ministria e Drejtësisë për funksionalizimin e institucionit të amnistisë, abolimit, faljes dhe zbutjes së dënimit dhe realizimit në këtë mënyrë të premtimeve dhe të zotimeve të marra zyrtarisht dhe bashkërisht e publikisht nga përfaqësuesit e Qeverisë?

KRYETARI: Zonja ministre, e keni fjalën!

NEKIBE KELMENDI: Përgjigje në këtë pyetje të deputetit, zotit Hydajet Hyseni do ta filloj nga ajo që Ministria e Drejtësisë ka premtuar zyrtarisht. Pra, fjala është për Ligjin për faljen. Ky Ligj ka qenë i përgatitur dhe është dorëzuar në Qeveri ditën kur është zhvilluar biseda me përfaqësuesit apo Këshillin grevist të të burgosurve, të hedhur në grevë, më 23 qershor 2008. Mirëpo, pas dorëzimit të këtij ligji është kuptuar se është gabuar titulli i Ligjit në raport me strategjinë, e në këtë kontekst edhe brendia, sepse amnistia nuk është e paraparë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, kështu që si e tillë edhe nuk është hartuar në formë të ligjit.

Sa i përket Ligjit për falje, ligji është dorëzuar, besoj se do të jetë në procedurë parlamentare shumë shpejt dhe do t'ia bëj një lutje speciale Kryesisë së Parlamentit që ta marrë me përparësi dhe ta miratojë këtë ligj në mënyrë sikur që i ka miratuar ligjet nga pakoja e Ahtisarit.

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputet, ke pyetje shtesë?

HYDAJET HYSENI: Zonja ministre, duke pasur parasysh faktin se keni qenë një nga drejtueset e procesit kushtetutbërës, pse atëherë nuk u lejua që Kushtetuta të plotësohet edhe me këto që i mungojnë Kushtetutës, një, dhe, e dyta, e konsideroni ju tash pse nuk qenka përmendur edhe amnistia edhe zbutja e dënimit, se tash është e pamundshme që ato të funksionalizohen edhe pse ne na obligojnë për t'i realizuar standardet ndërkombëtare të drejtësisë dhe dokumentet universale të cilave iu referohet Kushtetuta.

Ju tërheq edhe vërejtjen se në dokumentin e Rambujesë sa e sa vjet më parë, neni 12, Kosova ka qenë e obliguar të implementojë instrumentin e amnistisë për kategoritë që janë paraparë atje? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!
Ministre, e ke fjalën përsëri! A ke përgjigje?

NEKIBE KELMENDI: Po, kam përgjigje. Për Kushtetutën është bërë debat publik. Ju keni mundur t'i bëni këto vërejtje gjatë debatit publik, nën një, nën dy, në Ligjin për amnistinë pikërisht për këtë arsye nuk ka paraparë në strategjinë e vet as Qeveria, sepse ka qenë shumë e vëmendshme, se një gjë e tillë nuk mund të bëhet për shkak se nuk është përfshirë në Kushtetutë.

KRYETARI: Ju faleminderit!
Deputeti Hydajet Hyseni, pyetje për ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi.
Urdhëro, parashtroje pyetjen e dytë!

HYDAJET HYSENI: Zonja ministre, pse po zvarritet për vite të tëra, edhe tash pas kushteve të krijuara për një avancim në këtë fushë, Projektligji për Gjykatat, si dhe ai për Prokurorinë Publike dhe, rrjedhimisht, edhe procesi i verifikimit të drejtësisë në Kosovë, dhe sa ndikon kjo zvarritje në procesin e transformimit të sistemit të drejtësisë në Kosovë?

KRYETARI: Ministre, e keni fjalën!

NEKIBE KELMENDI: Projektligji për gjykatat dhe Prokurorinë e shtetit, janë ligjet e përfshira në strategjinë legislative të Qeverisë së Kosovës, të kësaj Ministrie për vitin 2008.

Zyra Ligjore e Ministrisë së Drejtësisë është duke punuar, jo vetëm në këto ligje, por edhe në një pako ligjesh të cilat duhet t'i paraprijnë reformës gjyqësore. Këto ligje janë shumë të rëndësishme për fillimin e reformës gjyqësore, andaj kërkohet një qasje më serioze dhe përfshirje e gjerë e ekspertëve vendorë e ndërkombëtarë për draftimin e tyre. Ne jemi në përfundim të draftimit të të gjitha ligjeve, të cilat i paraprijnë fillimit të reformës së drejtësisë dhe këto do t'ia dorëzojmë Qeverisë për miratim brenda afatit të caktuar me strategjinë ligjore të Qeverisë, kështu që Ministria e Drejtësisë nuk është me vonesë në draftimin e ligjeve të cekura në pyetjen e deputetit, zotiti Hydajet Hyseni.

KRYETARI: Ju faleminderit! Keni pyetje shtesë? Urdhëro!

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit! Dua ta informoj Kuvendin, ministrja e di se projekti për gjykatat dhe ai për Prokurorinë ka vite që qëndrojnë në zyrat e qeverive

tona. Por, një pyetje shtesë, në të cilën mendoj se ministrja duhet të përgjigjet dhe u harrua: Çka po ndodhë me procesin e verifikimit, një proces që vendet e tjera e kanë kryer dhe ka pasur shumë efekte pozitive?

KRYETARI: Zonja ministre, e keni fjalën!

NEKIBE KELMENDI: Nëse bën të sqarohet për çfarë verifikimi është fjala?

KRYETARI: Fjalën e ka Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Është procesi i mirënjohur i shpallur zyrtarisht edhe në këtë Kuvend, bashkërisht me Gjyqësorin dhe me partnerët ndërkombëtarë, Zyra Amerikane, USAID-i, Qendra shtetërore e gjykatave amerikane, po ashtu, ka ndihmuar për një proces të transformimit të drejtësisë dhe, në këtë kuadër, një proces të riemërimit dhe të verifikimit të gjyqtarëve, të prokurorëve dhe të bartësve të tjerë të funksioneve, një proces që e kanë kaluar të gjitha vendet në tranzicion.

KRYETARI: Zonja ministre!

NEKIBE KELMENDI: Riemërimi është i paraparë me Pakon e Ahtisarit. Ai riemërim akoma nuk ka filluar sepse kërkohet që të miratohet infrastruktura ligjore. Një pjesë është duke u bërë dhe po veprohet sipas standardeve që janë përcaktuar nga ato institucione që i përmendët, kurse emërimi i mirëfilltë do të bëhet pasa miratimit të infrastrukturës ligjore, e cila do t'iu paraprijë reformave në gjyqësi, kur do të bëhet emërimi i gjyqtarëve për tre vjet, më pastaj do të bëhet emërimi për një periudhë më të gjatë. Do të jetë ky trevjetëshi si një periudhë verifikuese për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët.

KRYETARI: Hydajet Hyseni, pyetje për ministrin e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, zotin Mahir Yagcilar.
Urdhëroni, bëjeni pyetjen deputet!

HYDAJET HYSENI: I nderuar ministër, pyetja në vijim është shqetësim i qytetarëve të disa lagjeve të Gjilanit, prandaj edhe unë e ndjej të nevojshme të pyes: Cila është qasja e Qeverisë dhe e Ministrisë përkatëse ndaj shqetësimeve dhe ankesave e kërkesave të qytetarëve të disa lagjeve të Gjilanit lidhur me gjendjen alarmante të krijuar në ato lagje si pasojë e mungesës së sistemit të grumbullimit dhe të trajtimit të ujërave të zeza të kanalizimit. Një gjendje vërtet e padurueshme nga përroskat dhe kanalizimet që derdhen nëpër këto lagje Çfarë masash janë ndërmarrë dhe çfarë planifikohet të bëhet në të ardhmen për sanimin e mjedisit në këto lagje të Gjilanit? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
I nderuari kryetar,
Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra dhe deputetë,

Zotëri Hyseni, problemi me ujëra të zeza është, për fat të keq, problemi i tërë Kosovës. Zgjidhja e tij implikon mjete të mëdha buxhetore dhe kërkon kohë. Pjesë e këtij problemi është edhe Gjilani, sikurse qytetet e tjera.

Për zgjidhjen e këtij problemi, Komuna e Gjilanit, përgjegjësi e së cilës është zgjidhja e infrastrukturës, kohë më parë ka hartuar një projekt i cili ka pretenduar ta zgjidhe këtë problem.

Vlera e përgjithshme e investimeve sipas këtij projekti është rreth 4 milionë euro. Këtë projekt, vitin e kaluar Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e ka marrë për ekzekutim. Ministria, gjithashtu, ka ndarë fonde për këtë qëllim dhe ka shpallur tenderin për realizimin e këtij projekti. Mirëpo, realizimi i tij po hasë në vështirësi të shumta, duke filluar nga ajo se projekti ka qenë i pareviduar, projekti ka pasur shumë mangësi, të cilat gjatë zbatimit kanë dalur në pah, nuk është bërë elaborati gjeomekanik i terrenit. Ky elaborat ishte bërë vetëm pas kërkesës së Organit mbikëqyrës të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Për shkak të këtyre gabimeve dhe të gabimeve të tjera, faza e parë e projektit është reduktuar.

Vëllimi i punëve, në vend të rregullimit të 476 metrave gjatësi me shumë mjeteve të destinuara për këtë fazë, kanë mund të rregullohen vetëm 300 metra.

Zvarritjen e projektit e kanë bërë edhe kontestet pronësore. Deri me tani janë përfunduar, mund të them 60% të punëve. Vlera e kontratës për Ministrinë ka qenë 238.000 euro, data e nënshkrimit të kontratës ka qenë 6 korrik të vitit të kaluar ose të vitit 2007. Afati i punimeve ka qenë 85 ditë. Pra, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka qasje, ka ndërmarrë veprime dhe planifikon të vazhdojë edhe më tutje derisa të rregullohet ky problem. Por, ne si Ministri ose Qeveri mund të themi se nuk kemi i vetmi autoritet në këtë çështje, janë edhe komuna, ata që duhet më shumë të bëjnë, sepse infrastruktura dhe çështjet e tjera janë në përgjegjësi direkte të komunave.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Zotëri deputet, ke pyetje shtesë? Nuk ke. Të faleminderit!

Ne po shkojmë vetëm me pyetjet që janë bërë për ministrat që janë këtu. Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për ministrin Shëndetësisë, zotin Alush Gashi.

Deputete, mund ta bëni pyetjen!

Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Zoti ministër, pyetja ime ka të bëjë për një çështje shumë të rëndësishme, siç janë grevat e sindikalistëve të shëndetësisë dhe kërkesat e tyre të arsyeshme.

Kërkesat e tyre kanë të bëjnë me rritjen e pagës deri në 50%, hartimin e ligjeve dhe aprovimin e tyre, siç janë: Ligji për sigurimet shëndetësore, Ligji për punën, Ligji për greva dhe Ligji për organizimin sindikal. Prandaj, për përgjegjësitë që i keni, si ministër, cilat nga këto kërkesa të sindikalistëve do t'i plotësoni dhe kur? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ALUSH GASHI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Ju falënderoj për pyetjen. Një prej pyetjeve, ndoshta më të rëndësishme në këtë fazë të funksionalizimit të sistemit shëndetësor në Republikën e Kosovës.

Nuk është e tepërt të thuhet se që nga viti 2001, pagat në shëndetësi, por as të pjesës dërmuese të shërbyesve civilë, nuk janë rritur. Nuk ka pasur mundësi, më duket deri më tani, as të jetë kompensimi i inflacionit gjatë këtyre viteve, andaj edhe kërkesa për përmirësim të standardit jetësor, për rritje të pagave, është një kërkesë e cila kuptohet shumë drejt në Qeveri, por besoj që kuptohet drejt edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Natyrisht, ne të gjithë jemi të lidhur me zhvillimin ekonomik të vendit tonë, e në kuadër të zhvillimit ekonomik të vendit tonë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave është në një bashkëpunim shumë të ngushtë me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Sa i përket Sindikatës, që nga dita e parë në Ministrinë e Shëndetësisë kemi një dialog të vazhdueshëm me Kryesinë e Sindikatave të Shëndetësisë. Kërkesa e Sindikatës për Ligjin për sigurime shëndetësore është një kërkesë e jona, po ashtu, është një kërkesë e tërë Kuvendit dhe e Qeverisë, sepse Kuvendi e ka votuar atë ligj dhe për shkak të implikimeve buxhetore, në qershor të vitit 2007, përfaqësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm nuk e ka nënshkruar atë ligj, dhe pas asaj është bërë një rihulumtim, sepse Ligji nuk e ka pasur koston buxhetore.

Kostoja buxhetore për atë ligj është 154 milionë euro. I tërë buxheti i Republikës së Kosovës për tri nivelet, nivelin primar, sekondar dhe terciar është diku 80 milion.

Që nga fillim i këtij mandati kemi bashkëpunuar me Bankën Botërore, kemi organizuar konferencën më 11 prill, më 13 maj, dhe si rezultat i këtij komunikimi është studimi i publikuar i Bankës Botërore për mënyra se si Banka Botërore, Fondi Monetar e sheh çështjen e Ligjit të sigurimeve shëndetësore.

Menjëherë pas kthimit të Ligjit për rihartim, kam themeluar Komisionin për hartimin e këtij ligji dhe në atë komision kemi lutur që të jetë edhe Sindikata e përfshirë. Janë ekspertë më të mirë të vendit...

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër, e ke harxhuar kohën!
Deputete, ke pyetje shtesë?

GJYLNAZE SYLA: Zoti ministër, sa do t'ua rrisë Qeveria rrogat punëtorëve shëndetësorë, a është në gjendje 50%, apo Qeveria ka konkret ndonjë ofertë tjetër?

Dhe, tjetra është se ju thatë që keni formuar Komisionin. Në agjendën legjislative që ka ofruar Qeveria për vitin 2008, nuk është asnjë ligj nga Ministria e Shëndetësisë. Nga aspekti kohor, kur do të procedohet në Kuvend? Ju faleminderit!

ALUSH GASHI: Ju faleminderit! Ne nuk e kemi pasur në agjendën legjislative, sepse ky ligj është votuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kjo ka qenë e vetmja arsye.

Nën dy, ne jemi të bindur që gjatë këtij viti do ta kemi Ligjin, por sigurisht do ta kemi në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Sa i përket çështjes së rritjes së pagave, dialogu me Sindikatën është i vazhdueshëm. Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës ka marrë përsipër që së bashku me ministrin për Ekonomi dhe Financa dhe me tërë Qeverinë, t'i shtrojë të gjitha mundësitë në kuadër të zhvillimit ekonomik të vendit tonë që kjo kërkesë të plotësohet në kohën dhe në afatin sa më të shkurtër që të jetë mundshme.

KRYETARI: Të nderuar deputetë, koha për pyetjet parlamentare ka kaluar. Tani propozoj një pauzë për një kafe, e pastaj vazhdojmë punën.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Të nderuar deputet, tani kemi në radhë

- Shqyrtimin e Raportit vjetor të punës së Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2007

Komisioni i Pavarur për Media, në pajtim me Ligjin për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim i ka paraqitur Kuvendit Raportin vjetor të punës për vitin 2007.

Komisioni për Shërbime Publike dhe Administratë Lokale dhe Media e ka shqyrtuar Raportin vjetor të Punës së Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2007 dhe ka rekomanduar që të radhitet për shqyrtim në seancën plenare.

Po ashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Raportin vjetor të punës së Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2007 dhe ka rekomanduar që të radhitet për shqyrtim në seancën plenare.

Rekomandimi i komisionit funksional së bashku me raportin e Komisionit të Pavarur për Media u është shpërndarë deputetëve.

Fjalën e ka kryetari i komisionit funksional, zoti Esat Brajshori.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë,

Në emër të Komisionit parlamentar për Media, ne kemi shqyrtuar raportin e KPM-së. Ka pasur kritika të mëdha nga deputetët, kemi kërkuar që të plotësohet nga ato që ne kemi menduar se nuk janë të plota në raport. KPM-ja ka marrë parasysh këtë gjë dhe na ka kthye pastaj një lloj përgjigje dhe në emër të Komisionit ne kemi marrë vendim që çështja ose raporti i KPM-së për vitin 2007 të procedohet në seancë plenare dhe nga ky debat të vihet në konkluzion në lidhje me punën e KPM-së për vitin 2007. Kaq do të thosha si kryetar i Komisionit.

Ndërkaq, në emër të Grupit Parlamentar do t'i shfaqim objeksionet më vonë. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit!
Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, zoti Gani Koci, a e do fjalën?

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Komisioni për Buxhet, në mbledhjen e vet të mbajtur më 11.7.2008, ka shqyrtuar raportin sa i përket pjesës buxhetore. Duhet pasur parasysh se ky Komision ka qenë deri vonë kompetencë e rezervuar dhe tek me Ligj pastaj është institucion që i përgjigjet Kuvendit. Në pjesën financiare të këtij Komisioni, ky iu ka përgjigj Ligjit për menaxhimin e financave publike lidhur me raportimet financiare dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik dhe, si të tillë, Komisioni e ka përkrahur dhe ia ka rekomanduar Kuvendit që ta shqyrtojë. Ajo që është shqetësuese për këtë Komision, me siguri gjatë diskutimeve do të thuhet, në kuptimin e nxjerrjes së rregulloreve mbi tarifat e licencimit dhe të krijimit të një fondi, siç e thotë edhe Ligji, nga këto tarifa ose nga gjobat që mund të mblidhet. Rreth kësaj nuk kemi pasuar një raport nga ky Komision i Mediave dhe ne, si Komision, kemi kërkuar që vërtet të plotësohet raporti lidhur me këtë çështje.

Qëndrimi i tyre ka qenë se në vitin paraprak ata nuk kanë pasur të hyra nga këto licenca dhe kjo ka qenë arsyeja pse nuk është futur në raportin e buxhetit. Por, vërejtja qëndron se në raportimet e tjera duhet të përfillin në mënyrë të përpiktë Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe mënyrën e raportimit financiar.

KRYETARI: Faleminderit!

Radha është e shefave të grupeve parlamentare.

Sipas radhës, kush e do fjalën në emër të Partisë Demokratike. Fjalën e ka deputeti Hajdin Abazi.

HAJDIN ABAZI: Përshëndetje, zoti Kryetar,

Përshëndetje, të gjithë kolegë të nderuar,

Grupi Parlamentar i PDK-së e ka lexuar me vëmendje Raportin e KPM-së dhe është një nismë e mirë që ky Komision i drejtohet Kuvendit për të raportuar pasi që tash ka ndryshuar realiteti në Kosovë dhe kësaj duhet të vendoset rendi dhe rregulli.

Mirëpo, duke ditur se këtu është fjala për raportin e veprimtarisë së Komisionit për Media për vitin 2007, ka pasur pengesa të mëdha nga mosfunksionimi i bordit, janë manifestuar jo veprime konkrete dhe azhure në praktikë për të marrë masa ndaj shkelësve të frekuencave, për të ndaluar frekuencat ilegale, për të marrë masa që, për shembull, RTK-ja ta mbulojë gjithë territorin e Kosovës, e mangësitë të këtilla. Mirëpo, këto janë gjëra të cilat kanë ndodhur dhe është një realitet që nuk mund të rikthehet. Tani për sivej Bordi është i kompletuar dhe Kuvendi duhet të angazhohet që të kërkojë që KPM-ja të jetë më aktive në kryerjen dhe përmbushjen e obligimeve të veta.

Mirëpo, njëherësh është e nevojshme që edhe Ligji përmes të cilit rregullohet veprimtaria, përgjegjësitë, obligimet dhe angazhimet e KPM-së të riprocedohet, të merret në shqyrtim, të bëhen plotësime dhe të bëhet adekuat që ai të mund të funksionojë në mënyrë efikase dhe ta kryej detyrën e vetë si duhet.

Me këto vërejtje, Partia Demokratike e Kosovës, Grupi Parlamentar i yni do ta mbështesë këtë raport që të kalojë.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, shefi i Grupit, Lutfi Haziri, e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti zëvendëskryeministër, ministra,

Grupi Parlamentar i LDK-së mbështet në tërësi Raportin e dorëzuar sot, në veçanti çmon angazhimin e dy komisioneve funksionale të Kuvendit dhe i mbështet rekomandimet e tyre në funksionalizimin dhe në angazhimet apo rekomandimet që i kanë bërë për këtë organ të pavarur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit shumë!

Në emër të Grupit Parlament të AKR-së, deputeti Esat Brajshori e ka fjalën.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Tani Grupi Parlamentar i AKR-së sinjerisht është përpjekur që ta shqyrtojë me dinjitet këtë raport duke pasur parasysh rëndësinë që ka KPM-ja në lidhje me funksionin që duhet të kryejë. Duke pasur edhe unë personalisht të njohur këtë raport edhe nga shqyrtimi që ka bërë Komisioni për Media në mbledhjet e veta, edhe nga gjendja reale në terren, konstatoj se tregu medial në Kosovë është krejtësisht kaotik, po flasim për raportin 2007. Komisioni i Pavarur i mediave që është i thirrur për të vënë rregulla, për të dhënë licenca për transmetuesit, për të vënë në zbatim Ligjin mbi KPM-në, nuk ka arritur të tregojë kapacitete menaxhuese dhe të jetë i paanshëm. Është për t'u çuditur se si ka funksionuar KPM-ja sa i përket strukturimit të brendshëm kadrovik. As edhe një herë, që prej themelimit të këtij Komisioni nuk janë plotësuar të gjitha vendet drejtuese të këtij Komisioni. Si rezultat i kësaj, janë nxjerrë disa rregullore të brendshme që shumë nga kompetencat i janë deleguar shefit ekzekutiv të KPM-së. Prandaj, vendimet që janë marrë pastaj, ju mund ta merrni me mend se sa kanë qenë të balancuara, të drejta dhe joselektive.

Komisioni i Pavarur i Mediave ende nuk ka ndonjë rregullore për subjektet transmetuese që do të mbronte të miturit nga përmbajtja e programeve të cilat ndikojnë negativisht në zhvillimin e tyre fizik, mental dhe moral. Që të arrihet kjo, duhen grupe ekspertësh, saktësisht psikologësh, sociologësh, edukatorësh e të tjerë.

Ende kanë mbetur pa përgjigje të sakta ose janë dhënë përgjigje të justifikuara, shumë nga pyetjet që i ka shtruar edhe Komisioni për Media në lidhje me funksionimin e KPM-së. Nuk është dhënë përgjigje e saktë se çfarë zgjidhjesh ka ofruar KPM-ja ndaj transmetuesve të cilët kanë pasur probleme me interferencat, përfshirë këtu edhe interferencat që vijnë nga mediat serbe.

Çka ka ndërmarrë KPM-ja ndaj RTK-së, transmetuesit publik, për mos mbulueshmëri të frekuencave në komunat ku jetojnë komunitetet joserbe. Ju e dini se është një pjesë e mirë që RTK-ja nuk e mbulon një hapësirë të mirë të territorit të Kosovës, nëse nuk gaboj, diku mbi 12% . Sa ka qenë KPM-ja në koordinim me ART-në në menaxhimin e spektrit të frekuencave konform nenit 2.6 të ligjit në fuqi.

Licencimi i operatorëve kabllorë për të cilën gjë ligji e ka obliguar KPM-në që ta kryej që në vitin 2005, jo që nuk është bërë në të 2005-tën e as në të 2006-tën, por as në të 2007-tën, raportin e të cilit vit po e diskutojmë tani. Operimi pa licencë i kabllorëve për 3 vjet

me radhë, po them 3 vjet, që kur e ka obliguar ligji në fuqi, sepse operimi i kabllorëve është edhe më i hershëm, i ka kushtuar buxhetit të Kosovës me qindra mijëra euro.

Ligji në fuqi për mediat thotë se frekuencat duhet të ndahet me korrektësi në aspektin etnik, gjeografik e të tjera. Ndërkaq, edhe pse rreth 20 televizione, sa janë gjithsej në Kosovë, nuk arrijnë që ta mbulojnë sot aksin rrugor Prishtinë - Pejë që nga mbyllja e Radiotelevizionit të Mitrovicës.

Të jesh agjencion i pavarur, nuk do të thotë të jesh jashtë planetar, jashtë rregullave dhe jashtë ligjit.

Ne po flasim gjithmonë për raportin e KPM-së me këtë rast, pra për raportin për vitin 2007, e jo për punën e KPM-së gjatë këtij viti, sepse ne kemi parë lëvizje pozitive në këtë vit.

Të gjitha këto defekte të funksionimit të KPM-së në esencë janë rezultat i një ligji jofunksional ekzistues për KPM-në. Është në përgjegjësinë e këtij parlamenti si themelues i Komisionit të Pavarur të Mediave, që t'i fillojë procedurat për amendimin e Ligjit për RTK-në. Kështu, njëherë e mirë do të stabilizohet tregu medial në Kosovë i cili, tani për tani, është akoma në kaos.

Si grup Parlamentar, ne përkrahim këtë raport me konkluzionin dhe kërkesën që të fillojë procedura për amendimin e Ligjit për KPM-në. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Në Emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Rasim Selmanaj e ka fjalën.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisionin e Pavarur të Mediave vazhdojnë ta përcjellin një mori lëshimesh dhe vështirësish njëkohësisht në punë. Në KPM, siç u tha edhe nga kryetari i Komisionit, vërehet jo transparenca në funksionimin e brendshëm dhe në mungesë të anëtarëve të Bordit shumë përgjegjësi janë bartur te shefja e ekzekutivit, e kjo nuk është absolutisht në rregull dhe kujtoj që bie ndesh me rregulloren në fuqi për funksionimin e KPM-së.

Shqetësuese është fakti se që nga themelimi, KPM-ja nuk ka arritur të vendos një rregull në tregun medial në Kosovë. Në disa raste, KPM-ja ka marrë vendime selektive. Në njëërën anë, TV Mitrovicës ia merr licencën, ndërsa në anën tjetër, mediumeve serbe iu lihet hapësirë dhe nuk ka kontroll mbi to.

Unë mendoj se përkundër të metave dhe vështirësive në KPM, këtë vit vërehet një lëvizje e ndjeshme pozitive krahasuar me vitin e kaluar, por kujtoj se KPM-ja është larg vendosjes së një rregulli medial në Kosovë. Që kjo të ndodhë, duhet të bëhet një ligj i mirë dhe funksional konform standardeve të vendeve me demokraci të përparuar.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, me vërejtje të cilat mendoj se duhet të plotësohen dhe, duke shpresuar se do të nxirret një ligj, e përkrah këtë raport të KPM-së.

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, fjalën e ka kërkuar deputetja Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, Kryetar!

Unë diskutimin tim do ta fokusoj në dy qasje apo në dy rrafshe. Një, e para koha kur ne po diskutojmë për raportet në përgjithësi, mandej pjesa tjetër do të jetë ndoshta shumë e shkurtër për raportin e KPM-së.

Se a ia vlen që ky raport të diskutohet në Kuvendin e Kosovës diku 9 muaj, do me thënë pas përfundimit të vitit kalendarik, sepse ne po i diskutojmë raportet për vitin 2007 dhe jemi diku në fundin e shtatorit të vitit 2008 nuk e di sa është një qasje e drejtë apo sa Kuvendi i Kosovës po vepron drejt konform institucioneve të pavarura apo konform ligjit mbi menaxhimin e financave.

Po ua rikujtoj, të nderuar kolegë deputetë, sepse Ligji mbi menaxhimin e financave parasheh rregulla të veçanta, ka kohë që thuhet se raportimi duhet të bëhet diku deri më 31 mars të vitit në vijim, sepse këto raporte është dashur të shqyrtohen diku kah 31 marsi i vitit 2008. Nëse kjo nuk ndodhë, atëherë afati i fundit për të raportuar është maji i vitit 2008. Mirëpo, ne jemi në muajin shtator të vitit 2008 dhe po vazhdojmë të shqyrtojmë raportet për vitin 2007. Raportet janë, fundja, edhe si rezultat apo si matje e performancës së funksionimi të një institucioni. Prandaj, nuk di a ia vlen që në fund të vitit ne të merremi me vitin 2007, por ndoshta do të kishte qenë mirë që t'i kalojmë edhe 3 muaj dhe 2 raportet së bashku, raportin për vitin 2007 dhe raportin për vitin 2008 ta shqyrtojmë në vitin 2009, po në fillim të vitit do t'i japim rekomandimet tona. Prandaj, unë këtu shoh një papërgjegjësi apo një mosfunksionim të drejtë apo mosshqyrtim të drejtë të punëve konform këtyre raporteve në Kuvendin e Kosovës.

Sa i përket raportit të KPM-së, vërejtjet tona janë të shkurtra, por sido që të jetë, nuk do të shtoj më tepër se sa që e tha kryetari apo edhe anëtarët e komisionit funksional sepse së bashku i kemi nxjerrë rekomandimet tona.

KPM-ja nuk ka punuar me bord të kompletuar asnjëherë. Kjo ndoshta si pasojë ka sjellë dhe si rezultat ka qenë që shpeshherë shefja ekzekutive ka ndërmarrë vendime që kanë qenë të kundërligjshme, mirëpo ajo i ka zbatuar. Rast më i freskët që është shkelur më së shumti rregullorja ka qenë ndoshta edhe rasti me Televizionin e Mitrovicës, kur në mënyrë parciale është vepruar dhe i është ndërprerë puna këtij mediumi, ndërsa për shkelje të njëjta mediumet e tjera nuk janë prekur.

Ka edhe shkelje të tjera që, vërtet, shpresojmë që në të ardhmen Bordi i KPM-së të kompletohet dhe të punohet më drejt në këtë drejtim. Faleminderit!

KRAETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, fjalën e ka kërkuar deputetja Shpresa Murati.

SHPRESA MURATI: Hvala, gospodine predsjedniče!

Pozdravljam sve prisutne,

Izveštaj Nezavisne komisije za medije za 2007. godinu, u nekim delovima se puno nije razlikovao od izveštaja za 2006. godinu. Uočeni su isti ili slični nedostaci i propusti. Razlog može biti nekompletan Savet, ali to sigurno nije jedini razlog.

Komisija za javne službe i lokalnu administraciju i medije razmatrala je godišnji izveštaj i nakon sadržajne rasprave zaključila da je izveštaj uopšten, pa je zahtevala dodatno objašnjenje i dopune koje bi se ugradile u izveštaj. Nakot toga, dobili smo izveštaj sa dopunama i odgovorima na pitanja upućene od strane Komisije. Jedno od pitanja je, nažalost, ponovo bilo, šta je Nezavisna komisija za medije preduzela prema RTK-a, javnom emiteru zbog nepokrivanja teritorije gde pretežno žive ostale zajednice.

U odgovoru stoji da je Nezavisna komisija za medije, kao regulativna agencija, dužna da obezbedi javnom emiteru frekvencije za emitovanje kako bi RTK-a pokrivala 90% teritorije Kosova.

Glavna tačka za radio i TV emitovanje je Goleš, a RTK-a ne poseduje infrastrukturu za emitovanje TV signala za te tačke.

Nezavisna komisija za medije i RTK-a održale su sastanak na kojem je RTK-a iznela da postoji finansijski problem za oživljavanje tačke na Golešu i da je Skupština dužna da pomogne RTK-au, jer na osnovu Zakona, osnivač javne institucije RTK-a je Skupština Kosova, a osnivač je dužan da štiti institucionalnu autonomiju i nezavisnost uredništva RTK-a i obezbedi adekvatne finansije za realizaciju misije javnog servisa RTK-a.

S toga je zaista krajnje vreme da Skupština Kosova učini napore i iznadje mogućnosti kako bi se ovaj problem napokon rešio, jer zaisto je absurd da stanovnici regije sa pretežno bošnjačkom zajednicom i dalje plaćaju za usluge koje ne dobijaju iako je zakonom o RTK-a uređeno da se ti stanovnici, odnosno stanovnici tih regija oslobode TV preplate do uspostavljanja signala.

Parlamentarna Grupa „7+“ podržaće ovaj Izveštaj Nezavisne komisije za medije, ali se iskreno nada da neće više imati iste primedbe i prilikom razmatranja izveštaja za 2008. godinu sledeće godine. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Nga Grupi Parlamentar SLS, nuk janë lajmëruar.

Vazhdojmë me deputetë. Deputeti i radhës është Numan Baliqi.

NUMAN BALIĆ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Smatram da je ovo jedno vrlo važno pitanje koje se tiče djelovanja medija na Kosovu od kojega zavisi ne samo rad Nezavisne komisije za medije, nego zavisi rad medija, a kao što svi znamo, medije u obliku javnog mjenja utiču na svijest ljudi, utiču na to kako ćemo se ponašati. U krajnoj liniji, opredeljenju stanja u jednom djelu čitave jedne nacije, prema tome pitanje je izuzetno značajno.

Upravo zato što je ovo pitanje značajno, ja nisam otišao na džumu i nadam da se da će bog da mi oprostiti, a ako budem odgovoran, onda će predsednik Parlamenta odovarati.

Dalje, da nastavim oko ovog važnog pitanja, da se usredsredim na suštinu. Komisija za medije, i ako je nova Komisija, ona bi trebala preuzeti ulogu koju stvarno treba da ima. Ja čak smatram da Komisija za javne službe, administraciju i medije ne bi se trebala baviti svima ovima trima stvarima, nego bi trebala imati samo jedna komisija za medije, a da se odvoji u drugu komisiju ovo ostalo što sam spomenuo.

Mislim da svi trebamo poržati predsjednika Komisije, gospodina Brajšorija u njegovoj nakani, da ova Komisija konačno, kao i Parlament Kosova, preuzmu svoju stvarnu ulogu, zato što u oblasati medija imamo pravi kaos. Oni koji se bave politikom i oni koji se bave medijima, obično znaju da su medije, s jedne strane, a političari, s druge strane, tako da jedni poznaju druge, ili bi trebalo da dobro poznaju druge, tako da u tom smislu mi treba da dobro poznajemo medije i moramo priznati da imaju ogromne slabosti. Zato bi Parlament Kosova trebao preuzeti mnogo značajniju ulogu, kao onaj koji ima tu ulogu u nadziranju funkcionisanja mnogih institucija ovde u zemlji, ne samo Vlade i drugih institucija, nego i medija. U tom smislu, Komisija za javne službe bi trebala imati mnogo veću ulogu kao ona koja nadzire, koja treba da bude jedna vrsta svojevrsnog mehanizma koji će stajati iznad, a da ne bude situacija kao sada da Nezavisna komisij za medije praktično bude potpuno nezavisna, odnosno da bude ono drugo tumačenju da radi šta ona hoće. Za sada smo nažalost imali tako, pa postoji mediji koji su omiljeni, postoji mediji koji nisu omiljeni, postoje mediji koje ona promovira ili ih forsira ili favorizira, a postoje mediji koji su na crnoj listi. Ne da samo TV Mintrovica bila jedna od tih kojoj je oduzeto sa pravom ili bez prava, ali kojoj je oduzeta licenca, oduzeta licenca nego je bio i čitav niz medija koji su bili na meti kampanja od nekih drugih medija, a koje nažalost, Nezavisna komisija za medije nije podržala.

To je onaj dio izveštaja koji se diče rada sa medijima, ako neki možda misle da sam skrenuo sa teme. Dakle, držim se teme o medijima i Nezavisna komisija za medije bi trebala da podrži i stimuliše medije na svim jezicima i kod svih zajednica, a ne da odobri, prećuti ili čak podrži kampanju protiv nekih medija. Tako da, u ovom smislu, uloga Komisije za medije, ja bi u ovom smislu išao ka zaključivanju ovog djela moga govora, da trebamo podržati Komisiju za javne službe i medije da ima što veće kompetencije, i da naravno ima nadzor nad Nezavisnom komisijom za medije i, naravno, da Zakon o Nezavisnoj komisiji za medije, koji bi se trebao ponovno razmatrati, da bude predmet jednog temeljitog razmatranja ili pretresanja, kako bih ja to rekao, gde bi se jasno utvrdile kompetencije Nezavisne komisije za medije.

Naravno, da budem u ovom smislu jasan, i ja sam takođe primjetio zajedno sa ovim kolegama koji su govorili, da postoje naznake da u Nezavisnoj komisiji za medije ima novih signala da će biti poboljšana i aktivnosti i djelovanje, uprkos onim hroničnim koji su bili, od kojih je болоvala Nezavisna komisija, stalna nekompletnost, nepopunjenost, sumnjiva legitimnost donošenja odluka, stalno menjanje ljudi u upravnim tijelima, uvijek nedostatak pojedinih ljudi u upravnim odborima, potom sjednice koje su održavane na način kako su održavane, ponekad nedostatak kvoruma i vrlo sumnjiva, čitav niz okolnosti u kojima su donošene odluke. Dakle, postoje svega toga, u zadnju godinu dana zaista imamo neke pomake. Nadamo se da će novi šef za medije, gospodja Graždani popraviti ovu situaciju, i vide se već pomaci, ali na nama je, na parlamentu i na Komisiji je da nadziremo na njihov rad.

I još samo da se osvrnem na ovo pitanje koje je spomenuto, a koje se tiče pokrivenosti teritorije Kosova, odnosno onog djela Kosova koji se tiče nesprskih zajednica. Da budem veoma jasan, malo prije je spomenula koleginica ovo pitanje, ali da to bude mnogo jasnije, što se nas tiče, ljudi koji zastupamo te krajeve, radi se o Gori i Župi. To su dva kraja, gde ima u Župi oko 15 do 20 sela, i oko 20 sela ima u Gori. To je oko 4 do 5 hiljada domaćinstava. I nije samo problem što oni menaju program. Problem broj dva je taj što oni, ili broj jedan, taj što oni plaćaju svakoga mjeseca po 3,5 eura, to je 42 eura godišnje, to je mjesečno oko 2 stotina hiljada euro, odnosno za ovih 5 – 6

godina, sedam, koliko je to bilo, milion do milion i po eura. To je tačno toliko, koliko navodno RTK traži da im se dadne para da bi oni napravili signal da imaju program.

Mislim da i Parlament Kosova, i Komisija za medije, moraju mnogo, zajedno sa Nezavisnom komisijom za medije, moraju promjeniti odnos prema Radioteleviziji Kosova, kao javnom mediju.

Radiotelevizija Kosova, kao javni medij je absolutno favorizovana, a nikome ne polaže računa ili nekome polaže, ili ima, da budem veoma otvoren, ima političke subjekte koje podržava i favorizira, a ima političke subjekte koje je potpuno uklonila i koji nisu na repertoaru, koji su nepoželjni, koji imaju zabrane. Nažalost, i naš je jedan od onih subjekata koji je nepoželjan ili ima neku vrstu zabrane.

Ja vas molim, ovo je veoma ozbiljna stvar i ovo nije personalno mišljenje. I vi veoma dobro znate da je glavni problem medija, ne samo kod nas, taj problem postoji i u Sjedinim Državama, i u razvijenim zemljama. Nema nezavisnih medija, samo je Bog nezavisan, da se razumjemo. Mi moramo razmišljati o tome, da konačno raskinemo sa time da neki mediji budu pod upravom onih koji ih plaćaju, ili pod uticajem nekih moćnih članova grupa, partija i tako dalje, ali nije samo problem u tome što su oni pod njihovim uticajem, nego što oni rade otvoreno protiv onih drugih koji su njihovi protivnici.

Molim vas, Komisija za medije, Parlament Kosova, imaju važnu ulogu da to prekinu, i u tom smislu ide i moje izlaganje. Znači, veoma jasno da se definiše Zakon i da podržimo Komisiju za medije ali, naravno, i gospodin Brajšori da se malo više potrudi i da malo pokaže pesnicu, tako krajnje je vreme. Hvala vam ljepa!

KRYETARI: Faleminderit!

Radhën për diskutim e ka Naim Rrustemi, le të përgatitet Gani Geci.

NAIM RRUSTEMI: I nderuar Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Sipas mendimit tim, qysh në fillim ky raport ka mangësi të veta, por njëra prej mangësive, që mund të themi edhe mangësi etike, është sepse në raportin e Këshillit për media vlerësohet lart puna e kryeshefes ekzekutive kurse i njëjti raport në emër të Këshillit nënshkruhet nga kryeshefi ekzekutiv. Nuk mundesh edhe ta lavdërosh veten, edhe ta nënshkruash atë raport, është problem i etikës në punë.

Përkundër shumë të metave që ky raport ka, sipas mendimit tim, nuk ka asgjë përveç se të gjitha mjetet që i ka harxhuar komisioni, janë harxhuar për mbylljen e TV Mitrovicës dhe mua më ka shty të mendoj, a thua pse?

Të nderuar deputetë,

Ne jemi të vetëdijshëm se në kohën moderne, pushteti i mediave është barabar i rëndësishëm aq sa edhe pushtetet e tjera. Sipas mendimit tim, kjo është bërë me qëllim që të bëhet një terr informativ në Mitrovicë. Unë mendoj se TV Mitrovica është mbyllur pikërisht që të mos shihet se çka po ndodh atje, që të mos shihet largimi i gjykatave, burgut, që të mos shihet largimi i manipulantëve që dëmtojnë buxhetin e Kosovës, që të mos shihen ku janë të vendosura pikat doganore në Mitrovicë. Kjo më bën të kuptoj që nuk është e rastësishme mbyllja e TV Mitrovicës, më bën të kuptoj gjithashtu për arsyen

se i njëjti person prapë e ka marrë licencën, por punët janë krye, se megjithatë, i njëjti person që e ka pasur licencën e TV Mitrovicës, prapë është licencuar dhe po i kthehen mjetet, po pas një kohe të gjatë. Pas një kohe kur Mitrovica ka pasur nevojë që mos të mbështetet vetëm kur t'i pikë rahmet RTK-së dhe të shkojë e ta vizitojë.

Dështim tjetër i radhës i këtij Komisioni është pikërisht ajo kur thuhet se sa mjete kanë mbledhur, shifra është zero, kurse infrastruktura ligjore ka rregulluar këtë shumë mirë, që mjetet të mbledhen nga ofruesit e shërbimeve kabllore. Ne jemi duke jetuar në Kosovë, e dimë se shumica prej nesh, mos të themi gati të gjithë, shumica prej nesh i shohim televizionet që na afrohen nga shërbyesit kabllorë. Ne po flasim për një vit e gjysmë, edhe shifra është e saktë e përcaktuar me Ligj se sa do të duhej paguar për secilin televizion kabllor që transmetohet. Kur bëhet një matematikë e thjeshtë, ne e shohim se këtu kemi të bëjmë me një shumë të madhe parash, kemi të bëjmë me shumë të madhe parash. Personalisht mua dhe, besoj edhe juve të tjerëve, u shkon mendja, a thua është manipulim për prolongimin e mbledhjes së këtyre mjeteve. Pse, pse të prolongohen?

Këto janë vetëm disa prej dështimeve që mund të themi se kanë qenë prezente në punën e Komisionit të Pavarur Mediave dhe, duke dëshiruar që ne të kontribuojmë që ta fuqizojmë këtë Komision edhe më shumë, është mirë që t'i marrim parasysh dhe të gjejmë arsyet pse kanë ndodhur deri më tash këo. Këto ishin disa prej brengave që unë desha t'i paraqes. Faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti Rrustemi!
Fjalën e ka deputeti Gani Geci.

GANI GECI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Siç e dini edhe ju, në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, më 21 shkurt 2008, Kryesia e ka autorizuar Komisionin Parlamentar për Media që të shqyrtojë çështjen e Televizionit të Mitrovicës dhe Komisioni për Media, në pajtim me rregulloret dhe ligjet në fuqi, e ka shqyrtuar çështjen e Televizionit të Mitrovicës.

Me datën 14 mars 2008, Komisioni për Media i rekomandon KPM-së, me arsyetim, ku thotë: “Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media vlerëson se Këshilli i Komisionit të Pavarur për Media ka bërë shkelje të dispozitave ligjore në fuqi dhe ka zbatuar standarde të dyfishta, ka aplikuar ligjin në mënyrë selektive”, dhe vazhdon: “Gjithashtu, Komisioni vlerëson se delegimi i kompetencave te Zyra e shefit ekzekutiv është në kundërshtim me ligjin” gjë që edhe deputeti tha që kjo e ka nënshkruar edhe raportin dhe e ka lavdëruar veten. Vendimi, njoftimi për shkeljet e datës 24.12.2007, me të cilin Zyra e shefit ekzekutiv ka ekzekutuar urdhrin për mbylljen e TV Mitrovicës dhe ka konfiskuar pajisjet, është arbitrar dhe subjektiv, shkruan në rekomandimin e Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media. Sipas Komisionit, Këshilli nuk ka vlerësuar faktet që i ka afruar TV Mitrovica, e ka bërë mbylljen. Pajtohem me deputetin kur thotë se ndoshta ka qenë ajo si arsye që uzurpimi i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, vandalizmi i një pjese të serbëve në Mitrovicë të mos paraqitet para publikut. Ndoshta kjo ka qenë një prej arsyeve ose ka qenë ndonjë arsye tjetër, siç ka pasur arsye edhe do herë më moti, mbyllja e Radiotelevizionit të Prishtinës.

Si deputet i regjionit të Mitrovicës mund të them lirisht se mbyllja e TV Mitrovicës ka pasur pasoja jashtëzakonisht të mëdha politike për gjithë regjionin, sepse KPM ka marrë vendim për kthimin e licencës, do të thotë prapë është bërë vendim, por prapë se prapë nuk është fuqizuar ky vendim, edhe pse ka 2 muaj që KPM-ja ka marrë vendim për kthimin e licencës të njëjtit person.

Mandej, në faqen 3 apo 4, në parathënie thuhet se si subjekte transmetuese që transmetojnë në Kosovë, në gjuhën shqipe janë 70 subjekte, në gjuhën serbe janë 35 subjekte, ndërsa në gjuhë të tjera jo serbe dhe jo shqipe janë 10 subjekte. Ju lutem, unë nuk e di sa për qind banojnë në Kosovë që kanë shikueshmëri në gjuhët joshqipe, ta zëmë nëse 45% të subjekteve kanë licencë në gjuhë joshqipe, atëherë jep për të kuptuar se afër 60% shqiptarë jetojnë, ndërsa të tjerët janë joshqiptarë dhe mbi 35% janë serbë. Kjo është për mua e papranueshme dhe e pakuptueshme që kaq tepër licenca t'ju jepen atyre që nuk kanë kaq shumë përqindje të banorëve në territorin e Kosovës.

Unë mendoj se ky raport nuk duhet të pranohet fare, sepse është një raport që, u tha edhe më herët, është bërë apo në faqen e parë shkruhet Milena Djeriq, ndërsa nënshkruhet me një K.M. a K.P. a si e ka emrin ajo shefja ekzekutive. Kjo është e parëndësishme, por e rëndësishme është që herëve të tjera, dhëntë zoti që anëtarët e Këshillit të Përkohshëm të Mediave që ne i kemi zgjedhur këtu, tash së fundi, mos të bëjnë këso shkelje të ligjit, siç ka bërë KPM-ja me herët, do të thotë në vitin 2007, sepse ata përpos që janë marrë me Televizionin e Mitrovicës, nja 10 faqe nuk arsyetojnë as mjetet ku i kanë quar, përpos kësaj, do të thotë, kjo ma e madhja, vepra më e madhe e tyre që është bërë, është mbyllja e Televizionit të Mitrovicës, ndërsa ato të tjerat gati janë edhe të parëndësishme, sepse janë bërë kopjime, disa kopjime të rregullave dhe të akteve që i kemi pasur të miratuara më përpara. Ka pasur edhe dështime të tjera, do me thënë janë bërë dështime edhe me pagesën e taksave për radio. Nuk janë bërë pagesa të taksave dhe unë po tutem, mos rastësisht ka këtu njëfarë ryshfeti, edhe pse këtu duhet komisionet të bëhen, sepse nëse televizionet kablloviqe operojnë në Kosovë pa licenca, dikujt i shkon për shtati kjo, sepse ata që operojnë në Kosovë pa licenca, ata marrin para prej firmave të ndryshme, prej reklamave të ndryshme dhe nuk paguajnë asnjë centë në buxhetin e Republikës së Kosovës. Me këtë mund të merret Komisioni i veçantë, i cili është për ryshfete, ata e dinë më mirë se a ka diçka.

Besoj se në të ardhmen do të jenë, të paktën për vitin 2008, sepse ne tash jemi në vitin 2008, plus jemi në fund të vitit 2008, kurse ne po shqyrtojmë një raport të vitit 2007, siç tha edhe deputetja më herët. Por, ma merr mendja që tash me komplementimin e Komisionit të Pavarur për Media, sepse ata kanë shkruar që edhe ne nuk kemi qenë të kompletuar sa duhet që të jemi efikas në punë, do të jenë më efikas dhe për vitin 2009 dhëntë zoti që nuk na vjen në muajin e dhjetë të vitit 2009, po të na vijë pak më herët raporti dhe ne do ta shqyrtojmë me kohë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

Mendoj se shumicën e atyre që unë desha t'i them, i thanë kolegët e mi. Unë do të përqendrohem pak në disa aspekte të tjera.

Mendoj se Komisioni i Pavarur për Media ka një rol shumë të rëndësishëm në çështjet e informimit në Kosovë, në çështjet se sa media do të jenë të afta ta bëjnë këtë informim të drejtë, të mirë dhe me kohë. Dëshiroj ta bëj një krahasim të shkurtër me një organ tjetër që ka qenë më herët, pra, Komisioneri për media dhe ne, shumica prej nesh ose ndoshta disa, e dimë saktësisht se kishte një qasje shumë selektive ndaj disa mediave, madje ka shkuar deri në atë masë sa u ka dhënë dënime drastike me një qëllim shumë të qartë që t'i mbyllë plotësisht ato media. E them këtë, që të mos përsëritet kjo edhe te Komisioni i Pavarur për media sepse, siç u tha këtu, edhe nga Komisioni ynë, por edhe nga shumë folës, ka qasje selektive dhe diskriminuese ndaj mediave të ndryshme.

Mendoj se kjo nuk duhet të lejohet të ndodhë dhe Komisioni ynë duhet të jetë aktiv në këtë aspekt. Ne do ta përkrahim pa asnjë rezervë që të mos përsëritet ajo që ka qenë të kaluarën.

Ne e dimë që në aspektet e kushteve për punë, RTK-ja po thuhet se ka kushte shumë të mira financiare e të tjera. Nuk mund të them për 2 televizione të tjera qendrore, por mund t'ju them se televizionet lokale dhe mediat lokale të cilat luajnë rol shumë të madh në informimin lokal për çështjet lokale, punojnë në kushte mizerable, në kushte aq të rënda sa që, kur shkon njeri dhe i viziton, çuditet si mund të punojnë ata.

Është veç një vullnet dhe një pasion i jashtëzakonshëm i njerëzve që i mbajnë ato. Unë desha të dal te fakti që ne duhet të gjëmë mënyra institucionale që t'i përkrahim ato, t'i përkrahim në aspekte të ndryshme në mënyrë që ta luajnë me sukses rolin e tyre.

Dëshiroj edhe unë të ndalem pak te Televizioni i Mitrovicës. E dimë që ka qenë një odisejadë e mbylljes dhe e rihapjes të këtij televizioni. Unë kam përshtypjen e fuqishme se ka qenë një tendencë e qëllimshme që të mbyllet ky televizion. Arsyet mund t'i dinë më së miri ata atje, por i thanë edhe këtu deputetët. Mendoj se Televizioni i Mitrovicës, jo veç që ka qenë i domosdoshëm dhe i nevojshëm, por është edhe sot, sepse ka qenë një medium shumë i fuqishëm që e ka plasuar të vërtetën që po ndodhë në atë pjesë të Kosovës. Asnjë televizion tjetër nuk mund ta mbulojë atë rajon sikur Televizioni i Mitrovicës, sepse Televizioni i Mitrovicës është marrë vetëm me problemet kryesisht të atij rajoni dhe mendoj se Komisioni do të duhej, është propozimi i imi, që të merret më shumë me çështjen e mbylljes dhe të rihapjes të Televizionit të Mitrovicës.

Nëse vërtet Komisioni ka konstatuar ato që u thanë këtu, atëherë vihet në pyetje seriozisht legjitimiteti i Komisionit të Pavarur për Media dhe objektiviteti i tij, zbatimi i ligjit dhe i rregulloreve.

Atëherë, ne do ta shohim pse ka ndodhur kjo dhe a duhet të jetë përgjegjës dikush në këtë aspekt. Ne që kemi pasur mundësinë ta vizitojmë Televizionin e Mitrovicës, e kemi pa në çfarë kushte tepër të rënda, po thuhet se të paimagjinueshme ka punuar ky televizion. Në anën tjetër, ka luajtur një rol shumë të madh në informimin e saktë dhe drejtë të opinionit në atë rajon.

Nuk duhet të harrojmë që informimi i drejtë dhe i saktë luan rol të madh edhe në aspektet e sigurisë. Njerëzit do ta ndjejnë veten të sigurt ose të pa sigurt, varësisht se si janë të informuar për zhvillimet që ndodhin aty. Në këtë aspekt, Televizioni i Mitrovicës ka luajtur rol të madh, ndoshta ka qenë edhe dritarja e vetme se çka po ndodh në atë pjesën që ne po e quajmë pjesa veriore e Mitrovicës dhe e Kosovës.

Unë apeloj edhe te Kuvendi edhe te Komisioni dhe të gjitha organet kompetente që të punojnë më shumë në këtë aspekt, që të trajtohet në mënyrë të veçantë problemi i Televizionit të Mitrovicës, por edhe të gjenden forma përkrahjes, veçanërisht të televizioneve lokale, të cilat mund të luajnë një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e proceseve demokratike në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Salihaj!
Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Faleminderit, zoti kryesues!
Respekt për auditorin,

Subjektet transmetuese kudo, pra edhe në Kosovë, mund të jenë dhe janë private apo publike, këto private zakonisht shoqëri aksionare, kompani. Por, gjithsesi, aktiviteti i tyre është i interesit të veçantë të shoqërisë politike. Për shkak se është i interesit të veçantë e të posaçëm, duhet medoemos të kontrollohet nga shoqëria politike në mënyrë të sofistikuar. Kjo është një, dhe kjo si mund të bëhet vetëm me ligj edhe në bazë të Ligjit.

Konkretisht, e marrë shembull transmetimin, se kontrollimi duhet të bëhet edhe mbi skemën transmetuese. Sot, po e zëmë, në mediat tona private transmetohen, emitohen emisione shumë pseudo, kuazi, vlera morale, pa vlera artistike edhe etike. Ky është një problem që ndikon shumë keq, sidomos në rini dhe nuk mund e të mos ndikoj keq, madje edhe në shtresat e tjera.

Sa i përket anës së..., e marrë shembull, ju lutem, RTK-në. Këtë e financon qytetari i Kosovës me 3,5% muaj për muaj, në rregull po e zëmë, nëse është në rregull, mirë. Kam lexuar në shtyp në dy gazeta, megjithëse nuk merren burime të sakta të pakontestuara ato që i shkruajnë gazetatat, por sado kudo, përderisa nuk përgënjeshtrohen, duhet t'i marrim si të tilla.

RTK-ja me paranë publike ka bërë një kontratë me një person për t'ia paguar kompensimin, ta quaj mujor 7000 euro një personit me emër e mbiemër, s'po e përmendi këtu, a kupton, sa tri e disa paga të Kryetarit Kuvendit të shtetit, e kështu me radhë. Po të ishte subjekt transmetues privat, do t'i jep edhe 50 mijë, 60 mijë euro, mirëpo është fjala për interesin e përgjithshëm për të cilin është i interesuar jetikisht edhe bujku, edhe blegtori, edhe filozofi, edhe deputeti.

Prandaj, ju lutem, angazhohem për ta bërë një ligj, për ta bërë një listë të mirë, edhe atë shumë shpejt, dhe në këtë kontest kursesit nuk do të mund të pranohej, po e zëmë, ky fragment që ia adreson kryetarja e Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media kryetarit të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale, e tjera e tjera, ku thotë ndër të tjera: "...me qëllim që të sigurohet mbrojtja e të miturve nga përmbajtjet e programeve të cilat mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin e tyre fizik, mental, moral, Këshilli i KPM-së do të hartojë dhe do të miratojë rregullore..." Do me thënë, do të hartojë, do të..., që është dashur para se të fillohet, si të themi, aktiviteti, të bëhet kjo punë, e kështu me radhë. Dhe, kjo rregullore duhet t'ju mundësojë subjekteve..., e tjera, e tjera. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Smaka!
Fjalën e ka deputeti Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar pjesëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Për të mos qenë i gjatë lidhur me raportin e Komisionit të Pavarur të Mediave, u diskutua shumë edhe nga kolegët deputetë, sado që i vonuar do të jetë, brengosen ata se thonë sivjet është kah punon më mirë, e ne ende s'e kemi shqyrtuar raportin e vitit të kaluar, do të thotë shihet se kemi qasje edhe për këtë vit. Unë në Komisionin për Buxhet dhe Financa e kam kundërshtuar fuqishëm këtë raport, edhe sot do të jem kundër këtij raporti. Me qenë se është trup i Kuvendit, kisha kërkuar që nga Kuvendi të formohet një Komision hetimor, t'i hetojë mirë këto vendime që i bie Komisioni i Pavarur i Mediave, në këtë rast, edhe për të gjitha shkeljet që janë bërë.

Ne në Kosovë e dimë hapësirën mediale, sa kanë edhe ato subjekte private të licencuara, e dimë hapësirën që ka kryeqyteti i Kosovës. Sot Prishtina nuk ka asnjë televizion privat, ndërkaq të gjitha komunat, që nuk jam kundër se i kanë nga 2 ose 3 medime televizive dhe radio lokale, Prishtina nuk ka asnjë. Hapësirën mediale e mbulojnë edhe 2 televizione qendrore, me çfarë të drejte, pa asnjë rregullore i kanë dhënë. Nuk jam kundër medimeve, por e them këtë, me çfarë akti kanë mund të jenë KTV-ja dhe TV21-shi, që i bëjnë konkurrencë të fuqishme sot në mbarë hapësirën mediale Radiotelevizionit të Kosovës, që nga Buxheti i Kosovës jepen para të majme për këtë medium publik dhe 12%, që edhe sot u tha këtu, nuk mbulohen nga RTK-ja, dhe të gjitha ato subjekte private apo ekonomi familjare që nuk kanë televizion, sot paguajnë nga xhepi i tyre tatim për RTK-në. Ne s'e dimë a jemi duke e dëmtuar ekonominë familjare edhe ekonominë private në këtë rast në Kosovë në kuadër të këtyre medimeve. Është me rëndësi të cekim se shkelja më e madhe që është bërë dhe ku nuk deklarohet asnjë e hyrë vjetore në kuadër të këtij raporti, është bërë edhe me Televizionin e Mitrovicës, sikurse të ishim duke jetuar para 30 vjetësh, kur edhe qytetarët janë dënuar pse kanë ardhur valët edhe frekuencat e Radio Tiranës apo të Televizionit Shqiptar në disa shtëpi të qytetarëve të Kosovës, kështu që këto shkelje janë të pajustificueshme dhe besoj se duhet të ngrihet një komision hetimor ta hetojë këtë mekanizëm të Kuvendit dhe jam kundër, personalisht do ta votoj kundër këtij raport. Faleminderit, të mos zgjatëm më tutje se po bëhet shumë.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Demalijaj!

Fjalën e merr deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryesues!

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të respektuar kolegë deputetë,

Mbase është krijuar një praktikë e mekanizmave, e organeve të pavarura që votohen në këtë Kuvend që mos ta përfillim Parlamentin e vendit dhe t'i sjellin raportet kur kanë mundësi apo si t'ju teket. Është shqetësuese që ky raport për periudhën e vitit që e lamë pas, të shqyrtohet tani në muajin e 9-të të vitit 2008 dhe, nga sa u tha edhe nga raporti, edhe nga kryetari i komisionit funksional, zoti Brajshori, të cilin e përgëzoj për një raport shumë konkret dhe të qartë, por edhe kolegët e tjerë të atij Komisioni. Është koha e fundit që agjencionet e pavarura, bordet apo qoftë edhe Këshilli i Pavarur i Mediave, që po flasim tani për raportin e punës të këtij këshilli, t'i përgjigjen konform kornizës ligjore dhe legjislacionit në fuqi, Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Këtu u potencuan shumë mangësi të punës së këtij Këshilli, të lëshimeve serioze. Unë dua t'i potencoj disa.

Së pari, raporti i KPM-së me RTK-në. Së dyti, raporti kthehet në plotësim nga ana e komisionit funksional me pyetje konkrete dhe prapë se parë nuk janë përgjigje adekuate nga Këshilli i Pavarur i Mediave. Është koha e fundit që i vetmi transmetues publik në Republikën e Kosovës -Radiotelevizioni i Kosovës të funksionojë jo në 89% të territorit të Republikës sonë, por të funksionojë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Është një raport që thjeshtë vë në pah mospunën, neglizhencat dhe mos respektimin e institucioneve qendrore të vendit.

Marrëdhënie tjetër me rëndësi është raporti i KPM-së me ART-në. Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit të Kosovës i cili e bën licencimin për operimin e këtyre operatorëve medial. Këtu kemi të bëjmë me shifra të mëdha të mjeteve dhe me një dëmtim serioz që i bëhet Buxhetit të Republikës së Kosovës. Pse kanë ndodhur këtu prolongime, pse nuk ka ndodhur me kohë licencimi dhe aspekte të tjera, sepse edhe ART-ja është organ që është zgjedhur nga Parlamenti i Republikës së Kosovës.

Sa i takon punës së këtij Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Mediave, lihet përshtypja e ekzistencës ende të disa komisionarëve dhe disa komisionereve që në mënyrë arbitrare dënonin media të caktuara në Kosovës.

Tani jemi shtet i pavarur dhe sovran. Është një sugjerim thjesht kolegial për anëtarët e Këshillit të Pavarur për Media, por edhe për drejtorin ekzekutiv atje, apo drejtoreshën, që Parlamenti i Republikës së Kosovës e trajton me seriozitetin më të madh aspektin e funksionimit të mediave në Kosovë dhe i sugjeroj kryetarit të komisionit funksional që raporti për vitin 2008 mos të vonohet më tepër se në muajin e tretë të vitit 2009, sepse është kërkesë edhe e Kuvendit, edhe e Komisionit, sepse po shihen haptas ndikimet edhe politike, por edhe të grupeve të tjera të interesit. Është bërë një ndërhyrje në Radiotelevizionin e Mitrovicës dhe dihet mirë pse e thanë edhe deputetët nga ai regjion dhe, ne si deputetë të Parlamentit të Republikës së Kosovës është mirë që po e ngrisim zërin, por ta dërgojmë një mesazh të qartë te këta njerëz që merren me këtë fushë tejet të rëndësishme për vendin, po edhe për qytetarët, po edhe për efektet që i ka media në ndryshimin e opinionit që nuk do të lejojmë më teket e dikujt që t'i ndalojë mediat të cilat respektojnë legjislacionin në fuqi dhe i kryejnë të gjitha obligimet ndaj shtetit të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Rugova!
Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!
Përshëndetje, të nderuar të pranishëm,
Meqë shumica e kolegëve diskutuan tani më dhe i prekën edhe çështjet që i pata ndërmend t'i diskutoj, unë do të ndalem vetëm te çështja e shkrimit të raportit.

Unë e kuptoj ndoshta edhe mungesën e anëtarëve të Bordit dhe pamundësinë që të krijojnë një raport apo të shkruajnë një raport konform standardeve apo konform raporteve tjera të cilat i ofrojnë organizatat buxhetore dhe agjencionet e pavarura, ndoshta

edhe në mungesë të stafit administrativ, mirëpo me qëllim që raporti mos të përsëritet së paku për vitin 2008, ngrejë këto shqetësime.

Nëse mund të thuhet, ky dokument që është ofruar mund të jetë gjithçka, por vetëm raport nuk mund të jetë. Nëse merret e lexohet në detale, është shumë vëllimor, diku i ka 50 – 60 faqe dhe, të jeni të bindur që këtë raport nuk mund ta ofrojë as Qeveria e Kosovës, nëse dëshiron të ofrojë raport përmbajtjesor. Nëse filloni ta lexoni, shihni se këtu ka citime të dispozitave ligjore që janë të panevojshme, përbërje të komisioneve, ka komplet takime që janë mbajtur në nivele të ndryshme dhe komplet shkruhet se çka është folur në ato takime, që janë të panevojshme, mandej shqyrtimi i të gjitha ankesave, e kështu me radhë. Ka bashkëngjitje të anekseve, me çka nënkuptojmë se raporti është i ndarë, aneksi 2, 3, që s'ka nevojë. Kurse, për çështjet për të cilat raportohet, flitet shumë pak. Për çështjen e buxhetit, edhe pse është i vogël, raporti është shumë gjeneral, e nëse e merr ta lexosh, nuk mund ta kuptosh sepse vetëm e kanë shkruar mjetet e zotuara, mjetet e harxhuara, mjetet e harxhuara për paga dhe pagesa, e kështu me radhë.

Prandaj, me qëllim që të mos përsëritet kjo çështje në të ardhmen, është mirë që KPM-ja në të ardhmen të marrë një mostër të hartimit të raporteve standarde dhe në pika të shkurta të japë pasqyrat detale të shqyrtimit të ankesave, infrastrukturën ligjore që ka arritur ta nxjerrë gjatë kohës sa ajo ka menaxhuar, të japë dënimet të cilat janë shqiptuar dhe të japë një raport detal për të hyrat, për të dalurat dhe për shpenzimin e buxhetit.

Dhe, krejt në fund, do të ngrejë edhe një çështje. Nuk është e interesit që në raport të shkruan objektivat. Unë nuk po e kuptoj, se komisioni funksional ndoshta ka qenë dashur të bëjë një vërejtje shumë të qartë, edhe pse në një farë mënyre e ka bërë, në rastin kur kërkon sqarime detale për raportin, ato i shkruajnë objektivat që i kanë për vitet e ardhshme, në raport nuk preken objektivat. Prandaj, krejt me qëllim të mirë, është mirë që së paku në raport të mos përfshihen tash objektivat për vitet e ardhshme, sepse objektivat duhet të jenë në raport të veçantë. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!
Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA: I nderuari zoti Kryesues,
Unë jam anëtar i Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media. Të gjitha diskutimet që u bënë sot në lidhje me këtë raport, t'ju them të drejtën, më pëlqyen shumë sepse e pashë një seriozitet të madh të të gjithë diskutuesve dhe diskutimet të cilat ishin thelluar edhe në raport dhe e njihnin mirë problematikën të cilën po e shqyrtojmë sot.

Duke qenë anëtar i këtij Komisioni, duke mos i përsëritur këto që u thanë, unë mendoj se burimi i të gjitha problemeve në Komisionin e Pavarur të Mediave është ky ligj që e kemi përpara. Dhe, askush të mos mendojë se do të ndryshojë diçka gjatë këtij viti ose në të ardhmen përderisa nuk merret në shqyrtim ligji i cili është aprovuar nga ky Kuvend, është nënshkruar praktikisht më 8 korrik të vitit 2005 dhe kurrë nuk është zbatuar në asnjë pikë, në asnjë dispozitë të tij.

Në rast se dikush ka qenë mbi ligjin në Kosovë, nuk ma merr mendja që ka institucion në Kosovë që ka qenë tërësisht i pavarur prej ligjit si ky agjencion.

Drejtuesit e agjencionit kanë përgjegjësi ligjore, morale dhe unë jam i bindur se sikur të bëhej një auditim, aty do të ketë mjaft, si të them, në aspektin juridik do të ketë aso shkeljesh, që do të duhej jo vetëm të shkarkohet komplet ky komision, drejtuesi i tij dhe anëtarët e tij, por sigurisht ka edhe baza ligjore edhe për ndjekje penale për shkelje që i kanë bërë.

Komisioni i Pavarur për Media nuk ka humbur shumë nga dhënia e licencave, mirëpo Buxheti i Kosovës ka humbur shumë nga operatorët dhe transmetuesit e ndryshëm të cilët nuk e kanë përfillur ligjin në Kosovë.

Unë ju kisha lutur që sot ta shqyrtojmë me seriozitet këtë raport dhe të marrim vendime adekuate të cilat krijojnë mundësi reale që në të ardhmen mos të përsëriten këto gabime.

E para, propozoj që të formohet një komision, i cili do të hetojë këtë agjencion për ligjshmërinë e marrjes së vendimeve dhe zbatimin e ligjit nga drejtuesit e tij, të këtij Komisioni.

E dyta, që të nisen procedurat për ndryshimin e ligjit menjëherë, dhe

E treta, që në ligj të përcaktohet edhe përgjegjësia e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës për zbatimin e ligjeve, të sanksionohet drejt.

Komisioni për Media i cili funksionon në kuadër të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media nuk ka asnjë bazë ligjore për të kryer funksionin e vet për çka është emëruar. Ne, si Komision kemi bërë vërejtje shumë serioze dhe kemi qenë shumë transparent, të gjithë anëtarët e Komisionit të të gjitha partive politike. Mirëpo, ngecjet kanë ndodhur në Kryesinë e Kuvendit të Kosovës. Kryesia e Kuvendit të Kosovës nuk ka treguar asnjë vullnet, as nuk ka manifestua asnjë vullnet që të mbështesë Kuvendit, së paku moralisht të mbështesë Kuvendin, që të krijohet ligjshmëria në këtë institucion për të cilën po flasim. Dëmet të cilat i ka bërë ky Komision janë jashtëzakonisht të mëdha. Nuk po dua ta zgjas më tepër, mirëpo ju kisha lutur që sot të merren vendime, këto vendime që i thashë, që të krijohet komisioni funksional për media, të jetë komision në vete i Kuvendit dhe ta përcjellë këtë sferë shumë të rëndësishme. Ekzistojnë 4 pushtete sot, të gjithë e dimë, legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori. Një prej katër pushteteve janë edhe mediat. Pushtetet e legjislativit, të gjyqësorit dhe të ekzekutivit janë të determinuara me ligj, të përcaktuara, kurse pushteti i mediave nuk është i sanksionuar me ligj dhe askush nuk e di deri ku shtrihet pushteti i mediave dhe, për një pushtet kaq të fuqishëm të mos hartohet një ligj, i cili e rregullon këtë sferë dhe të bëhen shumë më të përgjegjshëm ata që do të punojnë në këtë KPM për zbatimin e ligjit. Nuk mundet askush në Kosovë të jetë i pavarur ndaj ligjeve.

Në emër të pavarësisë editoriale, në emër të pavarësisë së marrjes së vendimeve, ne duhet t'i përcaktojmë me ligj. Ju vetëm edhe një gjë po ju them. Gati që 3 vjet Radiotelevizioni i Kosovës funksionon pa një bord komplet dhe merr vendime jolegjitime, kurse KPM-ja kurrë nuk e ka ngritur zërin pse është një gjendje kështu në Radiotelevizionin publik të Kosovës.

Unë po ju them se në Prizren i kemi 5 televizione lokale, kurse në Mitrovicë është mbyll vetëm një që ka ekzistuar. Në Prishtinë nuk kemi asnjë televizion lokal për arsye se këtu ka konflikt interesi. Tri televizione që ekzistojnë sot kombëtare në Kosovë, nuk janë hiq

më shumë se televizione lokale dhe për të mos t'iu bërë konkurrencë televizioneve kombëtare në Kosovë, nuk është lëshuar asnjë licencë për një televizion publik në Kosovë. Ndërkaq, në Prizren i kemi 5 televizione, në Mitrovicë asnjë.

Ka aq shkelje të rënda drastike selektive, arbitraritet në punë, marrje të vendimeve në mënyrë arbitrare. Dhe, çka është më keq, të gjitha ato vendime merren në kuadër të këtij Ligji. Ky ligj i ka bërë ata njerëz të paprekshëm dhe me punën e tyre në një mbledhje të Komisionit ka qenë i kënaqur vetëm përfaqësuesi i OSBE-së me punën e tyre, bile habitej si po i marrim në shqyrtim këtë Komision, kur ata janë jashtëzakonisht të kënaqur me punën e këtij Komisioni.

Do të thotë, unë po e mbylli me kaq, në rast se ne nuk marrim masa të menjëhershme, nuk do të përmirësohet asgjë derisa është ky ligj në fuqi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!
Fjalën e ka deputeti Berat Luzha.

BERAT LUZHA: Faleminderit! U fol shumë për mbylljen e Televizionit të Mitrovicës me të cilët diskutues unë pajtohem plotësisht. Unë desha ta theksoj edhe mbylljen e një radioje lokale në Kaçanik. Është mbyllur vetëm për shkak se ka ndërruar selinë nga Hani i Elezit në Kaçanik. Mendoj se KPM-ja ka probleme shumë më të mëdha se sa të merret me një radio lokale dhe të shikojë se ku e ka selinë, 10 kilometra më larg apo më afër.

Në komunën e Kaçanikut ka problem sidomos edhe me mbulimin e terrenit me frekuenca të televizioneve kombëtare. Kjo është një problematikë jashtëzakonisht e theksuar atje për shkak se ata janë të detyruar ta paguajnë tatimin për RTK-në, kurse nuk kanë mundësi ta përcjellin programin e RTK-së.

KPM-ja thotë se nuk ka kompetenca për këtë çështje, ia bartë problematikën rrjetit për transmetim tokësor. Ky është një rrjet që gjithashtu ankohet se nuk ka para për të bërë antenat që duhet. RTK-ja gjithashtu ankohet se nuk ka para për të investuar dhe kërkon para nga Kuvendi i Kosovës dhe kështu mbetet që terreni të mos mbulohet edhe për një kohë të gjatë, sigurisht, me frekuencat që kërkohen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!
Unë i kam edhe 2 emra këtu, po ata asnjëri nuk janë këtu, kështu që nuk po i thërras hiq.

Deputetë të çmuar, meqë nuk kam askënd që të ulet tash këtu, më lejoni që t'i them vetë 2 – 3 fjalë prej kësaj karrige, do të dilja normalisht atje.

Edhe ky diskutim i yni rreth këtij institucioni të pavarur nxori në shesh atë që po përsëritet me këto institucione, të cilat e marrin atë atributin “i pavarur” sikur jetojnë në planete të tjera. “I pavarur” do të thotë të mos përzihet kush në vendimet e saj dhe në veprimtarinë e saj, por institucione të pavarura nga shoqëria nuk ka dhe, nëse duhet të jenë të varura ose të kontrolluara prej dikujt, duhet të jenë të gjitha, ama bash të gjitha institucionet, sepse burojnë nga ky Parlament, se jemi Republikë parlamentare, aq më tepër që këto komisione i zgjedh ky Parlament.

Pra, kjo punë duhet të theksohet edhe kësaj radhe dhe t'ju bëhet me dije përgjithnjë këtyre institucioneve të pavarura. Ne sot kemi Komisionin për Media, po kjo na është përsëritur dhe në institucionet e sotit të tillë herëve të tjera.

E dyta, është puna e tipit të ndërtimit të këtyre raporteve. Të gjitha këto raporte që kanë ardhur në Kuvend, i kanë pasur të njëjtat gabime që përafërsisht merren me planet e tyre, me tipin e organizimit, me përshkrimin e rregulloreve të tyre, me përshkrimin e organogrameve të tyre, kur vjen puna që të flitet substancialisht për punën, lodhen, i lëshon fryma të gjithë edhe nuk ka kurgjë. Pak a shumë, i ngjashëm është edhe ky raport.

Unë kam respekt të jashtëzakonshëm për Komisionin e Kuvendit, i cili ka bërë një punë sepse ka kërkuar shënime plotësuese dhe, kur jemi te ky problem, desha të them edhe për hatër tonin, edhe të opinionit, edhe të Kuvendit, që në kuptimin e datave ky raport ka ardhur në kohën e caktuar, sepse Ligji thotë që duhet të vijë raporti deri në fund të marsit, ata e kanë prurë këtë raport deri në fund të marsit. Ligji thotë që deri në fund të sesionit veror do të duhej të kalonte në Kuvend. Ky është propozuar të kalojë në Kuvend, por është Kuvendi përmes Komisionit të vet që ka kërkuar të plotësohet. Pra, këto janë punë procedurale, pse ka mbërri në shtator. Është dashur të kryhet para pushimeve, ka mbërri në shtator. Janë punë procedurale të Kuvendit, jo të atij Komisioni në kuptimin primar, sa për saktësim.

E dyta, u shfaqën shumë probleme këtu që lidhen me këtë Komision, si organ i pavarur për media dhe për funksionimin e mediave, për raportet e mediave publike dhe private, u prekën 2 – 3 elemente shumë themelore që lidhen edhe me transmetuesin publik. Unë mendoj që sot nuk duhet të bisedojmë për te për shkak se ne do të bisedojmë për transmetuesin publik një raport të veçantë, të cilin ne e shtymë sot për arsye të plotësimeve.

Unë nuk dua ta zgjasë më tutje, veçse po përpiqem të rezymojmë nga diskutimet çka do të votojmë tani. Mora shënime dhe më duket që 2 grupe parlamentare, edhe nga AKR-ja, edhe AAK-ja, dhe nga deputetë të veçantë u mbështet që Ligji ekzistues për Komisionin duhet të rimerret, të amendohet, të plotësohet, të bëhet më i përshtatshëm për veprimtarinë dhe unë mendoj që ta nxjerr si rekomandim të këtij diskutimi në Kuvend që të votohet për raportin që e diskutuam dhe të njëjtën kohë të votohet për një rekomandim që Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave të merret në dorë, të amendohet. Mendoj që kjo ishte kërkesa themelore që doli nga 2 grupe dhe nga disa deputetë.

Unë e hedh në votim këtë formulim si e thashë. Pra, raportin me këtë rekomandim. Kush është “për”, ju lutem?

Fjalën e kërkon Berim Ramosaj. Urdhëro, Berim!

BERIM RAMOSAJ: Më falni, zoti kryesues, por nga diskutimet del edhe diçka më shumë, se duke marrë parasysh ky raport dhe raportet e komisioneve dhe të këshillave të tjerë të pavarur që kemi formuar, po ka standarde të ndryshme të paraqitjes së dokumentacionit, herë 50 faqe, herë 60 faqe, herë shkruhen objektivat, herë shkruhen vizioni. Të japim ne një propozim, si Kuvend, që ta standardizojmë çështjen e raporteve, jo vetëm të këtij raporti, po të gjitha raporteve, që në mesin e tyre zë vend edhe ky, që të krijojmë ne një pasqyrë standarde çka kërkojmë si Kuvend dhe vazhdimisht të merret për shembull. Kryesia e Kuvendit t'ia japë këtë detyrë sekretarisë që të formulojë një

standard, pasqyrë, që çdo raport që na vjen nga komisionet e pavarura, të plotësohen ato pyetje apo përgjigje dhe sigurisht që edhe për komisionet e tjera ka për të shkuar puna më mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Ramosaj!
Baliq e ka kërkuar fjalën.

NUMAN BALIĆ: Bilo je nekoliko slučajeva prekoračenja nadležnosti Nezavisne komisije za medije i, da tako kažem, štetnog delovanja koje je bilo predloženo da se ispituje i da se formira jedna komisija parlamenta ili ova komisija sa još nekoliko poslanika koji bi uzeli učešće. Dakle, da se ispituju pojedini slučajevi prekoračenja ovlašćenja Nezavisne komisije za medije. To bi se takođe moglo staviti na glasanje ako se slažete.

KRYESUESI: Edhe Riza Smaka e ka kërkuar fjalën.

RIZA SMAKA: Faleminderit!

Zoti kryesues,

Konsideroj propozimin e profesorit Ramosaj shumë me vend, vetëm do të isha angazhuar që aty të jetë edhe ky kriterium. Materialet të jenë sa më të shkurtra, sa më koncize, sa më precize, sepse shumë letra po shpenzohen, shumëçka shkruhet jashtë temës bosht dhe, për aq lexohen më pak, ndryshe do të lexoheshin nga të gjithë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju lutem shumë, ju po injektoheni, po lypni fjalën. Diskutimi ka mbaruar dhe mos ta keqpërdorim vetveten edhe opinionin. Të gjitha diskutimet kanë mbaruar. Çdonjëri që ka pasur dëshirë, ka four. Unë u përpoqa të rezymojë çka dominonte këtu. Ka pasur edhe diskutime brenda grupeve, që grupi thotë do ta përkrahim, e çohet njëri thotë, s'e përkrahu. Unë i respektoj mendimet individuale të deputetëve, po ajo që u tha këtu dhe që u përkrah prej 2 grupeve, është që Ligji duhet të rishikohet. A jeni ju që ta votojmë. Në deshi e votojmë ndaras, në deshi bashkë. Unë e hedh në votim, a doni bashkë, apo ndaras?

Kush është që të votohet bashkë, e ngrehni dorën?! Numëro, kush po numëron. Ju lutem, kush është ndaras? Propozoj që të votojmë për Raportin e Komisionit, me rekomandimin që Ligji të punohet.

Urdhëro, zoti Makolli!

IBRAHIM MAKOLLI: Zoti kryesues,

Nuk do të duhej të lejonim që të shkelim procedurat të cilat ekzistojnë në këtë Kuvend. Me gjithë respektin për të gjithë ata që kanë propozuar amendimin e këtij ligji, ne kemi një rregullore e cila përcakton procedurat për amendim të ligjeve, andaj konsideroj se është e panevojshme të votohet për këtë çështje.

KRYESUESI: Po, zoti Makolli, unë po ju them që organ më i lartë se kjo sallë për ta parë nevojën për t'u amenduar një ligj, nuk ka. Ne rekomandojmë, ne nuk e ndërrojmë ligjin, ekziston procedura qysh fillohet, ndryshohet ose nuk votohet. Bën vaki votohet i njëjti formulim, por ky Kuvend, në këtë rast, për këtë veprimtari është përbërja më e kualifikuar që sheh nevojën që një ligj të rishikohet dhe unë këtë e propozova. Në të vërtetë, e propozuat ju, në të vërtetë e propozoi shefi i Komisionit, në të vërtetë e propozoi në emër të grupit tuaj, kolegu i juaj dhe unë e respektova propozimin. Nëse ju tërhiqeni, është punë për ju.

Ju thërras ta votoni Raportin bashkë me rekomandimin që të rishihet mundësisht Ligji për Komisionin.

Votojmë tash:

Në bazë të votimit tuaj, del që “për” kanë votuar 47 deputetë, “kundër” kanë votuar 14, kurse 5 kanë abstenuar. Me shumicë votash, ky Raport dhe rekomandimi votohen.

Pushim deri në orën 15,30.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë, po vazhdojmë punën pa humbur kohë. Pika e parë e rendit të ditës është:

- Shqyrtimi i Raportit për shpenzimet e buxhetit të Kosovës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2008

Qeveria e Kosovës, respektivisht Ministria e Ekonomisë dhe Financave, në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, ia ka parashtruar Kuvendit Raportin për shpenzimet e buxhetit të Kosovës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2008.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Raportin për shpenzimet e buxhetit të Kosovës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2008 dhe ka rekomanduar që të radhitet për shqyrtim në seancën plenare.

Rekomandimi i Komisionit, së bashku me Raportin për shpenzimet e buxhetit të Kosovës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2008 u është shpërndarë deputetëve.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin Ahmet Shala që të prezantojë Raportin për shpenzimet buxhetore për gjashtëmujorin e parë të vitit 2008.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra të pranishëm,

Zonja dhe zotërinj,

Siç e paralajmëroi Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, mbështetur në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, nenin 45 – ministri i Ekonomisë dhe Financave është i obliguar që brenda 30 ditësh prej ditës së skadimit të tremujorit, pra për çdo tre muaj, të paraqesë raportin tremujor, përkatësisht tjetrin gjashtëmujor dhe kështu me radhë.

Mbase për shkaqe të pushimeve verore, në fakt, ne si Ministri e kemi dërguar raportin me kohë por në seancën e radhës ka ardhur tani për të biseduar dhe kam kënaqësinë e veçantë që para jush të paraqes ose të shpalos disa nga të dhënat kryesore të këtij raporti.

Rregullorja për buxhetin e konsoliduar të Republikës së Kosovës për vitin 2008 pasqyron planifikimet buxhetore për realizimin e të hyrave dhe ndarjet e planifikuara për shpenzime gjatë një periudhe të caktuar kohore e cila faktikisht në këtë vit është ndarë,

nëse mund të them, është aprovuar me një vonesë prej dy muajsh, për shkaqe të njohura për juve dhe për gjithë opinionin.

Pa marrë parasysh këto shkaqe, konsiderojmë se Qeveria e Kosovës ka arritur rezultate të konsiderueshme të cilat do përpiqem t'i shfletoj tani para jush.

Ndarjet e planifikuara buxhetore për shpenzime gjatë vitit 2008 kapin shumë prej 1.125.280.000 euro. Sa për sqarim, të nderuar deputetë, në raportin gjashtëmujor 2008 kemi paraqitur dy nivele të rregullimit të buxhetit.

Shtylla e parë, është niveli i aprovimit të buxhetit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Përfaqësuesit Special të Kombeve të Bashkuara për hir të obligimeve ligjore konform Kushtetutës para 15 qershorit të vitit 2008.

Kolona e dytë, është gjendja e cila është e sistemuar në sistemin informativ për menaxhimin e financave publike e cila quhet SIMFP.

Dallimi në mes të sistemit informativ për menaxhimin e financave publike të Republikës së Kosovës dhe Rregullores së buxhetit 2008/13 rrjedh si vijon:

- Kërkesat e organizatave buxhetore për transfere deri në vlerë prej 20%;
- Të hyrat vetjake të bartura nga viti 2007 në vitin 2008 dhe grumbullimi i të hyrave vetjake gjatë vitit 2008, të cilat nuk janë planifikuar me Rregulloren 2008/13, për çka i keni tablat e bashkëngjitura raportit që e kam dorëzuar me kohë.

Gjithsej, pra, për vitin 2008 janë 1.125.280.000 sipas SIMFP-it.

Në shumë totale, të planifikimit buxhetor, është llogaritur edhe huaja e KEK-ut e cila është aprovuar në planifikimet e rregullta buxhetore prej 79,4 milion euro.

Në vazhdim, më lejoni të paraqes raportin e ekzekutimit të buxhetit të vitit 2008. Së pari do t'i paraqes të hyrat e pastaj shpenzimet.

Sipas Rregullores së buxhetit, planifikimi vjetor për grumbullimin e të hyrave është 862.100.000 euro dhe sipas strukturës:

Të hyrat e grumbulluara gjatë gjashtëmujorit për vitin 2008, duke mos përfshirë grandët e përcaktuara të donatorëve si dhe fondet në janë 408.260.000 euro dhe paraqesin 47,4% të atyre të planifikuara. Dhe, në terma të rritjes ose të krahasimit me vitin e kaluar, në këtë vit kemi arritur, pa marrë parasysh problemet që kemi, qoftë në veri, qoftë për shkak të situatës së transicionit, qoftë për arsye të tjera, të kemi një rritje prej 10% dhe ky, konsideroj, është një sukses i Qeverisë së Kosovës dhe sukses i qytetarëve të Kosovës.

Ky trend pozitiv, krijon mundësi për realizimin e shpenzimeve të parapara me të cilat realizohen objektivat tona dhe përmirësohet jeta e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Këtu do ta keni një strukturë sipas klasave dhe më lejoni që të shkoj në kategoritë kryesore.

Tatimet kufitare, të grumbulluara nga Shërbimi Doganor, vazhdojnë të jenë pjesa më e madhe e të hyrave buxhetore dhe gjatë këtij gjashtëmujori nga doganat janë grumbulluar 262.350.000 euro, përkatësisht 11% më shumë.

Pa marrë parasysh që kemi pasur problemet në veri dhe kemi kaluar nëpër fazë të transicionit, ku shumë doganierë kanë lëshuar punën për shkak të çështjeve të ndryshme politike, ne kemi arritur që të sigurojmë një qëndrueshmëri konform planifikimeve. Po ashtu kemi arritur të ngrisim grumbullimin për 11% në krahasim me vitin e kaluar.

Tatimet vendore të grumbulluara nga Administrata Tatimore e Kosovës kapin shumë prej 95.240.000 euro apo 46,6% të planifikuarave, përkatësisht 12% më shumë sesa vitin e kaluar.

Nga të dhënat që paraqesim, gjatë këtij gjashtëmujori janë bërë kthime tatimore, sidomos në Administratën Tatimore sipas kërkesave të parashikuara që ka qenë një nga problemet kryesore të bizneseve që janë parashtruar viteve të kaluara. Pra, ka qenë kthim i ngadalshëm, përkatësisht mbajtja e TVSH dhe mbajtja e taksave të tjera ndaj bizneseve që shpeshherë është paraqitur edhe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar një nga kritikatat kryesore dhe kemi arritur këtë vit të kthejmë brenda gjashtë muajve 11.980.000 euro – para, të cilat Administrata Tatimore është dashur të konsiderojë se krahasuar me vitet e kaluara është 108,9% më e lartë.

Të hyrat jo tatimore të grumbulluara gjatë këtij gjashtëmujori kapin shumë prej 30.370.000 euro dhe paraqesin 56,3% të planifikimit buxhetor për këtë kategori, ose 5% më shumë sesa e njëjta periudhë e vitit të kaluar.

Sidomos kemi rritje në të hyrat vetjake të nivelit qendror dhe gjatë këtij gjashtëmujori janë mbledhur 15.540.000 ose 60,5% nga buxheti, nëse konsiderohet çdo gjë mbi 50% tejkalim, pra diku 10,5% tejkalim nga plani dhe 27% më lart sesa vitin e kaluar.

Sa u përket të hyrave vetjake komunale për këtë duhet falënderuar dhe përgëzuar të gjithë udhëheqësit komunal dhe qytetarët që kanë kuptuar rëndësinë e pagesës së të hyrave komunale, sidomos të hyrave nga taksat për pronën. Kemi arritur të grumbullojmë 17.190.000 euro ose 27% më shumë sesa në vitin e kaluar.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që tani t'i paraqes shpenzimet, përkatësisht të dalat nga buxheti i Kosovës për periudhën gjashtëmujore.

Ndarjet e planifikuara buxhetore sipas Rregullores 2008/13 për shpenzime janë 1.000.460.000 euro. Shpenzimet e bëra gjatë këtij gjashtëmujori janë 326.720.000 euro apo 31,2% e ndarjeve të tërësishme vjetore dhe janë nën nivel të planifikimit buxhetor, por janë dyfish më shumë se sa shpenzimet kapitale ose ekzekutimet e projekteve kapitale, pra dyfish më të mëdha sesa vitin e kaluar.

Vlen të theksohet se për këtë kategori kanë qenë rreth 190.000.000 euro mjete të zotuar apo në proces për shpenzim. Detajet e mjeteve të zotuar sipas Agjencisë Buxhetore dhe sipas kategorive ekonomike janë si vijon:

Ndarjet buxhetore për kategorinë ekonomike të pagave dhe mëditjeve janë 220.430.000 euro dhe në periudhën e parë gjashtëmujore janë shpenzuar 108.530.000 euro ose 49,2%.

Për mallra dhe shërbime, 152.170.000, përkatësisht 32,7% të ndarjeve të përgjithshme vjetore.

Shpenzimet komunale, 20.250.000 euro ose 42% e planifikimit vjetor për këtë kategori.

Unë dua të ndalem me theks të veçantë te shpenzimet kapitale për vitin 2008, të cilat kapin shumë prej 424.170.000 euro. Gjatë këtij gjashtëmujori janë shpenzuar 58.000.000, pra janë ekzekutuar deri më 30 qershor 58.860.000 euro ose 13,9% e planifikuar, ndërsa janë në proces edhe 157.000.000 euro. Gjithmonë po flasim për periudhën gjashtëmujore, sepse tani jemi në muajin shtator dhe me kënaqësi do të raportojmë se në ditën e sotme faktikisht janë ekzekutuar 115.000.000 euro apo 30% nga të planifikuarat dhe dyfishi nga ajo që është ekzekutuar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar nga Qeveria e kaluar, jo për një kritikë, por për të treguar se vërtet shifrat në aspektin absolut janë jashtëzakonisht në nivel të kënaqshëm, edhe pse kemi filluar ekzekutimin dy muaj më vonë.

Duke përmbyllur këtë paraqitje, më lejoni të theksoj se, këto shifra për të hyrat dhe shpenzimet për gjashtëmujorin e parë të vitit 2008 reflektojnë faktin se përkundër vështirësive dhe sfidave, siç e përmenda edhe më lart, që jemi ballafaquar si dhe përkundër faktit se gjatë kësaj periudhe Kosova ka kaluar nëpër momente historike, siç ishte shpallja e pavarësisë dhe, më gjithë implikimet që i pati në veri dhe në gjithë gjendjen e transicionit të institucioneve të Kosovës, Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me qytetarët e vet dhe me të gjitha institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare ka arritur t'i realizojë caqet e veta të planifikuara dhe t'i tejkalojë në mesatare diku rreth 18% të hyrat dhe të kursejë në shpenzime.

Më në fund, më lejoni, të nderuar deputetë, të theksoj se paraqitja e këtij raporti para jush jo vetëm që është një obligim ligjor, por, gjithashtu, është një përpjekje e Qeverisë së Kosovës për të qenë sa më transparente dhe më obligator, nëse mund të them, për të treguar transparencën dhe gjithë përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për dialogun me Parlamentin, me deputetët për të gjetur rrugë më të mira për ekzekutimin dhe ngritjen e efikasitetit të rritjes së buxhetit të Kosovës dhe çfarë do qoftë në të mirë të qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit, ministër! Nuk harxhove shumë kohë. Sipas radhës, ftoj kryetarin e komisionit funksional, zotin Gani Koci që t'i prezantojë qëndrimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari Kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Duke u bazuar në nenin 45 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe në Rregulloren e Punës të Kuvendit, Komisioni për Buxhet e Financa ka shqyrtuar Raportin për shpenzimet buxhetore të këtij gjashtëmujori, me datë 4 shtator 2008 dhe, në përgjithësi, ka pasur këto vërejtje, të cilat në mënyrë taksative, për të mos marrë kohë, do t'i përmend.

Në aspektin teknik dhe atë formal, ky raport i plotëson standardet mbi raportimin dhe është në nivel më të lartë sesa raporti i vitit paraprak. Mendimi i Komisionit është, që e tha edhe ministri i Ekonomisë dhe Financave, se përkrah këtë performancë të rritjes së të hyrave 10% nga ato të planifikuara. Është konsideruar se rritja e të hyrave përveç efikasitetit të Administratës, që e ka kushtëzuar një rritje të tillë, është edhe ngritja e çmimeve të shumë produkteve dhe, natyrisht, me këtë edhe është ngritur dogana dhe akciza, prandaj është edhe element tjetër i të rritjes së të hyrave.

U vlerësua e suksesshme puna e Qeverisë në kursime të bëra për kategoritë ekonomike në mallra dhe shërbime, pa dashur të futem në shifra, sepse ato i ceku edhe ministri më parë.

Vërejtje dhe konstatim i Komisionit janë se në shumë agjenci buxhetore vërehen projekte kapitale që janë bartur nga viti në vit dhe nuk janë realizuar as në këtë gjashtëmuor dhe është kërkesë e Komisionit që këto projekte ose vërejtjet në këto projekte të adresohen atje ku mund të shpenzohen dhe të mos kemi projekttime dhe në fund të kemi suficit të projektuar sikur që është diku rreth 78 milion, sipas parashikimeve.

Po ashtu, vërejtje tjetër e Komisionit është se ka shuma të mëdha të dhënies, që quhet formë e avancave, gjë që ka kërkuar edhe sqarime rreth këtyre çështjeve.

Një brengë tjetër është, sikur që u theksua edhe gjatë shqyrtimit në Komision të këtij raporti, ku kanë qenë prezent edhe këta të Ministrisë përkatëse, sidomos për vendimet e fundit për faljen e ndëshkimeve, për çka, Komisioni ka menduar se është një akt dhe veprim, ndoshta, që kishte dashur të ndodhë më ndryshe.

Dhe, duke pasur parasysh edhe disa vërejtje tjera, Komisioni i ka rekomanduar Kuvendit dhe i rekomandon që ta miratojë këtë raport.

Po ashtu, i rekomandohet Qeverisë që në pjesën tjetër të vitit fiskal ta realizojë buxhetin konform Ligjit për miratimin e buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe shpenzimeve të autorizuara për këtë periudhë dhe të menaxhojë më mirë suficitin ose deficitin eventual të buxhetit.

I rekomandohet Qeverisë të jetë më e kujdesshme ndaj agjencive buxhetore të cilat kanë bërë ngecje në realizimin e buxhetit të tyre të miratuar, sidomos në realizimin e shpenzimeve kapitale.

Duhet të them se, tetë agjenci të shpenzimeve të kapitaleve, kanë diku nën 10% të realizimit të planeve të tyre për këtë periudhë, prandaj në këtë pjesë tjetër të këtij viti fiskal duhet të kihet kujdes që të kemi një bilanc pozitiv në fund të vitit. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit! Sipas radhës, nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari Kryeministër,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Ne, siç e tha edhe kryetar i Komisionit, e kemi shqyrtuar këtë raport në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe e kemi miratuar, por Raportin me kujdes e kemi shqyrtuar edhe

nga radhët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Pra, gjatë shqyrtimit kemi ardhur në përfundim se ky raport gjashtëmujor i buxhetit është i përgatitur dukshëm më mirë, si në aspektin teknik, ashtu edhe në atë përmbajtjesor.

Po ashtu, është mirë të thuhet se raporti na ka ardhur me kohë, sikur që është paraparë me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe të përgjegjësi.

Ajo që është më kryesorja në këtë raport, vërehet një transparencë më e madhe sa i përket shpenzimeve kapitale.

Ne, gjatë të gjithë mandati të kaluar, kemi kërkuar një informacion për shpenzimet kapitale, cilat projekte kapitale kanë filluar dhe në cilën fazë të realizimit janë?

Në këtë raport të përkohshëm buxhetor ne kemi mundësi t'i shohim se cilat janë investimet kapitale, sipas projekteve dhe organizatave buxhetore, cila është vlera e projekteve të alokuara për këtë periudhë, sa prej tyre janë shpenzuar dhe sa është vlera e mjeteve të zotuar që do të thotë se janë lidhur kontratat për kryerjen e punëve, sipas projekteve të cilat janë paraparë?

Nga analiza e raportit vërejmë se shpenzimet janë realizuar 326.074.000 euro, apo 31.2% nga buxheti i planifikuar.

Gëzon fakti se po vijnë duke u zvogëluar shpenzimet në disa kategori të mallrave dhe të shërbimeve, ku në të kaluarën është abuzuar shumë.

Në këtë vit kemi një zvogëlim të shpenzimeve të udhëtimit për 27% dhe të shpenzimeve të telekomunikacionit për 22%. Shërbimet kontraktuese janë zvogëluar për 4%, që asnjëherë më parë nuk është dhënë ndonjë sqarim- pse kjo kategori e shpenzimeve në vazhdimësi është rritur?

Ky është një sinjal se Qeveria është duke bërë përpjekje për t'u shkëputur nga shfrytëzimi jo i mirë i mjeteve në kategorinë mallra dhe shërbime, që në të kaluarën janë shpenzuar në mënyrë të pakontrolluar.

Inkurajoj Qeverinë që edhe në të ardhmen të japë prova të fuqishme se është duke bërë përpjekje për t'i vënë bazat e një sistemi të mirë të menaxhimit të mjeteve në këtë kategori të shpenzimeve.

Shpenzimet kapitale kanë pasuar një rritje të kënaqshme gjatë këtyre muajve edhe pse është herët të gjykohet për këto shpenzime se për këto projekte a do të shpenzohen mjetet apo nuk do të shpenzohen në të ardhmen? Këto shpenzime janë 54% më të larta krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Nisur nga fakti se ky vit buxhetor ka filluar me vonesë për shkak të miratimit të buxhetit, shkaku i zgjedhjeve, atëherë shpenzimi në këtë kategori është i kënaqshëm me vetë faktin se janë shpenzuar 58.864.000 euro dhe janë zotuar 157.956.000 euro.

Kam bindje të plotë se Qeveria është duke punuar shumë për një shpërndarje të njëtrajtshme të shpenzimeve kapitale, në mënyrë që në të ardhmen shpenzimet kapitale të

kenë një strukturë të harmonizuar të shpenzimeve buxhetore në fillim të vitit dhe do të ulët mundësia e shpenzimit të tyre çdo herë në fund të vitit.

Të hyrat buxhetore gjatë këtyre 6 muajve të parë të këtij viti kanë dëshmuar për një angazhim serioz për vjeljen e të hyrave edhe përkundër problemeve me të cilat jemi përballuar në vazhdimësi.

Këtu është një performancë e mirë e të hyrave nga dogana, ku këto të hyra janë rritur 11%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, kurse vlen për t'u theksuar performanca e mirë në Administratën Tatimore të Kosovës, ku të hyrat nga Administrata Tatimore janë më të larta për 12% se sa që kanë qenë në vitin 2007. Të hyrat nga Administrata Tatimore kanë qenë 10% më të ulëta në krahasim me vitin 2006.

Të hyrat vetjake qeveritare janë rritur për 27%, kurse është shumë e mirëseardhur rritja e të hyrave vetjake të komunave për 27%, krahasuar me vitin 2007, kur dihet se në të kaluarën kemi pasur në vazhdimësi një performancë negative të hyrave në këtë kategori.

Qeveria ka premtuar se do t'i ulë shpenzimet dhe të bëjë rritjen e të hyrave. Nga raporti, nëse e analizojmë me kujdes, vërehet se ka ulje të shpenzimeve në disa kategori ku është shfrytëzuar jo mirë buxheti në të kaluarën ku njëkohësisht ka rritje të hyrave, prandaj Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah raportin gjashtëmujor të buxhetit. Faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka kërkuar deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Unë do të flas në emër të Grupit Parlamentar të LDK-ës lidhur me Raportin e shpenzimeve gjashtëmujore në vitin 2008 pa pasur për qëllim që të bëj fushatë duke krahasuar shifra me një periudhë të kaluar ose të tashme, por të gjitha vlerësimet, qofshin ato pozitive ose vërejtje me kohë me qëllim të mirë që të përmirësohet diçka në të ardhmen do t'i bëj me qëllim që për institucionet e Kosovës të shkojnë në një rrugë sa më të mirë të mundshme në pajtim me ligjin i cili përcakton mënyrën e shpenzimit të parasë publike.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka shqyrtuar dhe analizuar këtë raport dhe më ka angazhuar si person që jam profesionalisht më i lidhur me këtë lëmi të raportoj për përshtypjet tona lidhur me raportin.

Fillimisht ju them se ne e përkrahim raportin dhe, si të tillë, do ta votojmë.

Konsiderojmë, ashtu sikur që tha edhe kryetar i Komisionit për Buxhet, se raporti i plotëson standardet për raportim në bazë të dispozitave të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe se ofron mjaft të dhëna për ecurinë e shpenzimit dhe ecurinë e grumbullimit të hyrave publike në të gjitha sferat që Ministria e Financave dhe doganat disponojnë.

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se, nëse përkrahet raporti, nuk vërehen disa nga veprimet në realitet nëpër organizata buxhetore që nuk meritojnë të ndryshohen në të mirë, në kuptim pozitiv, pra, që të zhvillohen në pajtim me dispozitat e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Të hyrat. Jemi të kënaqur, që, përafërsisht, janë shumë afër dinamikës së paraparë me buxhetin për vitin 2008 në të gjitha kategoritë, qofshin në grumbullimin e të hyrave në kufij nga doganat dhe TVSH në kufi, qoftë nga grumbullimi i të hyrave në brendi nga ana e Administratës Tatimore, që do të thotë se 47 – 48% e realizimit të buxhetit në gjashtë muaj është shumë afër përqindjes së plotë kur merren parasysh se gjysma e parë e vitit buxhetor, në aspektin e të hyrave, gjithmonë është më e dobët, kurse gjysma e dytë e vitit, në aspekt të grumbullimit të hyrave është më e dobishme, më produktive – shpresojmë se të hyrat e parapara me buxhet për këtë vit në të gjitha kategoritë do të realizohen.

Ndoshta është e kënaqshme e dhëna se të hyrat janë rritur 10%, por nëse bëjmë një analizë kualitative të hyrave, ndoshta, nuk do të mund të jemi të kënaqur vetëm me krahasimin me 10% të vitit të kaluar, sepse duhet të kemi parasysh sa është rritur importi në këta gjashtë muaj dhe të vlerësojmë se ajo dinamikë a është kompatible me rritjen e importit në këtë periudhë të vitit kur po e analizojmë dinamikën e të hyrave. Prandaj, krahasimi me të kaluarën është i mirë për të parë dinamikën, por nuk e tregon realitetin e një pune në kuptimin cilësor. Megjithatë, në aspektin e vlerësimit të hyrave, vlerësojmë se dinamika e të hyrave është e kënaqshme dhe e inkurajojmë edhe Administratën Tatimore dhe Shërbimin Doganor që të vazhdojnë në mënyrë që buxheti të plotësohet me të hyra, ashtu sikur është paraparë, e pse jo edhe të tejkalohet.

Sa i përket shpenzimeve, shihet në shifra se dinamika është më e kënaqshme në numra sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar dhe kjo meriton lëvdatë. Por, në analizë strukturore kualitative mund të vërehet se nuk ka shumë ndryshime të dalluara pozitive. Pse po them kështu? Në totalin e shpenzimeve buxhetore, të cilat, krahasuar me buxhetin e këtij viti, janë vetëm 29.8%, ose 30%. Sipas periudhës kohore, do të ishte dashur të jetë afër 50%. Mirëpo, shumica e shpenzuar 30% është diçka më e kënaqshme, por është tepër e ulët në krahasim me dinamikën e dëshiruar. Te komunat është diçka më e mirë – 37% për shumën e mjeteve të shpenzuara, që do të thotë bashkërisht dy nivelet bëjnë 31% të shpenzimeve për periudhën gjashtëmuajore. Mirëpo, kur analizohet struktura e shpenzimeve, kemi shumë pak ndryshim kualitativ, për të mos thënë, nuk ka fare. Pse? Shuma e investimeve kapitale është realizuar vetëm 13%. Nuk e di shifrën e vitit të kaluar, por po flas për këtë vit – 13%. Nëse merret parasysh edhe fakti që nga 400.000.000 që ka pasur buxhet për investime në këtë vit, ku hyjnë edhe projektet e bartura diku rreth 36, sepse se di shifrën përmendësh, deri në 40 milion dhe në qoftë se supozojmë se investimet e bartura nga viti i kaluar kanë vazhduar në fillim të këtij viti, atëherë del se në investime e reja në projektet e këtij viti kemi përqindjen edhe më të vogël të realizimit të investimeve kapitale.

Pastaj, te shpenzimet, përqindjen e shpenzimeve buxhetore në këtë vit e rrit shumica e parave që janë përdorur për subvencione dhe transfere. E kam këtu fjalën për pensionet e rritura, që kanë ndikuar shumë në ngritjen e përqindjes dhe, po ashtu, në shpenzimet që janë bërë për importin e rrymës, pra për subvencionim të importimit të rrymës në shumë prej 19.5 milion euro dhe 4.5 milion që kanë qenë në përfshirjen e detyrimeve të familjeve të varfra, të cilat mjete të parapara për tërë vitin janë shpenzuar në tre muajt e

parë të vitit 2008. Këto shpenzime e kanë rritur vëllimin e shpenzimeve por se kualitativisht nuk mund të flasim se kemi bërë ndonjë përparim të dukshëm.

Këtë nuk po e them për ta kritikuar ndokënd, por edhe nuk dëshiroj që të krijojmë një iluzion se kemi bërë ndonjë ndryshim shumë cilësor, sepse ne e dimë, po edhe ministri i Financave e din, se për të realizuar investimet kapitale, sipas ligjit, vetëm edhe një muaj kanë kohë për të shpallur tender organizatat buxhetore. Sipas ligjit deri më 31.10 organizatat buxhetore kanë të drejtë të shpallin tender (ofertë publike) për ta kryer një punë, një investim kapital, pjesa tjetër mbetet, do të thotë, për t'u bartur në vitin e ardhshëm.

Prandaj, duhet t'i kemi parasysh këto analiza strukturore të shpenzimeve dhe të krijojmë një parafytyrim real për shpenzimet buxhetore në këtë periudhë.

Dua të them, kur jemi te pasqyrat, se janë disa defekte, për çka unë do të përpiqem në parim t'i përmend dy-tri raste, sepse diçka nuk përputhet me dokumentin e buxhetit të aprovuar me 16 shkurt dhe me atë që na është ofruar në raport.

Për shembull, në AKM, buxheti i aprovuar ka qenë, po flas për investimet kapitale, 61.800.000 euro. Në rishikim, kemi një gjendje tjetër, sepse është ndarë, AKM-ja është shuar dhe kemi një pjesë me Ministrinë e Financave, por e kemi në raport shumë e alokuar që nuk përputhet me atë që ka qenë në buxhetin fillestar dhe shuma që paraqitet këtu është 56.5 milion euro. Do të thotë për 5 milion euro ndryshon. Në shtojcën A/3 shuma është krejt tjetër, sillet në 63.221.000 euro. Po ashtu, nuk përputhen shumat në Ministrinë e Postë Telekomunikacionit. Buxheti është 89...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI I KUVENDIT: Anëtarët e Komisionit është mirë t'i harmonizojnë diskutimet. Radha është për Grupin Parlamentar të AKR-së, deputetin Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Ne sot, gjatë hartimit të rendit të ditës dhe aprovimit të tij, patëm kundërshtitë tona, por na u mor e drejta e fjalës, kryesisht edhe e shefit të Grupit Parlamentar, kështu që për mundësinë e shqyrtimit të raportit gjashtëmujor të buxhetit të Kosovës, i arritur nga Ministria e Financave, përkatësisht nga Qeveria e Kosovës – jemi kundër që sot të shqyrtohet ky raport gjashtëmujor e me të njëjtin alibi them se....

KRYETARI I KUVENDIT: Ju dëgjuat fjalën e kryetarit të Komisionit dhe ai nuk foli në emër të vetin, por në emër të Komisionit, prandaj anëtarët e Komisionit le ta dinë se e kanë votuar dhe shumica e ka miratuar raportin. Pra, mendoj se anëtarët e Komisionit duhet të pajtohen edhe këtu.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Zoti Kryetar, mendoj se nuk do të imponohem aspak nga çdo diskutim që mund të vijë nga çdonjëri nga ne këtu, sepse kryetari i Komisionit e tha sot dhe dihet se ky raport ka ardhur me 4 gusht në sirtarët e Kuvendit dhe ka qëndruar një muaj ditë, do të thotë kur ka filluar pushimi vjetor i deputetëve. Katër ditë, pas fillimit të

punës së Kuvendit, është shqyrtuar nga Komisioni për Buxhet dhe asnjë nga deputetët s'besoj që ka punuar në këtë raport, përveç anëtarët e Komisionit që e kanë shqyrtuar. Ne, sot, kthym një pikë shumë të rëndësishme të rendit të ditës për shqyrtim të një raporti të vitit të kaluar që është ai i Radiotelevizionit të Kosovës përkitazi me atë se Auditori Gjeneral ka theksuar se ka keq menaxhim të ekzekutimit të buxhetit të Radio Televizionit si një mekanizëm shumë i vogël dhe ne do të vendosim, pra, sot për 4-5 ditë mundësinë e shqyrtimit të raportit gjashtëmuor financiar të buxhetit të Kosovës. Nuk është aspak e ngutshme ta lëmë për seancën tjetër dhe ta shqyrtojmë këtë raport me të gjitha mundësitë tjera.

KRYETARI I KUVENDIT: Ju lutem, nga 3 shtatori, e sot është 19 shtator, 16 ditë...

SHKUMBIN DEMALIAJ: Sido që të jetë, është shumë kohë e shkurtër.

KRYETARI I KUVENDIT: ... keni pasur kohë që prej shqyrtimit të atëhershëm.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Në qoftë se mendoni se duhet të imponohet shqyrtimi i këtij raporti, ju vendosni, ne do të votojmë kundër si Grup Parlamentar.

(Ndërhyrje prej së largu)

Fajin e kanë edhe anëtarët e Kryesisë, sepse sot të gjitha subjektet politike duhet të bëhen transparentë, e nganjëherë edhe vetëkritikë, anëtarët e Kryesisë kur shkojnë pa diskutuar nganjëherë dhe me grupet parlamentare të vetat vendosin për futjen në rend dite. Edhe unë vazhdimisht jam bashkë me të gjithë kolegët tjerë që po thonë se çdo seancë po duhet të hiqen pika të rendit të ditës nga seanca. T'i shqyrtojnë mirë mundësitë dhe të mos merren gjërat ashtu nga Kryesia.

KRYETARI I KUVENDIT: Ju lutem, rendi i ditës propozohet në Kryesi bashkë me shefat e grupeve parlamentare dhe pse ju nuk i harmonizoni qëndrimet...

SHKUMBIN DEMALIAJ: Shefat e grupeve parlamentare nuk votojnë.

KRYETARI I KUVENDIT: ... e grupeve parlamentare, është problem i juaj. Nuk është problem as i Kryetarit, as i Kryesisë. Ne kemi bërë rendin e ditës me kërkesën e komisioneve.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Ne, nuk kemi dërguar shefa të grupeve në monitorim në Kryesi dhe shefi i Grupit meqenëse nuk ka të drejtë vote...

KRYETARI I KUVENDIT: Problem i juaj është, nuk është i Parlamentit.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Atëherë, ne do të votojmë kundër. Është kohë e shkurtër.

KRYETARI I KUVENDIT: Është e drejtë e juaja dhe shfrytëzoni atë të drejtë. Urdhëroni, Gani. Fjalën e ka Gani Koci.

GANI KOCI: Unë dua të ripërsëris atë që e thashë në seancën e paradites. Raporti ka ardhur me 4 gusht dhe ne, edhe gjatë pushimeve, jemi deputetë dhe mendoj se është dashur ta përcjellim këtë. Më 4 shtator Komisioni, në përbërjen e vet, vetëm në mungesë ka qenë e Shkumbinit.

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit, Gani! Vazhdojmë. Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Sot biseduam për buxhetin që për Parlamentin është një ndër punët më serioze, më të rëndësishme, por edhe për Qeverinë.

Tri herë kemi zhvilluar biseda për buxhetin në këtë vit: kur është miratuar buxheti në fillim, kur kemi kaluar nëpër rishikim të buxhetit dhe tani që po diskutojmë për raportin për gjysmë viti të realizimit të buxhetit. Që të tri herët, Kuvendi i Kosovës ka pas problem. Që të tri herët kemi diskutuar vonë, pasdite. Që të tri herët, i kemi pasur për ngutë. Dhe, ka ardhur koha për thënë që, nuk besojmë se janë realisht ko incidencë tri herë. Tri herë duhet të përfundojë transmetimi që të mos e dëgjoji populli se çka bisedohet për paranë publike, për shpenzim të parasë publike. Tri herë ka qenë dashur të kalojë shpejt e shpejt e të mos ketë mundësi të shoshishet çështja më e rëndësishme, për të cilën diskuton Parlamenti me Qeverinë, realisht.

Kemi problem dhe ky është problem serioz i demokracisë në Kosovë. Është problem serioz i yni. Prapëseprapë, unë do të ndalem vetëm te dy ose tri çështje që kanë të bëjnë me këtë raport, për çka me siguri kolegët e mi do të shkojnë pak më në detaje.

Nuk do të ndalem tek avanset. Dikush foli, le të flasin edhe tjerët. Nuk do të ndalem tek shpenzimet e telekomunikacionit, të cilat janë ulur, por janë ulur më pak sesa që janë ulur çmimet e operatorit të vetëm prej të cilit Qeveria merr kartela. Do të thotë, çmimet kanë rënë më shumë se shpenzimi. Shikoni ju lutem, sepse nuk janë çështje të na thuhën neve këtu që janë ulur shpenzimet. Janë ulur, kjo është krejt në rregull, por, çmimet janë ulur më shumë se shpenzimet. Do të thotë që shpenzimi i impulsit është rritur, i numrit ë impulseve, realisht.

Tani do të ndalem te dy çështje, të cilat kanë qenë tema shumë serioze të Qeverisë së Kosovës që prej fillimit, bile-bile edhe gjatë fushatës: drekat dhe darkat. Bile, më kujtohet vetja mua këtu, një herë, kur u kam thënë ministrave “hani bre se po vini të uritur”. Po më duket, më kanë kuptuar keq, sepse 12% e kanë rritur shpenzimin në krahasim me Qeverinë e kaluar, domethënë 12% më tepër kanë ngrënë darka e dreka.

Shembulli tjetër është një çështje tepër serioze, për të cilën Qeveria ka folur shumë dhe ka qenë qiraja. Ka qenë një premtim i drejtpërdrejtë i Kryeministrit të Kosovës që nuk do të ketë më institucione me qira, se nuk do të paguajmë më qira, se nuk do të abuzojmë kësioj me paranë publike. A dini çka ka ndodhur? Edhe parat për qira janë rritur. Domethënë, edhe qira, kjo Qeveri në gjashtë muajt e parë ka paguar më shumë se Qeveria e kaluar.

Përkundër faktit si shembull ta marrim, institucionet ndërkombëtare, disa prej tyre po i lëshojnë zyrat, sepse ka , domethënë, tepëricë të zyrave sot, tash është e çuditshme pse është rritur qiraja. Dhe, seriozisht, kam menduar për këtë punë, a mos mund të ndodhë për shkak të themelimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Forcës së Sigurisë? Jo, nuk është ashtu, se Ministria e Punëve të Jashtme nuk është me qira, është në objekt të Qeverisë. Dhe, aq më tepër, dje ministri na tha: “Deri në qershor unë s’kam

funksionuar si Ministri”. Domethënë deri në qershor s’ka funksionuar Ministria e Punëve të Jashtme, kështu që nuk ka pasur mundësi të rriten shpenzimet në qira për shkak të Ministrisë së Punëve të Jashtme. E njëjta gjë, vlen për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, e cila është themeluar pak rishtazi.

Tani dikush duhet të fillojë edhe të mendojë. Qysh bën, domethënë, të rriten shpenzimet për qira në këtë kohë, përkundër premtimit më të qartë të mundshëm që ka mund të japë një kryeministër i një vendi? “Nuk ka më qira, kemi për t’i hequr krejt”. “Ju keni abuzuar”, na thoshte neve atëherë. Pra, është krejt në rregull, edhe kjo shkoj.

Ministri i Financave na foli për shumë çështje këtu tash neve për shumë të arritura, por nuk foli për asnjë prej këtyre problemeve që po i përmendi unë. Nuk tha që “po, kemi rritje në qira” dhe të na shpjegojë pse. Nuk foli për këtë punë. Nuk foli as pse reprezentacioni është rritur. Mirëpo në këto fletët që i keni marrë ju, nuk quhet reprezentacion. Ia kanë ndërruar emrin. I kanë thënë “përfaqësim”. Është shumë interesant. Gjithmonë është quajtur reprezentacion dhe nuk po e mbroj atë fjalë, se nuk besoj që ajo është fjalë më e mirë se kjo e dyta, por është ndërruar fjala, është bërë “përfaqësim”. Me siguri prej përfaqësimit në futboll, e çka po di unë, tjerat si janë, është ndërruar fjala do të thotë. Po ai përfaqësimi është reprezentacioni, janë drekat dhe darkat për të cilat fola. As për këto nuk foli ministri. Domethënë, çka na tha ministri, nuk e pat guximin për të na thënë:” Krejt mirë i kam bërë”. Mirëpo, janë dy ose tri elemente të cilat nuk janë bash mirë. A mund ndokush prej Qeverisë të na thotë neve, ndonjëherë, që po, mirë-mirë-mirë, sepse normalisht duhet të flas mirë për veti, sepse s’bën ndryshe, gjithkush flet mirë për veti. Ama, të paktën, pak duhet të jetë vetëkritik. Pak të thotë:” Në këtë pikë jemi keq, nuk jemi mirë.”

Tjetra. Një element tjetër, një premtim tepër i madh është suficiti. Nëse ju kujtohet, çka ka ndodhur në fushatën e kaluar për suficit, edhe e shihni tash se kemi suficit të programuar diku afër 70 e sa milion euro. Prapë duhet menduar! More, a janë të njëjtit njerëz që i kemi dëgjuar ne përpara dhe çka po ndodhë tash? Domethënë, pse ka kaq shumë suficit? Pse ka kaq shumë suficit kur ka edhe vrapim të tmerrshëm për të shpenzuar mjete pa menduar se ku po shkojnë. Vetëm të shpenzohet buxheti. Çka do qoftë të ndërtohet, të hapen tenderë për t’i shpenzuar dhe prapë nuk munden, iu dalin diku nja 70 milion euro suficit.

I përmendi komunat. Secili prej nesh kemi dëshirë të shohim përparim në komuna, të shohim rregull në buxhet, të shohim rritje të hyrave vetjake të komunave. Kjo është mirë për Kosovën dhe ka ndodhur, është e vërtetë. Mirëpo, vetëm sa për kënaqësi të deputetëve dhe të popullit, ministri ka qenë dashur të na përmend në cilat komuna ka qenë rritja më e madhe në inkasimin e të hyrave vetjake dhe në cilat komuna më të vogla dhe pse? A ka faj komuna, a ka faj Qeveria ose, a është meritë e komunës, për ta shndërruar në pozitive këtë çështjen e fajit? A është meritë e komunës, a është meritë e Qeverisë qendrore dhe pse ka ndodhur ashtu? Pse ka ndodhur shembull ta marrim që në Pejë dhe në Gjakovë është rritja më e madhe e të hyrave vetjake? Diku tjetër, mos të kuptohem ndryshe, është më e vogël.

Shembull të marrim, neve na duhet të na shpjegohen këto çështje nga ministri. Jo pse nuk i kuptojmë, ne të gjithë i kuptojmë dhe edhe ju i kuptoni, por ne duhet të shohim se çka po mendon ministri, sepse ne e kemi zgjedhur. Cili është qëndrimi kritik i ministrit? Dhe, në fund të fundit, a e ka kuptuar ministri atë që e kemi kuptuar ne? Dhe ne duhet të jemi

të sigurt që edhe ministri e ka kuptuar. Nëse nuk na tregon, atëherë ne mund të fillojmë të spekulojmë se, ndoshta, ministri s'e paska kuptuar, ose s'po don të na tregojë.

Unë, po dua t'i lë kolegët e mi të bisedojnë më tepër në të ardhmen, por kur flitet për transparencën po e përmbyll me atë që thash në fillim. Ministri duhet të jetë transparent, duhet të vijë me kohë, seancat duhet të mbahen kur e dëgjon publiku, se janë për publik, janë parat e publikut dhe ministri nuk duhet ta bëjë Kuvendin që ta presë ministrin. Nuk ka mbledhje më të rëndësishme se seanca plenare e Kuvendit për asnjë ministër. Ministri duhet ta dijë, edhe pse vetë nuk është i zgjedhur, që seanca plenare e Kuvendit është mbledhja më e rëndësishme për këdo qoftë. Nuk ka mbledhje më të rëndësishme. Dhe, ka qenë e paraparë shumë më përpara, domethënë, ministri nuk është befasuar. Në fakt, neve ministri na e ka caktuar agjendën. Vetë e ka caktuar ditën dhe kur ne duhet të diskutojmë, ministri nuk është këtu, sepse ka mbledhje më të rëndësishme.

Nuk janë të mira këto për demokracinë, nuk janë të mira për ne, nuk janë të mira për vendin. Unë kërkoj prej jush t'i merrni parasysh qofshi edhe në pozitë, qofshi edhe në pushtet – merrni parasysh këto çështje, se nuk po i bëjnë mirë vendit. Faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit! Radha është për Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë. Fjalën e ka deputeti Berim Ramosaj. Kërkoj falje, në vend të tij, paraqitet Besa Gaxherri. Urdhëroni!

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra të pranishëm,

Me të vërtetë, askund në botë, në asnjë vend të botës demokratike, Kuvendit nuk ia cakton agjendën Qeveria, por ndodhë e kundërta.

Sot, hiç ma larg, ne kemi pasur këtë pikë të parë të rendit të ditës. Kjo pikë e rendit të ditës është shtyrë për në orën 14,30 dhe kemi filluar diku në 15,10 – a 15,15. Kjo të jep të kuptosh se vërtet Qeveria e cakton agjendën në Kuvend, Qeveria e luan rolin tamam të një monarku. Kuvendi, si organi më i lartë i këtij shteti nuk respektohet dhe po them shumë sinqerisht kjo nuk është shenjë e mirë. Kjo nuk i kontribuon demokracisë, nuk i kontribuon as respektimit të ligjit, as Rregullores së Kuvendit të Kosovës.

Prandaj, zoti Kryetar, edhe ju keni një përgjegjësi. Duhet të punosh me Qeverinë tuaj që të jetë më e disiplinuar, që të dijë ta respektojë Kuvendin dhe të jetë në momentin e duhur në Kuvend. 120 deputetë ta presin një ministër të vijë të referojë për një pikë shumë të rëndësishme kur flitet për buxhetin, qoftë për planifikimin e buxhetit, qoftë për shpenzimet, të hyrat e ku ta dijë unë, sepse kemi të bëjmë me një pikë shumë të rëndësishme. Në çdo vend të botës, çdo shtet demokratik i kushton vëmendje të veçantë, ndërsa ne sot e shqyrtojmë këtë kur deputetët e kanë humbur përqendrimin dhe fillojmë të debatojmë për këtë pikë kur nuk ka transmetim. Domethënë, na jepni të kuptojmë... Ju lutem shumë, nuk dua të përfundojë ky diskutim me vetëm prononcimin e kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Secili deputet duhet të hyjë thellë, sepse sot po flitet për paranë publike, për paranë e qytetarëve. Qysh ka hyrë në buxhetin e Kosovës paraja e këtyre qytetarëve dhe qysh po shpenzohet? Kjo është një temë shumë e rëndësishme, nuk mund të shkojë kjo veç sa për sy e faqe të flitet dhe vetëm se e kemi shti në rend dite.

Gjithsesi duhet të kthehem pa të keq, ju lutem shumë sinjerisht. Ky material ka ardhur në kohën kur Kuvendi ka qenë në pushim. Hajde t'ua sqaroj se u bë shumë debat këtu. Një muaj ne kemi pasur pushim. Ta zëmë se kemi qenë jashtë Kosove. Nuk kemi pasur mundësi të vijmë ta marrim materialin, sepse kemi qenë në pushim jashtë Kosove dhe Komisioni i Buxhetit e ka thirrur mbledhjen e Komisionit një ditë para të mbahet mbledhja me telefon. Është shkelur procedura ose Rregullorja e Kuvendit. Kemi hyrë në Komision dhe ende s'ka ardhur procesverballi. Nga opozita, kam qenë vetëm unë prezent. Kam propozuar dhe falënderoj kryetarin që e ka qitur në propozim se nuk jeni të përgatitur sot të diskutojmë këtë material, por normalisht se shumica kanë votuar për. Mirëpo, është thyer procedura, zoti Kryetar dhe sot na ka ardhur dhe të gjithë deputetët sot e kanë marrë rekomandimin nga Komisioni i Buxhetit. Unë ende s'e kam marrë procesverballin ta di çka është biseduar atë ditë në Komision të Buxhetit. Këto nuk bëhen pa qëllim.

Megjithatë, unë dua të ndalem në pika shumë të shkurtra ose në vija të trasha në këtë raport.

Dua të ndalem vetëm në të hyrat dhe shpenzimet për këta gjashtë muaj. Në bazë të këtij raporti, shohim se të hyrat gjashtëmujore të vitit 2008 janë në shumën prej 408.260.000 (katërqind e gjashtë milionëve, pikë 26 milionë euro), ose 47.7% dhe pagesat, të dalat e realizuara në gjashtëmujorin **2008** kanë arritur shumën prej 326.072.000 që paraqet diku 31.2%, domethënë nuk e ka mbërri as 50%.

Kur jemi te kjo shumë e të hyrave, për çudi, e nderuar Qeveri, që nuk jeni komplet se harrova të them, kur diskutohet për të hyrat dhe shpenzimet e buxhetit, secili ministër duhet të jetë këtu, në krye me shefin e vet. Këtu vjen vetëm kush ka kohë, kujt i del kohë vjen e kujt s'i del, ka punë më të mençme.

Domethënë, këtu mua më befason ky farë planifikimi i të hyrave buxhetore tuaja. Ju këtu paraqitni se në këto të hyra afër 50% e keni realizuar planin. Çudi, po të kishte mos ndodhur ajo në doganë që 500 mijë euro në ditë ka humbje buxheti i Kosovës, ju do ta kishit 200-fish, a – të hyrat e Kosovës. Shumë çudi! S'keni ditur t'i planifikoni. Ose, i keni planifikuar që vërtetë doni t'i mbyllni pikat doganore atje dhe ne do t'i humbim milionat, sikur që i kemi humbur që prej shkurtit dhe megjithatë, ne kemi arritur 47% planin e të hyrave.

Tash, nga i kemi këto të hyra? Janë nga doganat, nga Administrata Tatimore. S'po dua të flas për çdo të hyrë, por po dua edhe te Administrata Tatimore të ndalem pak. Ne dimë se mbi 200 milion borxhe kanë bizneset – Administrata Tatimore. Dhe, zoti ministër, na kemi dëgjuar si Kuvend i Kosovës përmes mediave se Qeveria ka vendosur t'ia falë gjordat të gjitha bizneseve që kanë borxhe ndaj buxhetit të shtetit apo të këtij shteti. Në rregull, zoti ministër! Por, një gjë e tillë nuk guxon ta bëjë Qeveria, të marrë vendim Qeveria, sepse është ligji dhe në ligj decidivisht theksohet edhe gjorda qysh merret, ku merret. Kjo çështje ishte dashur të shtrohet në Kuvend. Ndoshta do të kishit gjetur arsyen për të na bindur që vërtet duhet t'ua falim gjordat këtyre bizneseve, por të merrni vendim mbi Kuvendin, mbi ligjin, si Qeveri, kjo nuk është e pranueshme. Dhe njëkohësisht, çka po bëjmë ne? Ata njerëz të cilët nuk e respektojnë ligjin, nuk e respektojnë shtetin, ne i falim, i ndihmojmë, i përkrahim. Ndërsa, ata njerëz të cilët vërtet donë ta respektojnë këtë shtet dhe donë t'i paguajnë obligimet, ata vërtet diskriminohen ose fyhen në këtë

formë sikur ne dimë herë përmes atje pagesës në energjetikë, herë këtu në Administratë Tatimore dhe kjo është e papranueshme, zoti ministër.

Unë po ju kërkoj që për këtë pikë, në qoftë se nuk keni filluar veç ta zbatoni, të vjen si pikë e veçantë në Kuvendin e Kosovës dhe, ndoshta, vërtet do të gjeni forcën ta arsyetoni dhe edhe Lidhja Demokratike e Dardanisë ndodhë që ju përkrah. Por jo kështu në këtë formë. Jo- Kuvendi i Kosovës t'i shkelë vendimet e Kuvendit. Ky Kuvend ka marrë vendim, me shumicë. I përgëzoj edhe deputetët nga pozita që nuk kanë lejuar të ndahen 15 milion për një objekt, i cili ende ka problem pronën, pra nuk e ka të zgjidhur. E kemi dhënë arsyen, kemi votuar, ndërsa ju, Qeveri e nderuar e shkelni vendimin. Kuvendi për ju çka është? Ju jeni Qeveria. Të na rrojë edhe Qeveria! Edhe e shkelni vendimin, plus asaj e shkelni Ligjin e prokurimit dhe s'ka rëndësi për juve çka thotë Ligji i prokurimit. Me rëndësi për ju është a ju shkon biznesi dhe a është më i lirë a më i shtrenjtë nuk ka rëndësi? Edhe kjo, është e papranueshme, Qeveri e nderuar.

Dhe kalojmë pastaj tek shpenzimet, për të cilat do të mundohem të flas diçka në vija të trasha. Shikoni, kolegë të nderuar, kjo Qeveri, realisht edhe me rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar, thotë se nuk guxon të rritet numri i punëtorëve – të punësuarve. Dhe, në bazë të këtij raporti, ju e keni rritur numrin diku për nja 300-400 punëtorë. Duhet normalisht të rritet se normalisht i keni ata që iu keni premtuar, të partive, duhet t'i shtini në punë, mirëpo kjo nuk i kontribuon buxhetit të Kosovës.

Dhe kur shohim këtu, tek rrogat dhe pagat, vetëm në dalje tash, ne shohim se 6% ka ngritje të pagesës së rrogave dhe pagave, shkurt për të mos u lidhur në shifra.

Kalojmë te mallrat dhe shërbimet. Gjithë kohën, në mënyrë deklarative, keni thënë – do t'i ulim shpenzimet e karburanteve, të telefonisë e tjera. Nuk na ka dalë ashtu. As ju s'keni mund të dëshmoni, përkundër asaj që nuk është dashur të shqyrtohet në Kuvend rishqyrtimi – rebalanci gjashtëmujor pa na ardhur ky raport. Edhe aty ne kemi bërë një kalim.

Tash, këtu ne shohim se ju keni ngritje në mallra dhe shërbime për 2%, pa humbur kohë shumë, sepse e kemi përshkrimin këtu dhe po t'i hyjmë edhe përshkrimit, pastaj shohim se vërtet nuk i keni mbajtur fjalët.

Te shpenzimet komunale nuk po ndalem shumë. Po ndalem pak te subvencionet dhe transferet. 30% i keni rritjet në subvencione dhe transfere. Dhe, është për çudi, që diku, për shembull ku i keni zbritur dhe ku i keni rritur kjo është e papranueshme. Po i theksoj vetëm, për shembull, gjobat ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit! Radhën e ka... Mirë. Regjia, vazhdojani edhe për një minutë!

BESA GAXHERRI: O Kryetar, faleminderit! Por, kjo është ironia e jetës së Kosovës. Nuk është për të qeshur, ju lutem. Është buxheti, janë shpenzimet, paraja e këtyre qytetarëve të shkretë që vërtet mezi e kalojnë ditën deri në fund. Megjithatë, unë po e përmbyll. Me shpenzimet kapitale, që, Qeveri e nderuar, do të keni suficit dhe sipas kësaj, ky është vetëm një vazhdim i ish- Qeverisë. Do të thotë, keni suficit edhe në

investimet kapitale dhe ju nuk keni parashikuar që i keni 150% ngritje, për shembull, të blerjes së veturave në krahësim me vitin 2007 dhe ua kanë rritur këto investimet kapitale, por nuk jeni gati ta përmbyllni me 50%. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Radhën e ka Grupi Parlamentar” 7+”,përkatësisht Mufera Shinik e ka fjalën.

MÜFERA ŞINIK: Faleminderit!

Sayın başkan, bakanlar ve milletvekilleri

Bugün burada 2008 yılının altı aylık bütçe raporunu tartışıyoruz. Bütçe hazırlanmasında ve harcamalarda daha fazla dikkat edilmesi gerektiğini ve kabul edilen projelerin zamanında başlatılarak, zamanında bitmesi için özen gösterilmesinin gerektiğini vurgulamak istiyorum. Buna göre 2008 yılının altı aylık bütçe raporunu 7+ Parlamenter Grubu olarak kabul ediyoruz.

Teşekkür ederim.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Radhën e ka Grupi Parlamentar i SLS, prej tyre s’e ka kërkuar askush fjalën. Atëherë, konsiderojmë se shëfat e grupeve e kanë kryer me këtë diskutimin. Tani është radha e deputetëve. Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla. Le të përgatitet deputeti Ismet Beqiri.

GJYLNAZE SYLA: I nderuari, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kuvendarë,

Për çdo familje në Kosovë, shpenzimi i buxhetit ka rëndësi të madhe për mirëqenien e asaj familje. Po aq e rëndësishme, për çdo familje në Kosovë, është buxheti i Kosovës, menaxhimi i mirë i tij dhe shpenzimi efektiv i tij, sepse nga kjo do të varet se çfarë shërbime do t’u ofrohen shtetasve të Kosovës. A do të ketë rrymë 24 orë, a do të ketë ujë? Çfarë do të jetë gjendja e rrugëve, çfarë do të jetë shëndeti? A do të ketë rritje të pagave të mësuesve, të punëtorëve shëndetësorë, të pensionistëve? Po ashtu, nga kjo varet përfitimi i besimit të donatorëve dhe investorëve.

Prandaj, raportin e përkohshëm të buxhetit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2008 do ta vlerësoj nga shpenzimi i parasë publike në interesin më të mirë të çdo familjeje në Kosovë. Fjala ime do të jetë në korniza të respektimit të së vërtetës dhe të besimit, sepse me besimin fillon politika, por edhe përfundon nëse besimi humbet.

Që nga marrja e pushtetit, Qeveria vazhdimisht ka bërë propagandë lavdëruese se ka bërë zvogëlime të shpenzimeve milionëshe, se është e aftë të shpenzojë buxhetin dhe njëkohësisht ka adresuar kritikën e vazhdueshme qeverisë së kaluar për keqmenaxhim.

Siç thashë, do ta respektoj të vërtetën. Çka në të vërtetë pasqyron raporti gjashtëmujor?

E para. Është e vërtetë se të hyrat buxhetore janë për 10% më të larta, por janë më pak se sa janë planifikuar, për 23 milion më pak se sa janë planifikuar. Ky nuk është indikacion i suksesit, por është indikacion i planifikimit jo të mirë.

E dyta. Buxheti vazhdon të mos jetë i qëndrueshëm, sepse 64% mbushet nga dogana, kurse 44% nga të hyrat e brendshme. Ky është indikator për paqëndrueshmërinë e buxhetit, nuk është indikator i suksesit.

E treta, sa i përket shpenzimeve, janë shpenzuar 200 milion euro më pak se sa është planifikuar. E kjo, çfarë është, sukses, sigurisht se jo?

Niveli më i rregullt i shpenzimeve është shënuar në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, ashtu siç e tha ministri, 49.2%.

E katërta. Në gjendjen më të keqe janë shpenzimet kapitale. Nga 424 milion euro, sa janë paraparë, janë shpenzuar vetëm 59 milion euro, që do të thotë 14% nga ato të planifikuara.

Vetë Ministria e Ekonomisë dhe Financave pasqyrën që e ka ofruar për investimet kapitale është 0%, kurse sipas projekteve 1%.

Ky është indikacion i rëndësishëm për paaftësinë e menaxhimit dhe sinjal i keq për donatorë dhe investitorët, sidomos për donatorë, të cilët i kanë dhënë Kosovës 1 miliard e 200 milion euro.

E pesta, sa i përket deklaratave të vazhdueshme të Kryeministrit se kjo Qeveri ka kursyer miliona, si dhe të anëtarëve tjerë të Qeverisë, lidhur me kursimet e mëdha, unë dëshiroj prapë të fokusohem në të dhënat e pasqyrës.

Thotë, për derivate të naftës janë shpenzuar 10 milion euro. Qeveria e kaluar ka shpenzuar 7 milion euro. Kjo qeveri, pra ka shpenzuar 3 milion euro më shumë. Vazhdimisht janë bërë deklarata se Qeveria e kaluar ka pasur shumë vetura, janë dhënë veturat në ankand. Zotërinj të nderuar, Zyra e Kryeministrit i bleu 10 vetura nga UNMIK-u

E gjashta, Kryetari i Grupit Parlamentar të Aleancës e tha se kemi suficit prej 78.67 milion euro. Ky definitivisht është indikator i paaftësisë për menaxhim dhe shpenzim efektiv të buxhetit. Por, çka duhet ndryshuar?

1. Mentaliteti i qeverisjes dhe praktikat e qeverisjes, duhet të ndryshohen, duke u nisur nga shembujt individual të personave që bartin përgjegjësi publike.

Është me rëndësi që Qeveria të jetë e sinqertë dhe të ketë besimin e plotë të qytetarëve, të cilët ua ka dhënë besimin për t'i menaxhuar paratë e tyre. Premtimet duhet të mbahen. Qeveria nuk duhet të bëjë deklarata pompoze, por duhet të bëjë punë grandioze. Mos mbajtja e premtimeve po zhvillon reputacionin e premtimeve të thyera dhe kjo do të rezultojë me humbjen e besimit në zotimet që i ka bërë Qeveria dhe rrjedhimisht, me humbjen e besimit të qytetarët.

2. Menaxhimi duhet të jetë efikas dhe produktiv, të zbatohet dhe t'evitohet shpenzimet e panevojshme. Një sistem më efikas i monitorimit të shpenzimeve kapitale duhet të ndërtohet. Nuk ka projekte afatgjata, kurse ekzistueset ngelin në realizim.

Duke marrë parasysh buxhetin, çdo mangësi në menaxhimin e suksesshëm do të paraqesë ngecje serioze në ndërtimin dhe zhvillimin e shtetit.

Për ta evituar këtë dukuri, i propozoj Kuvendit që Komisioni për Buxhet dhe Financa të ngre një nën komision për monitorimin e shpenzimeve kapitale të gjitha organizatave buxhetore. Ky nën komision duhet të udhëhiqet nga anëtari i opozitës.

Zoti Kryetar,

Kërkoj nga ju që këtë propozim ta vëni në votim dhe të autorizohet Komisioni për Buxhet dhe Financa që të propozojë përbërjen e nën komisionit dhe formën e organizimit të tij.

3. Ngritja e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e buxhetit, sidomos të donacioneve, sepse duhet të fitohet besimi te donatorët.

Ky raportim dhe raportimet e vitit 2007, duhet t'i shërbejnë Qeverisë që të bëjë performancë më të mirë dhe t'evitohet të metat në procesin e buxhetimit.

Për stabilitet ekonomik, për jetë më të mirë të çdo familjeje në Kosovë, i kërkoj Qeverisë: kursim, racionalizim, mbikëqyrje, përgjegjësi dhe profesionalitet.

Sa i përket përgjegjësisë, ku është zoti Kryeministër?

Mbase, mos prezenca e tij, është injorim i plotë jo vetëm i Kuvendit, por edhe më keq, i interesimit për paratë publike të popullit të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri, le të bëhet gati Naim Maloku.

ISMET BEQIRI: Zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministra prezentë,

Sigurisht se shumëçka u tha dhe duke mos dëshiruar të përsëris për atë që është e mundshme, por, megjithatë, shqetësimi i të gjithëve dhe i imi personal është në mes të asaj që është planifikuar dhe asaj që është shpenzuar. Vetëm këto dy shtylla, duke pasur parasysh se gjithsesi duhet përshëndetur faktin se rritja e të hyrave është një fakt se ka ndodhur dhe kjo na inkurajon dhe na jep një vetëbesim se qytetarët tanë edhe në këtë mënyrë po i kryejnë obligimet karshi institucioneve. Mirëpo, përkundër shtimit të këtyre të hyrave, sigurisht, është dashur të shtohet edhe përqindja e realizimit, posaçërisht të projekteve të natyrës së investimeve kapitale.

Athua kjo, në njëfarë mënyrë, disharmoni në mes të shtimit, që është pozitive për ta përshëndetur të hyrave nga ajo që është planifikuar, në fillim të vitit, në mes të asaj se sa janë shpenzuar këto mjete, posaçërisht e kam fjalën gjithnjë për investimet kapitale dhe njëkohësisht nevojave shumë të mëdha që i kemi nëpër agjencitë e caktuara buxhetore. Po e them edhe një herë, kjo mospërputhje, në të dy të parat e thashë në aspektin pozitiv se është planifikuar më pak dhe është realizuar më shumë, është mungesë e projekteve që do të nënkuptonte mungesën edhe të kuadrove për hartimin e këtyre projekteve kapitale

posaçërisht apo është diku-diku nëpër organizata të caktuara buxhetore mungesë e angazhimit dhe punës. Domethënë, të gjitha këto do të duhej të merreshin parasysh posaçërisht, po e përsëris, tek investimet kapitale dhe të shpenzimeve kapitale, pse jo, është shqetësuese nëpër shumë komuna tona dhe po i marr komunat si një agjenci shpenzues ose agjenci buxhetore. Kjo përqindje e realizimit të investimeve kapitale, vërtet, në disa ose shumicën prej tyre është shqetësuese, duke e ditur dhe duke qenë i vetëdijshëm se unë e kuptoj që më vonë, sigurisht, në fazën shumë të madhe të realizimit të shumë projekteve kjo përqindje edhe do të rritet, për këtë jam i vetëdijshëm dhe është vështirë që çdoherë edhe të realizohen ato që parashihen, duke pasur parasysh edhe procedurat që po ashtu mundohem t'i kuptoj. Krahasimi me vitin e kaluar të hyrave vetanake gjithsesi duhet përshëndetur për ngritjen e tyre. Por, sigurisht krahasimi me vitin e kaluar të shpenzimeve si një lloj avancimi, megjithatë mendoj se nuk ka vend, sepse nuk shihet se ka një ngritje shumë të lartë.

Duke qenë, po ashtu, i vetëdijshëm se ky suficit, ashtu siç e thatë edhe ju, zoti ministër, do të ndodhë afërsisht ose në përqindjen e caktuar, megjithatë do të duhet një angazhim shumë më të madh të gjithë neve, flas posaçërisht të agjencive shpenzuese dhe të gjithë ata që kanë mundësi ndikimi pozitiv, që vërtet, ky suficit të mos jetë ose të jetë sa më i vogël që është i mundshëm, sepse, vërtet, në mes asaj që po kërkojmë shpeshherë shumë agjenci kërkojnë para për realizim të projekteve dhe për shpenzimet e tyre, sikur kanë edhe disharmoni ose mungesë të realizimit të këtyre projekteve.

Uroj që sa më pak të kemi suficit buxhetor.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Naim Maloku. Le të përgatitet Fatmir Rexhepi.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Në këtë debat, që është i një rëndësie të veçantë dhe më i rëndësishmi për Kuvendin dhe Qeverinë, dua të konstatoj me keqardhje për atë që po shihet se mungojnë pjesa më e madhe e ministrave dhe e Kabinetit qeveritar, që nuk ishte dashur të ndodhë kështu.

Unë nuk dua të hyj në detaje dhe në gjëra të cilat, parafolësit e mi i thanë, por më lejoni të përqendrohem në dy-tri çështje, të cilat i kam ngritur edhe më përpara në këtë Kuvend dhe nga ajo ngritje të këtyre çështjeve nuk ka pasur rezultat gjer më tani.

Zoti ministër, e kam fjalën për evazionin fiskal dhe krimin e organizuar në dy segmente të tregtisë në Kosovë, atë me derivate të naftës dhe tregtinë me pakicë e shumicë të arit, argjendit dhe prodhimeve nga metalet e çmuara.

Unë, me plot të drejtë, duke përcjell si unë si ju lëvizjet dhe gjendjen në këto dy segmente, mund me siguri të konstatoj dhe me përgjegjësi të madhe se në masë të madhe ky është krimi i organizuar në Kosovë dhe evazoni fiskal më i madh që po i ndodh Kosovës dhe krimi më i madh që po i ndodh buxhetit të Kosovës, zoti ministër dhe Qeveri e nderuar.

Zoti ministër,

Unë dua t'ju citoj replikën tuaj në fjalën time, në seancën më 18 prill të këtij viti, kur është debatuar për 100-ditshin e Qeverisë. Nga transkripti nga ajo seancë, faqe 49 Ju keni thënë zoti ministër, citoj:

“Unë të garantoj, pra, që në periudhën më të shkurtër të mundshme dhe në javën e ardhshme do të jetë një paketë e tërë për të luftuar, siç e ke quajtur, “petrol-mafinë”, për të luftuar evazionin fiskal dhe për t’i ndërprerë të gjitha këto gjëra. Ndërsa, në gjashtë muajt e ardhshëm do të vendosen arkat fiskale të cilat ne do t’i kontrollojmë secilat”. Përfundoj citatin.

Kjo është, zoti ministër, fjala e juaj para 5 muajve në këtë Kuvend. Unë nuk e di për cilën javë e keni pasur fjalën, por kanë kaluar shumë javë dhe ju nuk e keni bërë asnjë hap.

Asgjë mos t’ju kishte nxitur, zoti ministër, për t’i vënë arkat fiskale në të gjitha pompat e benzinës në Kosovë. Vetë ndezja e dy pikave doganore, ky kishte për të qenë hapi i parë që është dashur ta ndërmerr Qeveria e Kosovës. Pra, kontrollin e distribuimit me pakicë të naftës dhe derivateve të naftës në Kosovë dhe në atë mënyrë ju ta kontrolloni se çfarë sasive naftë hyn kontrabandë në territorin e Kosovës. Pse nuk e bëni këtë? Pse, zoti ministër, Qeveria, e cila si flamur e ka ngritur luftën kundër krimit të organizuar, nuk ka guxim të përballlet me këto fenomene? Ju jeni ekonomist i zoti dhe nuk dua të hyj në lëmin tuaj, por ju e dini se çka do të thotë ky evazion fiskal dhe çfarë ndikimi ka në të gjitha tregjet tjera, edhe në paluajtshmëri, e tjera dhe çfarë pasoja mund të kenë dhe kanë qytetarët e Kosovës, shtresat e varfra dhe të mesme?

Zoti ministër,

Javën e kaluar, në një familje në Pejë, janë zbuluar 58 kilogram ari dhe dhjetëra-mijëra euro. Supozoj se ka qenë i rastësishëm. Një telefonatë policisë, ndoshta për shkak të ndonjë interesi që e ka pasur ndonjë qytetar në atë treg dhe nuk është aftësi e inspektorëve dhe nuk është aftësi, sipas mendimit tim, e policisë. Është rastësi, zoti ministër. Por, kjo, tregon shumë se çfarë dhe çka po ndodh në atë treg dhe me çfarë sasish kemi të bëjmë në atë treg të zi në Kosovë që, ju nuk keni ndërmarrë asnjë hap. Ju nuk e keni marrë asnjë veprim zoti ministër dhe Qeveri e nderuar për t’i vënë në kontroll. Unë nuk do të doja të hyj andej se qysh janë bërë pronarë e si, ata të atyre pompave e tjera, e kush është krejt i implikuar? Unë kërkoj që ai treg të jetë i kontrolluar dhe të jetë në kuadër dhe brenda suazave të ligjit.

Zoti ministër dhe Qeveri e nderuar,

Duke parë dhe përcjell punën zero tuajën në këtë drejtim, atëherë vetvetiu, pa dashur t’ju akuzoj, shtrohen katër pyetje: A është kjo mos punë e juaja dhe mosdashje për t’u përballur me këto fenomene, pasojë e neglizhencës tuaj si Qeveri, si ministra, apo është, ndoshta, si rezultat i implikimit tuaj direkt në këtë treg, apo qëllimshëm ju nuk po doni të merreni me këtë fenomen?

Për të mos qenë vetëm kritik, zoti ministër, ju duhet t’i ndërmerrni urgjentisht këta hapa: të sillni ligjin për arkat fiskale, sepse më duket në çdo kuvend të botë ka kaluar dhe duhet të vijë ligji për arkat fiskale në Kuvendin e Kosovës dhe të përkufizohen me ligj pasojat që do t’i kenë, qoftë tregtarët e qoftë edhe klientët që marrin mall dhe furnizohen pa tiketat fiskale. Atë ligj nuk e keni sjell, zoti ministër.

Tjetra, duhet të shpallet gjendje e jashtëzakonshme në tri ministri: në Ministrinë e Financave, Tregtisë e Industrisë dhe të Punëve të Brendshme dhe brenda një kohe shumë të shkurtër të bëhet kontrolli i krejt këtij tregu, pra me pakicë dhe shumicë dhe të vihen arkat fiskale dhe të bëhet kontrolli.

Zoti ministër,

Sipas mendimit tim është krijuar një piramidë e këtij lloj mafiozllëku dhe pompat e benzinës, argjendaritë, inspektorët e tregut ose financiar në komuna të ndryshme dhe deri te dikasteret tuaj. Ju duhet t'i ndërroni vazhdimisht inspektorët e tregut dhe ata financiar nga një komunë në tjetrën në mënyrë që të ndërpritet lidhja e shkurtë në mes të inspektorëve financiar dhe të tregut dhe keqbërësve apo tregtarëve, që janë, e unë nuk dua t'i fyej individët që vërtet dhe, ndoshta, me ndershmëri e punojnë këtë punë, por në masë të madhe, zoti ministër, Qeveri e nderuar këto dy segmente të tregtisë në Kosovë janë evazion fiskal dhe krim i organizuar.

Zoti ministër,

Ndoshta nuk e ka vendin, por shfrytëzoj rastin që gjatë këtij debati të ngrit edhe çështjen e Trustit Pensional të Kosovës, për shkak se edhe ajo është para publike dhe para e jona, e qytetarëve dhe punonjësve të Kosovës. Tani pasi që veç jemi shtet i pavarur dhe kemi ingerenca më shumë mendoj se ju duhet të ndërmerrni si Ministri dhe si Qeveri hap të shpejtë, veprim të shpejtë që ajo para të drejtohet kah bankat e Kosovës. Unë e kuptoj se ndoshta në të kaluarën, për shkak të UNMIK-ut ose kompetencave tjera nuk i është lejuar qeverive të mëparshme një hap i tillë, por zoti ministër, mendoj se ju duhet të ndërmerrni sa më shpejt këtë hap dhe ato të holla që janë para e qytetarëve tanë, e punonjësve por edhe jona këtu të ruhet dhe të investohet e të hyjë në tregun financiar të Kosovës.

Zoti ministër,

Mendoj se ju duhet ta sillni në Kuvendin e Kosovës ligjin për t'u shpall pasuri e shtetit e gjithë ajo tokë që është nën 40 centimetra në sipërfaqen e tokës. Kjo është me rëndësi për shkak të gjitha pasurive minerale dhe të gjitha pasurive nëntokësore që i posedon dhe i ka Kosova dhe të mos abuzohet me to. Besoj se po e kuptoni ku po e qes, pra te Feronikeli dhe shfrytëzimi

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi, le të përgatitet deputeti Xhevdet Neziraj.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëritje, kolegë deputetë,

Ministra të Qeverisë së vendit, përsëritje,

Tani kur po debatohet për raportin e përkohshëm të buxhetit gjashtëmuor, unë personalisht për të dhënë ndonjë kontribut të vogël në këtë temë, mjaft të rëndësishme, do të jam i rezervuar që të bëj ndonjë vlerësim të plotë apo më të thelluar për arsye se do të presim përfundimin e vitit, atëherë kur edhe Qeveria do ta bëjë një vit të plotë të punës dhe për të parë vërtet edhe bilancin edhe krahasimin, performancën, kapacitetet dhe mendoj unë personalisht si deputet do të jam ai që tek atëherë do të shoh realisht që vërtet si mund ta matim punën e Qeverisë në mënyrë që të bëjmë vlerësime sa më reale.

Kjo tani, në këtë fazë, më shtyn të them diçka më tepër në formë të sugjerimeve për të korrigjuar diçka, për të ndihmuar diçka në fazën e dytë, pra, për aq kohë sa ka mbet deri në fund të vitit me qëllimet më të mira.

Prandaj, objektivat e planifikuara kur është fjala të të hyrat, ato veç janë realizuar dhe është mirë.

Unë personalisht shoh këtu që të hyrat nga dy kategori që duhet krahasuar janë se të hyrat kufitare apo nga doganat, të cilat janë diku mbi 262 milionë euro dhe të hyrat nga TVSH e brendshme që kapin shumën rreth 95 milionë euro, diku një raport përafërsisht 3 me 1.

Prandaj, meqenëse ministri, është profesor dhe njohës i kësaj fushe, kisha dashur ta dëgjoj interpretimin e tij lidhur me atë se cila është perspektiva e këtij faktori të derdhjes së parës jashtë të këtij importi të madh të qarkullimit të parës jashtë, të hyrave të brendshme dhe si e sheh perspektivën në jetën ekonomike të vendit dhe si do të jetë mundësia që të ndryshohet ky raport.

Te politika e menaxhimit apo e shpenzimeve, po ashtu, mendoj se duhet të provojmë të korrigjojmë diçka që është në interesin e vetë politikave të Qeverisë.

E para, u përmend çështja e treguesit këtu rreth 6%, ngritja e pagave. Pra, le të më lejohet ta bëj një digresion të vogël, për shkak se dje shtrova në renditje një çështje që Kryetari i Kuvendit fort nuk e mori me përkushtim se tha – nuk janë procedurat. Po sot, debati i sotshëm, këtu në Parlament, me të thënë të drejtën më dha shumë të drejtë, do të thotë, për shumë çështje që u bënë me rend e pa vend, këtu që të mendojmë edhe diçka tjetër, pra që të merremi me seriozitet dhe të shohim për të bërë trajtimin real dhe objektiv të mundësive buxhetore edhe për kategoritë e tjera në ngritjen e pagave. Pra, nuk i gjetëm vend, nuk i gjetëm hapësirë.

Unë nuk e marr me aq komoditet këtë, kur them se duhet të ketë ngritje, sepse, si duket më shumë po bëjmë nganjëherë pak, të them, zhurmë dhe propagandë nëpër media sesa realisht po e shfrytëzojmë këtë foltore në këtë Parlament për ta bërë debatin real, të marrim rekomandime, por edhe Qeveria t'i marrë zotimet dhe detyrat për t'i kryer në funksion të atij projekti, të atij programi që e kemi shtruar bashkërisht.

Unë e di që, ndoshta, kjo pak është akomoduar, edhe nga unë si Fatmir Rexhepi, deputet dhe Haxhi Merxha këtu se i kemi afër 4 fish më të mëdha rrogat se çdo mjek në shëndetësi e mos të flas për Kryetarin e Kuvendit, Kryesinë e Kuvendit apo Kryeministrin që i kanë 8 deri 10 fish pagat më të mëdha. Pra, ne detyrohemi që të trajtojmë temën ashtu si duhet.

Te politika e kategorisë, bie fjala, e shpenzimeve - subvencioneve dhe transferove, unë do të përmend këtu, që për fat të keq, nuk e kam këtu kolegun Bajrush Xhemajli, të cilin e përsëndes, por ai i ka lënë disa trashëgimtarë këtu në Kuvend. Ganiu iku diku, se i thashë Ganiut se do të përmendi diçka. E kam fjalën për Gani Kocin, se edhe ai, bashkë me mua, kemi bërë potere bajagi shumë në këtë foltore atëherë kur nuk kemi lënë, do të thotë, seancë pa e ngritur zërin pse nga buxheti i Kosovës po subvencionohet KEK-u? Pra, bajagi gjatë kemi folur në këtë Kuvend dhe tash po më intereson mua pse ndërroi politika? Pse nuk ia ndjeva zërin kryetarit të Komisionit të Buxhetit që deri atëherë, e ngritke zërin me të madhe e sot nuk e tha asnjë fjalë lidhur me atë pse po financohet kaq tepër KEK-u nga buxheti i Kosovës? Prandaj, janë diku rreth 20 milionë që u përmendën nga kolegët, edhe 20 të tjera deri në fund të vitit e unë mendoj, si politikë pra, nuk është e mirë. Bile, po të ishte Ganiu këtu do t'i kisha thënë diçka si koleg deputet atij për

shkak, po them, të gjitha sugjerimeve më herët që i kemi dhënë dhe kritikën bashkërisht me mua, që transferi i mjeteve për KEK të mos bëhet përmes bankës, por të bëhet përmes Komisionit për Buxhet dhe bile atë me atë provizion ta shpërblejmë Komisionin për Buxhet se s'e ka thënë asnjë fjalë sot.

E kam edhe një sugjerim, do të thotë, që kërkon një angazhim dhe një përkushtim më të madh. Nuk e them se është lehtë për Qeverinë, larg asaj, pavarësisht. Kur është çështja të shpenzimet, ajo u pa se është diku rreth 31% që është shumë e vogël, por unë mendoj se në pjesën e dytë do të korrigjohet, por, realisht, të investimet kapitale ku po t'i shikojmë të gjitha edhe në komuna edhe te ministrinë përkatëse sillet diku prej 4 deri në 25% maksimumi, ose 27% në ndonjë komunë. Kjo do të thotë se në gjashtëmujorin e dytë duhet bërë shumë më tepër punë për t'i realizuar, qoftë ato projekte apo për të përmbyllur atë politikë të cilën e ka projektuar Qeveria para veti, në mënyrë që të mos na ndodhë ajo që shpeshherë e kemi pasur në fund të vitit me teprica të mëdha, sikur që u tha edhe nga kolegët e mëhershëm.

Prandaj, unë po them, le të jetë ky debat i sotëm si një shans, do të thotë, për të ndryshuar diçka në politikë, e sidomos le të jetë një vërejtje për të gjithë ne dhe për Qeverinë e edhe për parlamentarët që kur të debatohet për politikën buxhetore të vitit 2009, atëherë t'i shohim defektet të cilat i kemi pasur ose të shohim, realisht, objektivat qysh i kemi planifikuar, ndarjen e mjeteve si e kemi bërë nëpër ministri, ku e kemi tepruar me derdhjen e mjeteve, ku kemi lënë keq si kulturën, sportin dhe të tjerat dhe një infrastrukturë tjetër, ndoshta, diku. Prandaj, është mirë që të jetë kjo një shenjë e mirë dhe ne të mësojmë nga kjo, në mënyrë që gjatë debatit në nëntor apo dhjetor kur ta përfundojmë dhe parashohim për 2009, vërtet, të na shërbejë si një punë e mirë. Unë e përkrah në parim dhe e mbështes me dëshirën që të punojmë më mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Ke dalë me një pjesë të caktuar nga rendi i ditës, por po të tregoj dhe po flas se nëse merret parasysh puna dhe angazhimi i Kryetarit të Parlamentit dhe puna e angazhimi yt si deputet, e ke pagën më të mirë se të Kryetarit të Parlamentit. Fjalën e ka Xhevdet Neziraj. Le të përgatitet Bahri Hyseni.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti Kryetar i Parlamentit,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë, si anëtar i Komisionit për Buxhet e Financa, do të ndalem në disa çështje të cilat i kemi shqyrtuar dhe kemi rekomanduar në Komision. Përveç anëve pozitive, është e qartë se edhe të metat e këtij gjashtëmujori i kemi cekur në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Unë nuk do të ndalem në atë që kolegët diskutuan rreth disa çështjeve, nuk do të ndalem në shpenzimet, nuk do të ndalem në paga e mëditje, nuk do të ndalem në disa kategori që u përmendën, as në subvencionin për energji dhe disa tjera. Por, do të ndalem në dy çështje, për të cilat jemi duke u monitoruar nga institucionet ndërkombëtare dhe ai është suficiti dhe mbi punësimi, që do të thotë është paraqitur edhe në këtë gjashtëmujor.

Dua të them se edhe ministrinë që kanë mjete më të mëdha të dedikuara për shpenzime, si Ministria e Transportit dhe Ministria e Arsimit, i kanë realizuar me të vërtetë diku deri 13% investimet kapitale dhe droja është se në fund të vitit do të ketë suficit shumë më të madh, duke pasur për bazë edhe Ligjin për prokurimin dhe tenderimin. Është e paarsyeshme të justifikohemi para qytetarëve kur ndërtohet një shkollë në Dardani dhe

tani ajo shkollë nuk ka tabela ose shkumësa, ndërsa në anën tjetër është realizuar 13% i investimeve kapitale nga Ministria e Arsimit. Ky është një sinjal që agjencitë buxhetore duhet të përgatiten me kuadro, sepse ministri nuk mund t'i bëjë ato, mirëpo agjencitë buxhetore duhet të kenë njerëz që duhet t'i planifikojnë dhe t'i harxhojnë mjetet sipas dinamikës së planifikuar. Kjo do të thotë se nëpër çdo agjenci buxhetor nëpër ministri nuk ka kuadro që dinë t'i planifikojnë dhe t'i realizojnë dhe tani në fund të vitit mund të na ndodhë ajo më e keqja sikur që ka ndodhë shpeshherë – të bëhen shpenzime të panevojshme dhe shpenzime vetëm sa të harxhohen mjetet dhe të ikim nga suficiti, e ai është një krim edhe më i dyfishtë, sepse kemi kohë që të planifikojmë me kohë dhe të investojmë me kohë.

Para 2-3 ditësh në mediat e shkruara del ministri i Shëndetësisë, thotë: "Me 30 milionë mund ta zgjidh problemin e shëndetësisë". E ne i kemi 75 milionë suficit, kjo, me të vërtetë është shumë qesharake. Pse atëherë nuk gjendet modus që në fillim të shfrytëzohen ato mjete në mënyrë shumë më racionale dhe të justifikohemi para qytetarëve të Kosovës se vërtet me ato mjete dimë të menaxhojmë dhe t'i shohim sferat që janë shumë me rëndësi dhe që prekin nevojat e qytetarëve. Kur e kemi një suficit të tillë dhe themi se po t'i kishim ato para do të kishim zgjidhur probleme, kjo po më duket se është një alarm që edhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave, por edhe sektorët nëpër ministri e në agjencitë buxhetore duhet të mendojnë shumë mirë dhe sidomos, për planifikimin e buxhetit të vitit 2009. Unë besoj se nuk duhet të humbur shumë kohë, por duhet të mendojmë të planifikojmë shumë mirë buxhetin e vitit 2009 dhe qysh tani të angazhohet edhe Komisioni për Buxhet dhe ekspertët, por edhe Parlamenti, sepse në shumë vende të botës diskutohet tre muaj e më shumë për një buxhet dhe jo sikur neve që na bie gjithmonë dhe si rast urgjent dhe vetëm për një a dy orë duhet kryer, sepse thonë jemi vonuar dhe të mos mbesim pa paga dhe mëditje në vitin e ardhshëm.

Prandaj, është sinjal që edhe kjo Qeveri – ka thënë zero tolerancë suficitit. Kjo Qeveri ka thënë se do të kemi një zvogëlim shumë të madh të shpenzimeve. Nuk është kah ndodhë kjo. Atëherë, duhet t'i përvishemi punës dhe të justifikohemi para tatimpaguesve. Unë shpresoj se në të ardhmen duhet të ulet Komisioni për Buxhet, të thirren edhe ekspertë të ndryshëm me qëllim që ministrinë të jenë shumë më përgjegjëse në planifikimin dhe, që është më kryesoja, në shpenzimin cilësor, sepse zoti Shala, jeni ekonomist dhe e dini se ka shpenzime cilësore dhe jocilësore dhe në shumicën e rasteve po kemi shpenzime sa për sy e faqe vetëm sa për t'u harxhuar buxheti. Prandaj, duhet t'i kushtohet më shumë rëndësi shpenzimeve cilësore, në mënyrë që do të përfitojnë të gjithë qytetarët e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Naim Maloku, pak më parë e lexoi një stenogram të Kuvendit. Është mirë t'i lexojnë disa deputetë stenogramet e vitit të kaluar. Fjalën e ka Bahri Hyseni. Le të përgatitet Berim Ramosaj.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëritet, të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të gjithë e kuptojmë se buxheti është një indikator tregues se si Qeveria, qoftë qendrore dhe ajo lokale, ka efikasitet në punën e saj, se sa menaxhon drejt me paranë publike, sa është e gatshme që të shpenzojë investime të cilat i ka planifikuar për një vit fiskal? Gjithashtu është indikator tregues se sa përfitojnë qytetarët e Kosovës në sfera të

ndryshme të jetës, sa është përmirësuar jeta e tyre në infrastrukturë, në shërbime komunale, në arsim e shëndetësi?

Për të bërë një krahasim tillë, duhet pasur parasysh të bëjmë dallimin ndërmjet kategorive që u përmendën më parë, të hyrave si kategori shumë e rëndësishme për buxhetin e Kosovës dhe, natyrisht, të dalave apo pagesave që bëhen nga planifikimi buxhetor.

U përsëritën dhe unë po e përsëris. Nëse, Qeveria ka arritur të shpenzojë në përqindje 47.4% nga ajo që ka planifikuar në planin buxhetor, me plotë të drejtë mund të thuhet se është në trend të zhvillimit normal dhe, natyrisht, ka qenë planifikim i drejtë. Nëse shkohet në këtë trend për të krijuar të hyrat, konstatohet se në fund të vitit fiskal të hyrat do të krijohen ashtu siç janë të planifikuara në buxhetin e Kosovës. Dhe, shifra 10%, që është më e madhe se në vitin krahasues në vitin 2007, duket e vogël, por në esencë është shumë e madhe, sepse flitet për një kategori ku buxheti i Kosovës fiton pa ndonjë ndryshim që është bërë prej vitit 2007 në vitin 2008.

Po ashtu, vlen të përmendet te kategoria tjetër te pagesat apo të dalat. Nëse merret si përqindje e përgjithshme 31.2, ndoshta, nuk është në raport me planifikimin buxhetor shumë e këndshme, por duke pasur parasysh se buxheti është aprovuar me vonesë, duke pasur parasysh se nuk janë 6 muaj të plotë për këtë raport të buxhetit dhe duke pasur parasysh krahasimin në vitin 2007, krahasimin prej 18.1% me plotë të drejtë mund të thuhet se edhe këtu ka rezultate pozitive. Natyrisht, periudha në gjashtëmujorin e dytë do të jetë periudhë, duke pasur parasysh se shumica e kontratave janë kontrata afatgjata, do të ketë rritje edhe në këtë kategori dhe se në fund të vitit fiskal mund të pritët që shpenzimet do të jenë përafërsisht ashtu siç janë planifikuar në buxhetin e Kosovës.

Unë, jo rastësisht, kam bërë dallimin ndërmjet tri kategorive. Të hyrat vetjake komunale dhe për dallim nga kolegët që përmendën disa komuna, unë i kam shikuar të gjitha komunat, duke i përfshirë edhe komunat pilot që i kemi. Dhe, të gjitha komunat e Kosovës, me përjashtim të tri komunave, dy për të cilat e dimë se nuk funksionojnë shumë mirë për shkak të situatës politike – Shtërpca dhe Novobërda dhe për Malishevën për të cilën nuk kam njohuri, të gjitha komunat kanë krijuar të hyra më të mëdha, me përqindje shumë të lartë edhe deri në 76% në krahasim me vitin 2007. Dhe këtë duhet të kemi parasysh, këtu nuk ka ndryshuar asgjë, as infrastruktura ligjore, por ka ndryshuar vetëm menaxhimi i drejtë dhe efikas i qeverive komunale. Është i njëjti staf, të njëjtat procedura, të njëjtat vendime të asambleve komunale, por këtu shihet se stafi që ka ardhur t'i drejtojë komunat e Kosovës po menaxhon drejt. Dhe, nuk është për çudi, asnjëherë nuk mund të planifikohet buxheti për grumbullim në mënyrë të përpiktë, sepse propozimi dhe planifikimi bëhet në bazë të raportit të vitit 2007 dhe askush nga komunat e Kosovës nuk ka mund të planifikojë që dikush mund të mbledhë me të njëjtin staf, me të njëjtat rregullore, deri në 70% buxhet më tepër se në vitin paraprak. Prandaj, për këtë duhet të jemi krenarë dhe shifra e fundit nuk është e vogël – 17 milionë euro me 13 milionë euro është dallim i madh dhe tregon se ka menaxhim të drejtë. Natyrisht se mund të jetë edhe më mirë, se mund të jetë edhe më i dobishëm, por kjo që është vlen të përmendet se është rezultat pozitiv.

U përmend shumë kategoria tjetër, që e konsideroj shumë të rëndësishme – mallrat dhe shërbimet. Nëse shikohet drejt, me plotë të drejtë e thanë shumica e kolegëve që diskutuan, nuk ka shumë dallim ndërmjet kësaj Qeverie dhe asaj Qeverie sa i përket kësaj kategorie të shpenzimeve dhe dallimet janë në një përqindje shumë të vogël, në

përqindje të përgjithshme është vetëm 2%, por konsideroj që duhet të ndalemi pak te kategoritë ekonomike. Nëse i krahasojmë shpenzimet e udhëtimit, janë për gjysmë milioni më të vogla. Shërbimet e telekomunikimit janë, gjithashtu, përafërsisht në një shumë diku rreth 400 milionë euro më të vogla dhe nuk janë pak për një periudhë 3-4 mujore, sepse nuk është periudhë e plotë gjashtëmujore. Pajisja me mobile dhe pajisja me inventarin që e kanë përdorur organet që i drejtojnë institucionet, nëse krahasohet me vitin 2007 është shumë më vogël. Natyrisht që qiraja dhe disa kategori tjera ekonomike janë të përafërta me shpenzimet e vitit 2007, por duhet të kuptojmë se ato kontrata janë kontrata afatgjata dhe Qeveria nuk ka pasur mundësi, ndoshta, edhe t' i shkëputë brenda kohës së caktuar, por është objektivë që në të ardhmen të shikojë që këto kategori të mos kenë shpenzime kaq të larta siç është qiraja. Prandaj, ndoshta, është mirë edhe të rekomandohet edhe nga ky vend që Qeveria duhet të ketë parasysh që qiratë apo kontratat për qira në të ardhmen të shkëputen dhe të kalohet në ndërtesat të cilat e kanë karakterin e ndërtesave publike dhe të mos paguhet qira.

Dhe, kategoria e tretë, që gjithashtu, është kategoria më e rëndësishme – shpenzimet kapitale. Pa dashur të lëvdoj, sepse ka edhe kritika që duhet bërë, nëse shikohen investimet kapitale dhe problemet me të cilat është ballafaquar edhe tash vonesa e miratimit të buxhetit, pastaj duke marrë parasysh se te investimet kapitale shumica e kontratave janë kontrata të cilat nuk përfundojnë në një vit fiskal, por kalojnë edhe në vitin e ardhshëm fiskal. Duke marrë parasysh se në shumicën e kontratave duhet të lihet edhe ai 10 përqindëshi për sigurinë e kryerjes së punëve që bëjnë kompanitë e ndryshme, atëherë me plot të drejtë mund të thuhet se ka trend pozitiv, sepse dallimet janë në esencë dhe dallojnë diku edhe me miliona.

Me gjithë këto përparësi, mund të thuhet se Qeveria në të ardhmen duhet të ketë një shikim, ndoshta, që planifikimin rreth shpenzimeve, në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, ta zvogëlojë dhe sidomos atje kur kemi pak rritje të pagave dhe pagesave është mirë, ndoshta, në të ardhmen të shikohet edhe duke iu përshtatur rregullave të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa që të mos kalohet kjo kategori.

Prandaj, unë mendoj se në përgjithësi mund të thuhet se ky raport, që ka ardhur nga Ministria për Ekonomi dhe Financa duhet të përkrahet, sepse të gjitha trendet e kategorive shpenzuese të hyrave janë duke shkuar në rrugë të mbarë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Berim Ramosaj. Le të përgatitet deputeti Driton Tali.

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë, ministra,

Vërtetë, krejt atë që desha ta them e thanë kolegët. Unë, ndoshta, do të përqendrohem vetëm në disa pika që kanë kuptimin e këtij raporti buxhetor për ndërtimin e strategjisë së shfrytëzimit të mjeteve në përgjithësi.

Edhe këtë buxhet, edhe në këtë gjashtëmujor, nga shënimet del se e mundon problemi i zërit kryesor të hyrave që janë të hyrat nga doganat. Këtë do ta pranojë edhe ministri i Financave, sepse agregati kryesor i të hyrave prapë janë të hyrat nga doganat që nuk është tregues i mirë për vendet që pretendojnë të kalojnë fazën e emergjencës. Kryesisht, vendet që janë në fazën e emergjencës dhe vendet që nuk kanë potenciale të mjaftueshme as të autoritetit fiskal, as të kapaciteteve të përgjithshme të brendshme, nuk mund ta

tejkalojnë këtë. Ky është një minus që në fakt që po përcillet edhe nga Qeveria e kaluar. E njëjta gjë ishte edhe nga periudha e kaluar, domethënë është një vazhdimësi.

Të hyrat në përgjithësi, nëse krahasohen me shpenzimet, del se ka rritje 10%. Mirëpo, le ta dinë qytetarët, le të dini edhe ju se këto shënime nuk janë të valorizuar as me rritjen e importit, që kemi rritje të importit, as me rritjen e çmimeve, që kemi rritje të çmimeve, as me rritjen e inflacionit, që kemi inflacion. Këto tri kategori e degradojnë treguesin 11% apo 10% që shihet këtu si rritje e të hyrave. Pa dyshim, që kisha me i shtuar këtij fenomeni edhe një element tjetër, në qoftë se krahasojmë këtë pjesë të buxhetit, domethënë gjashtëmujorin dhe buxhetin e 2008-shit, vjen në pikëpyetje a është në harmoni me kornizën afatmesme të shpenzimeve. Duke ditur mirë ne, se në Konferencën e donatorëve kemi konkurruar me kornizën afatmesme të shpenzimeve, shihet se edhe në planin e të hyrave, edhe në planin e shpenzimeve ka dallueshmëri shumë të madhe dhe atë strukturore edhe në të hyra edhe në shpenzime në krahasim me kornizën afatmesme e kjo, ka pasoja. Ndonjë donator, i cili vërtet është donator i fuqishëm apo potencial që ka premtuar se do t'i japë donacion Kosovës, në qoftë se sheh këto rezultate që ne kemi ndryshuar edhe në rebalanc buxhetin me kornizën afatmesme, e në të njëjtën kohë tash edhe ky raport i buxhetit nuk është në harmoni as me kornizën, kjo del se ne nuk jemi në harmoni me atë që u kemi premtuar donatorëve, iu kemi premtuar miqve tanë se do ecim kësaj rruge me këto shpenzime, me këto të hyra potenciale.

Rritja e të hyrave, më tepër del si rezultat i rritjes së importit. Ky është treguesi kryesor ndoshta që edhe pse i kemi tri pika doganore të mbyllura, prapë kemi rritje të hyrave nga doganat, sepse në fakt është zëri kryesor i të hyrave dhe mu për atë nuk mund të na ndryshojë.

Të ardhurat komunale, janë më të mëdha. Po ashtu, kemi edhe tendenca të rënies së shpenzimeve nëpër komuna. Por këtë nuk mund t'ia veshim si rezultat kësaj Qeverie, sepse aspektet buxhetore, respektivisht kanë pavarësi buxhetore komunat, andaj secila komunë veç e veç do të krenohet edhe me rezultatet dhe me dobësi të veta. Këtu nuk mund të bisedohet për atë.

Edhe një çështje, desha ta sqaroj. Kur është fjala te investimet kapitale, unë kam menduar edhe te shpenzimet e mallrave dhe shërbimet dhe të pagave se, vërtet sa i përket pajisjeve teknike – teknologjike, qoftë të institucioneve qendrore, qoftë lokale kam menduar që qeveria e kaluar ka përfunduar, kishin mjaft shpenzime të fryra edhe për vetura edhe për pajisje të zyrave, edhe për atë... Unë kam menduar se do të ketë rënie të këtyre zërave të shpenzimeve, por në këtë raport buxhetor nuk shihet një gjë e tillë. Këtu duhet sigurisht të jetë një sinjal i mirë për të gjitha ministrat që të menaxhojnë më me racionalist buxhetet e tyre.

Ajo çka dua të them, si konkluzë nga kjo është se edhe pse është krenuar kjo qeveri dhe ka dhënë premtime se do të jetë qeveri e ndryshimeve, në bazë të këtyre shënimeve, në bazë të këtij raporti buxhetor, nuk ka treguar ndryshim esencial nga periudha e kaluar. Është një kontinuitet i thjeshtë, një kontinuitet edhe në lëmin e shpenzimeve të tepërta, edhe në lëmin e mos ndryshimit të zërave të hyrave, po ashtu sikur kanë qenë më parë. Andaj, bien poshtë të gjitha ato premtime se do të jetë një qeveri efikase, andaj shihet se është një kontinuitet i thjeshtë, një kontinuitet i Qeverisë së kaluar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk është bash krejt ashtu, profesor, zi, por ka edhe bardh. Fjalën e ka deputeti Driton Tali. Le të përgatitet Ramadan Avdiu.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të jesh pa grup parlamentar po më kushton se po duhet kah i fundit të flas, pra, kisha pasur çka të them në grupin tim parlamentar. Sidoqoftë atë që desha ta them janë thënë në forma të ndryshme, zoti Kryetar, e tash do t'i prek disa pika të cilat edhe ashtu u prekën, duke tentuar që të mos i përsëris dhe mos t'ju mërzis edhe juve tjerëve.

Do të ndalem te dy premtime, të cilat i ka dhënë koalicioni qeveritar, sidomos partneri më i madh dhe ato kanë qenë planifikimi dhe organizimi dhe se këto dy premtime nuk është kah i përmbush. Kështu, siç u tha, po më duhet tash ta përsëris, planifikimi i këtij buxheti është një përsëritje e planifikimeve të tjera të viteve të kaluara të qeverive të mëparshme të cilat kanë qenë ashpër të kritikuar për mos zotësi dhe një gjë e tillë tash këtu po përsëritet që nga të hyrat e përfundojnë të të dalat.

Është e pakuptueshme se si, them e pakuptueshme kështu në mënyrë metaforike, se si nuk mund të planifikohen të hyrat që 10 vjet në Kosovë, gjithmonë do të dalin ose më shumë ose më pak. Gjithmonë duke e ditur problemin e njëjtë që e kemi vjet për vjet.

Është jo e sigurtë, për cilindo subjekt politik dhe ajo po na kushton si skenë politike për të premtuar diçka që, realisht, nuk kanë mund tjerët ta bëjnë edhe kur kanë dashur ta bëjnë. Kjo veç po na kushton se siç e dini këto zgjedhjet e fundit 38% të elektoratit ka dalë në zgjedhje nga fakti se në zgjedhje po gënjehet, kështu është disponimi në elektorat. Po thonë partitë politike veç po rrejnë dhe

KRYETARI: Të lutem, e kemi fjalën për buxhetin, jo për zgjedhjet!

DRITON TALI: ... pikërisht te planifikimi se është rrejtur gjatë fushatës. Të paktën këtë po thonë se po rrejnë, kanë rrejtur.

KRYETARI: Megjithatë, ekziston një normë e fjalorit të deputetit, në Parlament.

DRITON TALI: Më fal pra, kanë gënjer. Ka pasur edhe gënjim, apo gënjeshtër, s'është folur e vërteta. Sidoqoftë, unë, mbase po ju maltretoj, por ashtu është zoti Kryetar, me secilën linjë buxhetore që u tha këtu dhe s'po dua ta zgjasë se sinjerisht del ashtu.

Po ndalem pak edhe te organizimi. Një nga premtimet më të mëdha që i kemi dhënë ka qenë organizimi i ndryshëm i aparatit shtetëror, duke premtuar efikasitet, ekspertizë, profesionalizëm. Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar doli me atë kritikën që herët e patëm thënë këtë se në ndërmarrje, në bordet publike janë personat e pakualifikuar dhe në institucionet tjera të ekonomisë që është pjesë e organizimit të kësaj qeverie të punës, që është pjesë e këtij buxhetit. Sidoqoftë po ndalem pak më konkretisht të shpenzimeve. E kam dëgjuar njëherë nga arsyetimet e Qeverisë se çështja e derivateve, shpenzimeve në derivate është se është ngritur çmimi i naftës. Andaj, kjo qeveri ka shpenzuar më shumë se Qeveria tjetër në periudhën e njëjtë për shkak të çmimit më të lartë. Nuk është ashtu, për shkak se përqindja e rritjes së shpenzimeve në derivate nuk korrespondon me përqindjen e rritjes së çmimit të naftës në treg apo të derivateve tjera. Dhe nuk kanë premtuar, nuk keni premtuar për të ardhur në pushtet se do ta marrin nivelin e njëjtë të apo uljen e vogël të shpenzimeve, por ulje drastike. T'ua përkujtoj juve, zoti Kryetar, se

po e shoh që pak po ju mërzis, zoti Kryeministër pat ardhur me bujë të madhe me atë që do t'i kursejë 40 – 50 milionë euro që bëri jehonë u përshëndet nga të gjithë qytetarët e Kosovës. Po ky buxhet nuk po e tregon një gjë të tillë. Pastaj do t'ia rikujtoj edhe zotit ministër, sidomos se ka qenë zëvendësudrejtor i AKM-ës, pras jo saktësisht në PDK, të paktën kështu ka qenë publikisht, se kolegët e tij patën premtuar që Fondin e Privatizimit ta sjellin në Kosovë, gjatë fushatës por edhe para fushatës. Dhe është kritikuar AKM dhe qeveria e kaluar se paratë e privatizimit janë jashtë sistemit ekonomik të Kosovës. Tash ish -zëvendësudrejtorin në AKM e kemi ministër, unë po habitem shkuan gjashtë muaj dhe ato para nuk na u sollën, këtu. Po ashtu, u përmend puna e parave të trustit, që u tha se të kaluarën nuk kanë mund. Nuk është e vërtetë se nuk është mundur dhe në të kaluarën të bëhet diçka në atë drejtim. Ka mund edhe atëherë por ka munguar presioni i vendorëve, siç mungon edhe tash. Nuk është në rregull që me një problem shumë të madh shumë serioz të merren disa gazetarë amatorë gjersa institucionet shtetërore të Kosovës të cilat të paktën krenohen se janë profesionalist, se kanë profesional në vete – profesionalistë ashtu thonë të paktën, nuk merren fare me atë problem. Thotë njeri që është problem minor, flas për kontributet e qytetarëve të Kosovës apo për trustin e Kosovës.

Çka mbet tjetër pa u thanë këtu? Po e them edhe një herë rritjen, se u prek këtu nga profesori, domethënë nuk ka rritje të buxhetit nëse merret parasysh fuqia blerëse e paritetit apo Purchasin Power Parity, ministri e din shumë mirë bile nëse merret ajo parasysh do të ketë ulje, ky 10% i bie ulje nga fakti se ka disa muaj që doganat në veri nuk jeni kah i kontrolloni, andaj edhe logjikisht reflektohet në buxhetin e Kosovës sepse siç u tha s'di sa herë këtu çdo kush e din se buxheti i Kosovës mbushet nga doganat, zoti ministër, dhe aty keni një pjesë të madhe të doganave që s'i kontrollon kjo qeveri, andaj edhe nuk ka të hyra aty. Dhe si mund të ketë rritje nëse ka, domethënë, rritje të çmimeve tjetërkund sigurisht se reflektohet ajo andaj edhe fati yt këtu në këtë fatkeqësi t'u ka rritur ajo linja e buxhetit, por nuk është reale, atë e di ti shumë mirë.

Po u thanë edhe tjera, zoti Kryetar. Po them edhe një herë, unë pa grup parlamentar po duhet i fundit kështu të flas, krejt çka u thanë. Faleminderit!

KRYETARI: Bile desha të them, këto dy partitë më të mëdha s'po kanë njerëz për të qeverisur, po me cilin grup do të qeverisëh ti, këtu është problemi. Fjalën e ka Ramadan Avdiu. Le të përgatitet Gani Geci.

RAMADAN AVDIU: Unë i takoj grupit më të madh parlamentar, por megjithatë po flas pas deputetit Driton Tali.

Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të respektuar ministra,

Ndonëse jam ndër diskutuesit e fundit, vërtet është një materie që thuaj se është shterur. Unë vetëm do të doja ta përgëzoj Qeverinë, domethënë, për nikoqirllëkun e treguar në menaxhimin e buxhetit. Rritja prej 10% është një indikator jashtëzakonisht i mirë dhe na bën edhe neve që ta inkurajojmë Qeverinë që të vazhdojë të punojë në këtë drejtim dhe në këtë formë. Ajo çka është pak për t'u brengosur është se një numër i organizatave buxhetore nuk i kanë shpenzuar, domethënë, as minimumin e mjeteve të planifikuara dhe këtu do t'i sugjeroja Ministrisë, gjegjësisht gjithë Qeverisë që t'i nxitë ato organizata buxhetore dhe ta shtojë në njëfarë mënyre të monitorimit të shpenzimit të tyre. Është e vërtet, domethënë, që në shifra ka pak diferencë në shpenzime në krahasim me vitin e

kaluar ama këto shpenzime janë shumë të dukshme për dallim nga vitet paraprake, janë shumë të dukshme, shumë të prekshme, shumë të matshme. Dhe unë besoj se gjashtëmujori i ardhshëm, sigurisht, se do të rritë shpenzimet, por brengë gjithmonë do të jetë se doganat do të jenë pika kyçe e akumulimit të buxhetit përdërisa ta kemi këtë deficit komercial dhe duke pas parasysh shkallën e zhvillimit të vendit tonë deficit komercial ka për të na ndjekur edhe një kohë relativisht të gjatë, do të thotë ai dallimi në mes importit dhe eksportit, kështu që unë nuk do ta zgjas më shumë vetëm do të dëshiroja që vërtet edhe një herë ta përgëzoj Qeverinë për efikasitetin dhe nikoqirllëkun e treguar në menaxhimin e buxhetit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Ramadan! Fjalën e ka deputeti Gani Geci. Le të përgatitet deputetja Myrvete Pantina.

GANI GECI: Faleminderit zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë nuk dua të hy në vija buxhetore, sepse nuk e njoh aq shumë këtë lëmi, por të ne thonë: “katundi që duket kallauz nuk do”. Ju vetë keni deklaruar se ekonomia e zezë informale apo ekonomia e hajnave i vjedh buxhetit të Kosovës rreth 35% apo dhjetëra milionë euro. Zoti ministër, unë desha t’ju pyes juve se keni vënë një kufi doganor gati në gjysmën e territorit të Republikës së Kosovës apo më thjesht në fshatin Koshtovë, të gjithë e dini ku është fshati Koshtovë. Kush nuk e din mund të shkojë për ta parë. Kushdo nga ju aty mund të shkojë për ta parë dhe aty ka doganierë, ka policë kufitarë dhe ka policë të thjeshtë që ju i quani pika lëvizëse doganore, por ato nuk janë pika lëvizëse doganore, por janë pika statike doganore ku qytetarët e Kosovës dënohen, dënohen sepse nja 100 metra andej nga ajo pikë lëvizëse qysh po e quani ju që unë e them se është pikë statike apo kufi që e keni vu, i vetmi ndryshim nga Qeveria e kaluar është ky kufi, sepse nuk ka ndonjë ndryshim tjetër. Merren qytetarët e Republikës së Kosovës dhe dërgohen në pikën doganore apo në terminalin doganor në Mitrovicë, kam argumente për këtë, sepse një qytetar i Republikës së Kosovës më është ankuar mua drejt si deputet, sepse ka shkuar me ble 100 metra nga dogana të gjithë doganierët, policia dhe KFOR-i e kanë parë duke blerë në pikën për derivate matanë Koshtovës dhe nuk e kanë ndalur as nuk e ka pyetur askush derisa është kthye në pikën doganore apo në kufirin doganor që keni vu ju dhe e kanë dërguar qytetarin e Kosovës në terminalin doganor në Mitrovicë, e kanë dënuar 30 euro dhe ia kanë zbratur gjysmën e rezervarit të benzenit apo naftës që e ka ble ai qytetari. Doganierët, policia por edhe KFOR-i e shohin në pikë të ditës atë pikën matanë që i gëlltit parat e qytetarëve të Kosovës apo këtë ekonominë informale a të zezë, të hajnive a qysh doni mund ta quani dhe nuk intervenon askush që ta ndalë atje ku po shitet dhe jo ta ndalë në fshatin Zhabar qytetarin e Republikës së Kosovës, sepse qytetari i Republikës së Kosovës në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ka të drejtë me pakicë të blejë në secilën pikë të derivateve në territorin e Republikës qoftë edhe në kufi me Serbinë atëherë ku ka qenë dogana këndeje doganës që është fjala. Por, juve e keni shkelur Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ku e keni shkelë, sepse e keni vu një pikë doganore në mes të shtetit të Republikës së Kosovës, jo pikë lëvizëse, por keni vu një pikë statike. Tërë ditën aty, edhe natën, qëndrojnë doganierët dhe secili prej qytetarëve mund të shkojë dhe nesër nëse doni unë ua bie me fotografi, sepse vi edhe nga ai rreth por kam edhe informata të përditshme. Plus qytetarët e Republikës së Kosovës nja 5 qytetarë nga Skenderaj janë arrestuar dhe janë çua në burg për shkak të kontrabandës me derivate. Ju lutem a më shumë kontrabandë bën me derivate ai që i blenë 30 litra a ai që i ka 100 mijë litra në pompë dhe i shet në pikë të ditës, para KFOR-it, para Qeverisë së

Republikës së Kosovës, para syve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para doganierëve të Republikës së Kosovës dhe askush nuk intervenon.

Unë, zoti ministër, kisha dashtë ta di, se edhe ju e dini, se vetëm për një ditë Qeveria e Republikës së Kosovës nga kjo ekonomi informale apo e zezë, apo e hajnave, në bashkëpunim të hajnave, se nuk po dimë se kush është pas tyre, e kush është pas tyre këtu, por duhet me intervenuar sa më shpejt që është e mundshme që Kushtetuta e Republikës së Kosovës të funksionojë në territorin e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim, kuptohet në bashkëpunim me organet që kanë përparësi dhe që mund ta bëjnë këtë dhe këto janë KFOR-i.

Prandaj, ju lutem, nëse qytetarët i dënojmë në Koshtovë, keni bërë shkelje të Kushtetutës dhe nuk e keni dënuar atë qytetarin tjetër që shet me qindra- mijëra litra derivate dhe e gëlltit buxhetin e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Radha është e deputetes Myrvete Pantina, le të përgatitet deputeti Sabri Hamiti.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Nga raporti i gjashtëmujorit të vitit 2008 i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave vërehet qartë pra se është shënuar një rritje në të hyra, në këtë periudhë në krahasim me vitin 2007 për 10%. Ajo çka ende është brengosësh në strukturën e të hyrave, ajo çka është për t'u brengosur në strukturën e të hyrave buxhetore në Kosovë edhe më tutje është se këto të hyra kryesisht krijohen apo grumbullohen në kufi dhe me këtë nuk mund të jemi të kënaqur. Mirëpo, vërehet se të hyrat tatimore kufitare janë rritur për 46%. Natyrisht ky është rezultat i rritjes së importit dhe me këtë neve nuk mund të jemi të kënaqur. Mirëpo, unë çka shoh një element pozitiv në grumbullimin e të hyrave buxhetore në këtë periudhë është se nga të hyrat tatimore vendore ose të administratës tatimore po ashtu është shënuar një rritje. Është kjo rritje prej 46.6%. Kjo është pozitive, mirëpo ne nuk guxojmë të kënaqemi edhe me këtë për arsye se ka mundësi që të punohet më shumë që të hyrat tatimore vendore të rriten edhe më shumë meqenëse e dimë se është i pranishëm edhe atë në masë të madhe evazioni fiskal. Edhe një element tjetër që vërehet, sipas mendimit tim, në të hyrat buxhetore në këtë periudhë është se janë rritur të hyrat vetjake dhe të hyrat vetjake janë rritur për 58.4% dhe kjo sipas mendimit tim paraqet një element shumë pozitiv, çka do të thotë duhet edhe më tutje të veprohet në këtë drejtim. Dhe, në kuadër të të hyrave vetjake për mua është sidomos për t'u vlerësuar këto të hyrat vetjake të komunave, ku vërehet se ka një rritje në grumbullimin e këtyre të hyrave për rreth 27%. Këtu vetëm do të përmend se ka komuna në të cilat të hyrat i kanë rritur në këtë periudhë madje deri në 148%, si është komuna e Hanit të Elezit. Mirëpo, kemi edhe komuna të tilla në të cilat nuk grumbullohen fare ose thjeshtë ka rënie të grumbullimit të hyrave siç u përmend më parë është Novobërda dhe Shtërpca.

Mirëpo, nuk mund të jemi të kënaqur me dinamikën e shpenzimeve, ndonëse pagesat në këtë periudhë janë rritur për 18% në krahasim me vitin 2007. Mirëpo, pjesëmarrja e mjeteve të shpenzuara në krahasim me buxhetin është vetëm 31%. Sidomos ngecin shpenzimet për investime kapitale, të cilat paraqesin vetëm 13.6% të mjeteve të planifikuara nga fondi i konsoliduar i Kosovës ose 15.3% të mjeteve për shpenzime kapitale të shfrytëzuara në nivelin qendror. Nga tabelat vërehet se shumica e agjencive buxhetore i kanë shfrytëzuar shumë pak ose aspak mjetet e parapara për shpenzime kapitale.

Për një shpenzim më të mirë të mjeteve për investime kapitale, nëse mund të thuhet ashtu, mund të veçohen disa prej agjencive buxhetore. Do t'i përmend Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që konsiderohet me shpenzime në shkallë më të lartë të mjeteve për investime kapitale me 29%, pastaj është Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit me 17% dhe Ministria e Shëndetësisë po ashtu me 17%.

Kjo është për t'u brengosur, sepse e dimë se nevojat ekzistojnë për investime kapitale, ndërsa ato nuk shfrytëzohen dhe në fund të vitit ato mjete shpenzohen me shpejtësi ose do të paraqiten si suficit.

Vërehet nga të dhënat se pritet apo ka suficit edhe në këtë periudhë, por në këtë nuk do të ndalem. Natyrisht se mjetet nuk duhet të shpenzohen me çdo kusht. Domethënë për projekte jo të arsyeshme. Por duhet që të punohet më shumë me organizatat buxhetore ose ato duhet të kenë pra ekipe të cilat hartojnë projekte në mënyrë që prej tyre të vijnë projektet e arsyeshme dhe të mirëfillta, të cilat përshtaten me prioritetet e përcaktuara. Ju faleminderit!

KRYETARI: I fundit diskutues për sot deputeti Sabri Hamiti, e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Unë do të flas krejt shkurt e më shkurt që është e mundur. Meqë sot po bisedojmë për buxhetin dhe e kemi bërë zakon më vonë të themi, u vonuam e s'u vonuam. Edhe sot u tregua që të gjitha buxhetet janë aprovuar vitet e fundit duke thënë se është kohë emergjente, po na zë Viti i Ri, kemi konstituimin e Qeverisë, kemi shpalljen e pavarësisë, e tjera.

Ju them që, me ligjet në fuqi, deri më 15 tetor të këtij viti duhet të jetë leximi i parë i buxhetit për vitin e ardhshëm në Kuvend. E shfrytëzoj rastin t'i them ministrit të Financave që është koha e fundit që të përgatitet projektbuxheti për vitin e ardhshëm dhe të vijë në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Ministri Ahmet Shala e ka fjalën. Ekziston koha, unë e kam paralajmëruar moti deputetin e fundit. Pas kohe, je lajmëruar.

AHMET SHALA: Faleminderit, Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ju falënderoj shumë për kontributin tuaj. Shumica e deputetëve, konsideroj se kanë dhënë një kontribut të shkëlqyer në përkrahjen e këtij raporti, me vërejtjet e sinqerta, ndërsa të tjerët kanë bërë gotën gjysmë të zbrazët.

Në qoftë se shikohet ky raport, konsideroj që të gjitha parametrat të cilat u paraqitën, qëndrojnë me argumente të fuqishme.

Të gjitha sugjerimet e sinqerta do merren parasysh qoftë në përpilimin, qoftë për organizatat buxhetore të cilat janë shpenzues të pavarur të buxhetit të Kosovës.

Megjithatë, unë dua të reflektoj në disa gjëra për hir të opinionit dhe për hir të atyre që na dëgjojnë dhe na përcjellin, dhe dua t'i drejtohem, mbase individualisht disa prej deputetëve, për hir të korrektësisë së raportit, thashë disa prej tyre e shohin gotën gjysmë të zbrazur e disa gjysmë të mbushur, në fakt është e njëjta gjendje. Në qoftë se

lexoni faqen 17 dhe i drejtohem deputetit të zotëri Gjini, te shpenzimet sidomos të udhëtimeve dhe shpenzimeve zyrtare, ju do ta shihni sqarimi dhe është fer të lexohet po ai raport të cilin ua kemi dhënë të gjithë juve. 3 milionë e 300 mijë euro të shpenzimeve të këtyre kategorive janë nga viti i kaluar, prandaj nuk ka ngritje të shpenzimeve të ushqimeve zyrtare çfarëdo qofshin, që quheshin me sinonime të ndryshme, nuk ka ngritje përkundrazi ka ulje diku në mesatare 5%. Pra, 3 milion e 300 mijë euro, Qeveria e Kosovës ka paguar dreka dhe darka borxhet e vitit të kaluar.

Në vërejtjet që i lexova dhe kur të lexohet i gjithë, për hir të opinionit duhet të lexohet e tëra e jo vetëm një segment i saj. Natyrisht, roli i opozitës është gjithmonë t'i gjejë të metat, por ato duhet të jenë vërtet të sinqerta, të argumentuara dhe në bazë të shifrave të konfirmuara. Kështu që, do kisha dashur që të jetë në ndërgjegjen e secilit se si do t'i përdorë këto, por unë e thërras edhe pozitën edhe opozitën për korrektësi dhe sinqeritet.

Unë, si ministër i financave do të bëjë gjithçka që është e mundur që sinqerisht, këtu raportimin e bëjë për qytetarët e Kosovës dhe jo vetëm për deputetët e një partie politike ose të një koalicioni dhe do të bëjë gjithçka që është e mundur që të përmirësojmë raportimin dhe i falënderoj të gjithë ata që më dhanë komplimente për përmirësimin e raportimit, i cili është proces. Nuk është brenda dite dhe nuk pretendojmë të arrijmë perfeksionimin, por po bëjmë gjithçka që është e mundur.

Dua të konsideroj një kritikë një analizë ishte mjaft e sinqertë edhe nga opozita edhe nga pozita, sa i përket strukturës së të hyrave nga doganat dhe nga vjeljet e brendshme. Kjo nuk do të ndërrohet edhe për tre edhe pesë vitet e ardhshme. Të gjithë ekonomistët e dinë, por në qoftë se shihet trendi, kemi përmirësim të dukshëm, dhe shikoni në mesatare vjeljet nga brenda janë dyfish më të mëdha se sa në vitin e kaluar, ndërsa vjeljet nga doganat janë 11%, dhe nëse krahasohet pra kjo shifër tregon se vjeljet nga brenda janë rritur, shumë më shpejtë do rriten dhe besoj që në vitin e ardhshëm edhe më shumë dhe në gjysmën e këtij viti i kemi shënimet edhe më të mëdha se sa vjeljet nga dogana.

Kjo sa i përket arritjes së një hapi, do të merr procese, do të merr importi me prodhimin, do merr goxha vite për të marrë dhe nuk dua të rrisë shpresat e rrejshme te askush por të raportoj sepse kemi një obligim moral dhe profesional ndaj të gjithëve. Prandaj, por trendi është pozitiv, kjo është me rëndësi dhe këtë duhet ta vërejnë profesorët dhe ekspertët qofshin edhe të opozitës dhe ta thonë, jo ta thënë vetëm të kundërtën.

Sigurisht që nuk dua të shkoj një nga një, unë i kam përgjigjet mbase për secilin, por për hir edhe të kohës që ka kaluar neve kemi premtuar dhe sigurisht do ta realizojmë me gjithë fuqinë tonë që është e mundur venien në kontroll të Veriut dhe jemi në bashkëpunim shumë të mirë me ULEKS-in, për fillimin e funksionalizimit të doganierëve ndërkombëtar dhe atyre vendor.

Kemi një reagim pozitiv edhe të vetë serbëve të cilët e kanë lëshuar mbi 48 e dini që e kanë lëshuar, neve kemi rekrutuar tani po aq nga 700 të tjerë që janë paraqitë dhe së bashku me ULEKS-in, do t'i vendosim ato. Nuk ka dogana, nuk ka kufi të ri, por në fakt, në realitet edhe nuk kemi arritur të kalojmë atje ku duhet, por e kemi saktë, konsideroj të qartë se si do arrihet atje, dhe kjo do arrihet. Unë jam i sigurt që së bashku me ULEKS-in, deri në nëntori, neve do ti kemi doganierët vendor dhe ndërkombëtar atje.

Kjo është gjendja reale, të gjithë e dimë tash, nëse domi me bo politikë edhe propagandë edhe kritikizëm, por kjo është e vërteta të cilët e dinë edhe vetë kolegët të cilët kritikuan.

Çka desha të, u prekën disa gjëra mbasi që nuk kanë të bëjnë me raportin drejtpërdrejtë, por për hir të informimit rreth arkave fiskale dhe disa ligjeve, neve zotohemi, jemi zotuar dhe do ta bëjmë që të jemi në përgatitje e sipër në momentin kur ka kalon në Parlament, ky një ligj që është lexuar vetëm një herë Ligji për procedurës e Administratës Tatimore, tani pres që brenda dy –tri javëve, besoj në Parlament do të bëhet edhe leximi i dytë, neve dhe Ligji mbi TVSH-në i cili është përgatitur faktikisht dhe është në procedurë të vijë te ju këto ditë, neve faktikisht mbulohemi ligjërisht për ta zbatuar edhe arkat fiskale, kemi përgatitur komplet materialin për fillimin e procesit të disa projekteve, pilot projekteve në këtë vit dhe është një proces, do të shkoj 6 muaj, 1 vjet, shteteve ua kanë marrë 5 vjet, kështu do të veprojmë edhe ne në bazë të praktikave më të mira.

Edhe një sqarim dhe po e përmbylli i nderuar kryetar dhe të nderuar deputetë, nuk ka të bëjë me falje të dënimeve, ju kisha lutur shumë, sepse ndoshta nuk kemi qenë shumë të zotë të shpjegojmë këtë, por edhe qeveritë e kaluara pa dashtë ta kritikojë askënd, mbase për shkak të pretendimit të madh të aprovimit të ligjeve shumë perfekte, nuk ka arritur të inkasojë rreth 230 – 241 milionë euro me shënimet fundit të gushtit janë, nuk është faji as vetëm i kësaj Qeveria, nuk është faji as i qeverive të kaluara, krejt mbase është faji i gjithë gjendjes politike e shoqërore, infrastrukturës ligjore dhe për gjitha.. Çfarë duhet të bëjmë neve, duhet të presim se dikush duhet të na i paguaj ato, jo. Neve kemi pezulluar, pra nuk ka falje, ka pezullim të ndëshkimit jo të borxhit. Nga 241 milion euro 126 milionë euro janë ndëshkime dhe penale. Prej atyre ndëshkimeve dhe penale vetëm ndëshkime janë 56 milionë euro dhe penale diku rreth 50 e diçka milionë tjera.

Çka po themi na, ndëshkimet po i pezullojmë për çdo kompani e cila ndërhyrë në marrëveshje në marrëveshje me Administratën Tatimore në afatin deri me 31 dhjetor, për të shlyer borxhin brenda një viti, në qoftë se brenda këtij viti, prej momentit kur janë nënshkruan kontratën e shlyen borxhin dhe penalet ndëshkimi do t'i falet, dhe nuk është falje e borxhit kjo, prandaj ndoshta kemi qenë të mangët dhe unë në javën e ardhshme e kam përgatitur një konferencë, faktikisht një shpjegim pak më të gjatë dhe do të ketë mjaftë edukim ndaj qytetarëve, ndaj deputetëve nëpër media, nëpër televizorë, është përgatitur një paketë i tërë i seminareve. Pra, përhirë të vetë informimit më të sakët ndaj juve sidomos ligjdhënësve, unë doja t'i shpjegoj këto gjëra.

Neve nuk pretendojmë që është bërë një mrekulli me Qeverinë dhe me shpenzimet kapitale, konsideroj se ka zvogëlime në shpenzime dhe atë deri në shkallën diku 27% në mesatare, por në disa segmente deri në 57%, duhet të sqaroj edhe një herë për dreka dhe darka, është zvogëlim 5,2% saktësisht deri në këtë vit pa marrë parasysh që kanë ndodhur festat e pavarësisë, festat tjera, që karshi me vitin e kaluar nuk kanë qenë dhe ka ekzekutime të kapitaleve edhe pse buxheti është aprovuar me 29 shkurt, dhe fillimi i parë i mundësisë për të ekzekutuar ka qenë 26 marsi. Brenda kësaj periudhe janë harxhuar dhe deri sot, raportimi është që janë harxhuar 115 milionë euro të shpenzuara tërësisht brenda këtyre 4-5 muajve faktikisht, ndërsa në vitin e kaluar Qeveria pa dashtë me e kritikuar askënd, në tërë vitin ka harxhuar 153 ose 153,7, nuk e di ose diku 157 milionë euro.

Nuk po them që kemi me ia arritur pa buxhet, por nëse krahasohet edhe vetë dyfishimi i shpenzimeve kapitale, se në vitin e kaluar ka qenë 250, sivjet është 440, neve do të arrijmë diku...

KRYETARI: Të nderuar deputetë, unë po iu drejtohem dy shefave të grupeve të koalicionit që vërtetë është mirë t'i disiplinoni deputet e grupeve tuaja parlamentare se 25 deputetë ka Lidhje Demokratike, 37 ka Partia Demokratike dhe do të duhej ti kishte për të votuar ashtu që sot me heqë këtë pikë nga rendi i ditës, meqenëse na ka mbetur vetëm votimi dhe mendoj që deputetë edhe të Partisë Demokratike edhe të Lidhjes Demokratike, ose duhet të jenë pozitë ose duhet të jenë opozitë edhe pozitë edhe në opozitë mendoj se është njëfarë dyfytërsie dhe nuk na ka hije si deputetë. Koalicioni është, deputetët janë dhe mendoj që përgjegjësia për ta qeverisur këtë vend, është e këtyre dy subjekteve politike, dhe me këtë përgjegjësi që po tregoni edhe ju si deputetë, mendoj se nuk është as në nderin e Kuvendit, as në nderin e institucioneve, por as në nderin e partive politike që i përfaqësoni, kështu që kjo pikë mbetet pika e parë e rendit të ditës në seancën e ardhshme - vetëm votimi.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve